PIPS
Prishtina Institute fot Poltical Studies

KONRAD ADENAUER STIFTUNG

Partitë politike
Funksioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike

Wilhelm Hofmeister dhe Karsten Grabow

Botimi i dytë

www.kas.de

Partitë politike
Funksioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike

Wilhelm Hofmeister dhe Karsten Grabow

Botimi i dytë

Impresum

Titulli:
PARTITË POLITIKE
Funksionimi dhe organizimi në shoqëritë demokratike
Botimi i dytë

Botues:
Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Kosovës
Instituti i Prishtinës për Studime Politike - Prishtinë

Autorë:
Uilhelm Hofmajster / Karsten Grabou

Koordinimi:
Granit Tërnava

Përktheu:
Global Consulting & Development Associates LLC Gjilan, Kosovë

Shtypi dhe dizajni:
Envinion

Tirazhi:
500 ekzemplarë

Publikimi mund të shkarkohet falas në:
http://www.kas.de/kosovo

Vërejtje:

Qëndrimet e prezantuara në Publikim nuk janë qëndrime të Fondacionit Konrad Adenauer dhe të Institutit të Prishtinës për Studime Politike, por janë pikëpamje personale të autorëve.

Përmbajtja

PARATHËNIE 07

1. PARTITË DHE SISTEMI PARTIAK 11

1.1. Çka është partia politike? 12
1.2. Kriteri për identifikimin e partive politike 13
1.3. Pse ekzistojnë partitë politike? 14
1.4. Funksionet e partive politike 16
1.5. Sistemet e partive politike 17
1.6. Tipologjia e partive politike 18
1.7. Partitë dhe ideologjitë 21

2. MENAXHIMI MODERN I PARTIVE POLITIKE 23

2.1. Organizimi dhe Anëtarësimi 24
2.2. Anëtarët e një partie politike 28
2.3. Rekrutimi i anëtarëve të rinj 29
2.4. Edukimi dhe trajnimi i anëtarëve të partisë 31
2.5. Programet e partive politike 33
2.6. Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm 34
2.7. Demokracia brenda partiake 39
2.8. Konfliktet brenda partiake dhe zgjidhjet e konflikteve 42
2.9. Kuota për gratë dhe minoritetet 43
2.10. Financimi i partive 44

3. PARTITË POLITIKE DHE MARRËDHËNIA E TYRE ME SHOQËRINË CIVILE DHE GRUPET E INTERESIT 49

3.1. Partitë dhe shoqëria civile 51
3.2. Partitë dhe asociacionet 52

4. PARTITË POLITIKE NË PARLAMENT DHE QEVERI 55

4.1. Grupet parlamentare (fraksionet) 57

5. LIDERSHIPI POLITIK 59

5.1. Dilema e lidershipit politik 62
5.2. Mësimet e udhëheqësve politik 63

6. SFIDAT E PARTIVE POLITIKE NË REGJIMET DEMOKRATIKE 67

6.1. Partitë politike dhe ndryshimet sociale 68
6.2. Kriteret për punë të qëndrueshme dhe të suksesshme të partisë 71

7. KONKLUDIM: NUK KA DEMOKRACI PA PARTITË POLITIKE 75

8. PARTITË POLITIKE NË KOSOVË 77

Butrint Berisha – Instituti i Prishtinës për Studime Politike 77

9. SHËNIME DHE REFERENCA 93

Padyshim se të gjitha mendimet e njeriut dhe i tërë veprimi i njeriut shpeshherë varet nga koha dhe u nënshtrohen ndryshimeve. Por, nëse formojmë parti politike, e cila u përmbahet kërkesave të cilat i dikton koha, atëherë partia e tillë do të jetë sterile dhe jetëshkurtër. Veçanërisht partitë ose, thënë më mirë, sidomos partitë politike në qoftë se dëshirojnë të mbijetojnë, duhet të ndërtohen në thellësi. Ato duhet të bazohen në vlera të përjetshme.

Konrad Adenauer

Parathënie

Politika është procesi i organizimit se si të jetojmë së bashku në një shoqëri.

Në demokraci, secili qytetar mund të marrë pjesë në këtë proces – duke pranuar lirisht informacione për çështjet politike, duke shprehur në mënyrë të hapur mendimin e vet mbi çështjet publike, duke formuluar pritjet, propozimet apo kërkesat pa frikën e represionit, duke votuar në zgjedhje, duke u angazhuar në organizata të shoqërisë civile apo parti politike, apo duke qëndruar si kandidatë në zgjedhje demokratike. Në këtë drejtim, demokracia është " qeveria e popullit, nga populli, për popullin", në fjalët e famshme të Abraham Lincolnit, President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga viti 1861-65

Për të arritur të gjitha kërkesat e një qeverie 'të popullit, nga populli dhe për popullin', politika në demokraci duhet të plotësoj disa kushte:

- Politika kërkon ide dhe vlera të cilat i caktojnë qëllimet dhe standardet e organizimit politik. Liria, drejtësia dhe solidariteti janë parime të tilla të cilat mund të udhëheqin organizimin politik të secilës shoqëri.

- Politika kërkon organizata shoqërore të cilat mbledhin interesa, përfundime, dhe i komunikojnë ato tek institucionet politike dhe qeveritare. Partitë politike, mirëpo edhe asociacionet e biznesit dhe punëtorëve si dhe organizatat e tjera jo qeveritare të shoqërisë civile, janë organizatat të tilla që mbledhin interesat e përgjithshme të shoqërisë.

- Politika kërkon institucione që mbledhin propozime për organizimin e shoqërisë, pastaj i përfaqëson, diskuton, vendos dhe i zbaton ato. Parlamentet dhe qeveritë—të cilat normalisht mbështeten në partitë politike janë institucionet më të rëndësishme të politikës në një shtet demokratik.

- Politika kërkon qytetarë aktiv që marrin pjesë në diskutimet politike me ide, kërkesa dhe pritje, dhe kontribuojnë në mënyrë aktive në funksionimin e institucioneve politike:

Në demokraci, shumica nëse jo të gjithë qytetarët duhet të përfshihen në aktivitetet politike. Megjithatë, një demokraci e drejtpërdrejtë ku secili qytetarë është drejtpërdrejt i përfshirë në të gjitha vendimet politike, nuk është e mundshme në shoqëritë moderne masive. Prandaj kjo është pse demokracia moderne ka nevojë për institucione dhe organizata të cilat përfaqësojnë vullnetin dhe interesin e qytetarëve sa më autentikisht që është e mundur. Këto mund të jenë asociacionet, grupet jo formale apo organizatat jo-qeveritare. Në veçanti, partitë politike kryejnë funksione të tilla përfaqësuese. Ato i ofrojnë qytetarëve mundësinë për të influencuar politikën dhe vendimet politike. Ato janë një instrument dhe institucion i rëndësishëm i politikës.

Pa parti politike, një demokraci përfaqësuese moderne nuk është e bindshme. Vetëm partitë sigurojnë se qytetarët janë përherë në gjendje për të vepruar politikisht. Ato artikulojnë dhe integrojnë interesa, vizione dhe opinione të ndryshme. Ato gjithashtu janë burimi kryesor për rekrutimin e elitës politike.

Në mënyrë që të marrin pjesë suksesshëm në zgjedhje, partitë politike duhet të jenë zëri i sektorëve të gjerë të shoqërisë. Asociacionet, organizatat shoqërore apo iniciativat qytetare normalisht koncentrohen më shumë në çështjet individuale dhe fushëveprimin e kufizuar. Partitë politike, në kontrast, pritet të zënë pozicionet në të gjitha ato pyetje të cilat lidhen me rendin publik dhe organizimin e shoqërisë.

Partitë garojnë mes vete për mënyrën më të mirë të zgjidhjes së problemeve politike. Ato janë në garë për influencë dhe pushtet. Pa pushtet për të zbatuar vizionin politik nuk është e mundur të organizohet një shoqëri. Diskutimet e brendshme dhe konfliktet brenda saj, si dhe mes Diskutimet e brendshme dhe konfliktet brenda, si dhe në mes, shoqërojnë partitë në këtë garë për ide dhe pushtet. Ato janë të ligjshme dhe thelbësore.

Në këtë libër, ne i paraqesim partitë politike si institucione qendrore të demokracisë moderne. Karakteristikat dhe funksionet e partive, elementi bazik i organizimit të tyre, konteksti politik dhe social, si dhe problemet e demokracisë së partisë dhe sfidat e veçanta që partitë ballafaqohen me to janë temat kryesore. Kjo bëhet që të përcillen informacionet thelbësore në rrjedha të ndryshme të partive politike. Njëkohësisht është menduar të rrisë interesimin dhe dëshirën për të kontribuar, në një parti. Edhe pse kritikat e partive politike janë gjithmonë të lehta dhe të njohura, partitë politike janë të domosdoshme për një demokraci. Ato mund të jenë në gjendje të përmbushin funksionet e tyre vetëm kur më shumë qytetarë dëshirojnë të angazhohen politikisht në parti.

Fondacioni Konrad Adenauer
Republika e Kosovës

1

Partitë dhe sistemet e partive

1. Partitë dhe sistemet partiake

1.1. Çka është një parti politike?

Partitë politike janë forma të veçanta të organizimit social. Ato nuk duhet të ngatërrohen me asociacionet, federatat, dhe klubet shoqërore. Një definicion i njohur i partive politike vjen nga Shkencëtari i shkencave politike Antony Downs, i cili shkruan: "Një parti politike është një ekip i burrave që kërkon të kontrolloj aparaturat qeverisëse duke fituar zyrën gjatë një palë të zgjedhjeve të rregullta"[1]. Dijetari Italian Giovanni Sartori, i cili ligjëroi për një kohë të gjatë në Universitetin e Kolumbisë në New York dhe është një nga hulumtuesit më të njohur të partive politike, ai e ka definuar një parti si: "cili do grup politik i identifikuar me një emërtim zyrtare i cili paraqitet gjatë zgjedhjeve, dhe ka aftësi që nëpërmjet zgjedhjeve të vendos kandidatët për zyrën publike."

Edhe nëse këto definicione demonstrojnë disa dallime në të kuptuarit e partive politike, ato të gjitha theksojnë **pjesëmarrjen në zgjedhje** dhe interesin që të **fitojnë zyrat publike dhe mandatet** si elemente thelbësore që karakterizojnë partitë politike. Ato duhet patjetër të arrijnë disa kritere të cilat mund të përmblidhen si në vijim.

1.2. Kriteret për identifikimin e partive politike

- Një parti përpiqet për të influencuar formimin e opinionit politik dhe synon të ketë një ndikim të përgjithshëm politik. Influenca aktive e opinion-bërjes synohet në periudhë më të gjatë kohore si dhe në një rajon më të gjerë dhe se nuk duhet të koncentrohet në nivel lokal apo në një çështje të vetme.
- Një parti është një asociacion i qytetarëve që mbajnë një anëtarësim individual, dhe duhet të ketë numrin minimal të anëtarëve, kështu që serioziteti i synimeve të veta dhe prospekti i suksesit të mbetet i qartë.
- Një parti duhet të demonstroj dëshirën që në mënyrë të vazhdueshme të merr pjesë në përfaqësimin politik të popullatës gjatë zgjedhjeve. Prandaj kjo e dallon veten nga sindikatat, organizatat jo qeveritare dhe iniciativat e tjera të cila nuk duan të kryejnë ndonjë përgjegjësi politike për sektorët më të mëdhenj mirëpo tentojnë të kenë një influencë selektive, dhe atyre që nuk marrin pjesë në zgjedhje.
- Një parti duhet të jetë organizatë e pavarur dhe permanente; nuk duhet të formohet vetëm për një palë zgjedhje dhe pastaj të pushoj së vepruari.
- Një parti duhet të dëshiroj të paraqitet në publik.
- Një parti jo me doemos duhet të fitoj ulëse në parlament, por duhet të përmbush të gjitha kriteret e tjera.

Në këtë mënyrë **partitë** mund të kuptohen si **asociacione permanente të qytetarëve që bazohen në anëtarësim të lirë dhe një program, të cilat mundohen që të zënë vend nëpërmjet zgjedhjeve, pozicioneve vendimtare politike të vendit, me ekipin e tyre të udhëheqësve, në mënyrë që të materializojnë sugjerimet për zgjedhjen e problemeve të jashtëzakonshme.** Mjetet e zgjedhjeve nënkuptojnë garën e së paku dy partive.

Partitë jo vetëm se mundohen që të marrin pjesë në formimin e opinionit politik. Ato gjithashtu aspirojnë të marrin pjesë në përfaqësimin e popullatës në parlament. Kjo nënkupton se partitë marrin pjesë në zgjedhje. Kontributi politik i një partie si dhe "pesha" e vet politike është e lidhur ngushtë me zgjedhjet. Vullneti i votuesve është i një rëndësie të konsiderueshme për partitë.

Një gjë tipike për partitë është "shpirti luftarak" — gatishmëria e tyre për veprim politik dhe konfrontim politik — si dhe aspirata e tyre për të udhëhequr dhe ruajtur pushtetin qeverisës. Kjo konkurrencë mes partive është një instrument për të fituar pushtet politik dhe i tërë organizimi i një partie është përfundimisht subjekt i këtij qëllimi. Vetëm ato parti që marrin pjesë në mënyrë të suksesshme në këtë garë mund të fitojnë poste të

përfaqësimit politik. Ky është edhe stimulimi kryesor për të marrë pjesë në aktivitetet e partisë dhe e bën një parti veçanërisht interesante pasi të bëhet pjesë e qeverisë.

Edhe një rol më pak atraktivë i opozitës ofron elemente interesante për pjesëmarrje aktive. Partitë politike janë gjithmonë qendra për debate dhe diskutime rreth reformave politike dhe ndryshimeve politike. Të interesuarit për politikë në të shumtën e kohës e gjejnë një parti që reflekton perceptimet e veta, qoftë ajo në opozitë apo në pushtet. Partitë në opozitë ushtrojnë një funksion të rëndësishëm në sistemet demokratike si një "kujdestarë" i politikave qeveritare dhe se si një alternativë politike në të ardhmen. Opozita mund të konsiderohet si e tmerrshme, por është esenciale për funksionimin e demokracisë.

Ndryshe nga grupet e interesit, një parti pritet të shpreh veten në të gjitha çështjet relevante për qeverinë. Pritet që partitë të propozojnë pikëpamje në politikat e jashtme, ekonomike dhe politika sociale, dhe politikat e rinisë dhe atyre civile etj. Në mënyrë që arrijnë këto kërkesa, secila parti duhet të ketë një program në të cilin ruhet pozicionimi i vet themelorë në fusha të ndryshme. Për më tepër, pritet që një parti të ketë një organizim të qëndrueshëm.

1.3. Pse ekzistojnë partitë?

Brenda çdo shoqërie ekzistojnë opinione, nevoja, pritje dhe pikëpamje të ndryshme për problemet ditore; gjithashtu ekzistojnë pyetje të "mëdha" mbi organizimin e shoqërisë, normat dhe procedurat. Nuk ekziston diçka e ngjashme me vullnetin e përbashkët të popullatës apo të mira të përbashkëta të para përcaktuara. Ndryshe, në çdo shoqëri ka interesa rivale të cilat shpesh ndeshen shumë fort. Në mënyrë që paqësisht të ndërmjetësojmë konfliktin, formimi i pikëpamjeve politike duhet të ndodh në një proces të hapur të debatit mes opinioneve të ndryshme. Është i nevojshëm minimumi i bindjes së përbashkët. Ky është mendimi praktik i demokracisë. Bazohet në parimin se secili qytetarë ka të drejtë të përfaqësoj opinionin dhe bindjen e vet në një garë paqësore të mendjeve.

Ky supozim i konfliktit të interesave brenda çdo shoqërie, që në parim janë legjitime, quhet pluralizëm apo "teori konkurrimi" e demokracisë. Sipas kësaj teorie, formimi i opinionit politik në një shoqëri pluraliste arrihet nëpërmes një procesi të hapur të konkurrimit mes interesave heterogjene. Për shkak të llojllojshmërisë së opinioneve dhe konflikteve sociale nuk ka zgjedhje të përsosur për problemet. Vendimet duhet të merren në bazë të pëlqimit dhe aprovimit të shumicës së qytetarëve. Megjithatë, nuk mund të ketë asnjë "tirani e shumicës" që fyen rregullat demokratike dhe shkel të drejtat e patjetërsueshme të njeriut. Edhe vendimet e shumicës mund të përfshijnë mangësi apo edhe padrejtësi. Prandaj, një mbrojtje e veçantë dhe e garantuar me kushtetutë e pakicave në njërën anë, si dhe pranimi i votimit ose të humbjes në zgjedhje e palës humbëse në anën tjetër, me kusht që ato të jenë (kryesisht) të lira dhe të ndershme - janë elemente konstituive të këtij koncepti të demokracisë.

Brenda kontekstit të konflikteve të interesave të menaxhuara në mënyrë demokratike, partitë politike përfaqësojnë interesa të veçanta. Vetëm atëherë kur të jenë shprehur

hapur interesat e kundërta dhe partitë i akordojnë partive të tjera të drejtën për të përfaqësuar interesat e veçanta, dhe kur palët pajtohen me parimet e lojës-politike, për shembull, në qoftë se ata bien dakord kryesisht në kushtetutë demokratike-atëherë është e mundur që të zgjidhen konfliktet në një shoqëri dhe të krijohen kompromise politike në një mënyrë të përshtatshme.

Natyrisht, liritë e partive duhet të sigurohen gjatë procesit. Kjo do të thotë se krijimi i partive politike duhet të jetë i lirë nga kufizimet politike. Megjithatë, mund të ketë disa kufizime sa i përket krijimit të partive të cilat në mënyrë të hapur e kundërshtojnë kushtetutën demokratike të një shteti. Megjithatë, në parim qytetarët duhet të kenë të drejtë të krijojnë një parti, të jenë pjesë e një partie, dhe të shprehin vetën e tyre lirshëm në to. Liria e partive gjithashtu përfshin nocionin; se askush nuk mund të shtyhet me forcë të aderoj tek një parti e veçantë apo të mbetet në atë parti përkundër dëshirës së tij- siç ka qenë dhe që mund të jetë ende rasti në disa vende. Afirmimi i shumëllojshmërisë së partive është një konkluzion i njohjes së demokracisë pluraliste.

Ky koncept garues i demokracisë qëndron në krahasim me vizionin e homogjenitetit, i cili supozon një unitet të dëshirës së popullit. Filozofi politik Francez Jean-Jacques Rousseau (1712 – 78) e ka krijuar këtë vizion që në teori e mohon legjitimitetin e konflikteve dhe e definon demokracinë si një identitet i qeverisë dhe i qytetarëve. Ky koncept nuk e pranon një për një pluralizmin e partive. Ato nuk konsiderohen si legjitime pasi që ato në mënyrë të pashmangshme falsifikojnë "vullnetin e përbashkët" me sjelljen e tyre të veçantë. Devijimet nga e mira e përbashkët e imponuar dhe e detyrueshme nuk tolerohen nga kjo teori. Megjithatë, është e qartë se ky koncept është karakteristikë e shteteve totalitare, ku llojllojshmëria e partive ndalohet dhe ku "vullneti i përbashkët", përcaktohet vetëm nga një elitë e vogël sunduese. Rrjedhimisht, shtetet totalitare janë identifikuar me Rousseau. Duhet të theksohet se edhe Rousseau nuk mund të sqaroj se si kjo "logjikë e shëndoshë" do të zbulohet dhe vendoset. Duhet të kemi parasysh se shoqëritë moderne karakterizohen nga llojllojshmëria e interesave dhe pikëpamjeve. Ato kanë nevoje për parti politike si instanca qendrore për përfaqësimin e kësaj llojllojshmërie të interesave brenda sistemit politik.

1.4. Funksionet e partive politike

Për të marr pjesë në mënyrë të suksesshme në proceset politike dhe për të kontribuar në konsolidimin e demokracisë, partitë politike duhet të demonstrojnë disa kapacitete. Në shkencat politike këto kapacitete quhen "funksione".

Funksionet e partive politike[2]

- Ato artikulojnë interesat e përbashkëta sociale: Partitë shprehin pritjet e publikut dhe kërkesat e grupimeve sociale në sistemin politik (= funksionet e opinion-bërjes politike).
- Ato rekrutojnë staf politik dhe ushqejnë gjeneratat e ardhshme të politikanëve: Ato përzgjedhin personat dhe i prezantojnë ata si kandidat për zgjedhje (=funksioni i përzgjedhjes).
- Ato hartojnë programet politike: Partitë integrojnë interesa të ndryshme brenda projektit të përgjithshme politik dhe i transformojnë në programe politike, për të cilat ato bëjnë fushata për të marr pëlqimin dhe mbështetjen e shumicës (= funksioni i integrimit).
- Ata promovojnë socializimin politik dhe pjesëmarrjen e qytetarëve: Partitë krijojnë një lidhje midis qytetarëve dhe sistemit politik, ato mundësojnë pjesëmarrjen politike të individëve dhe grupimeve me perspektivën e suksesit. (= Funksioni i socializimit dhe pjesëmarrjes).
- Ato organizojnë qeverinë. Ato marrin pjesë në zgjedhje në mënyrë që të zënë pozita politike. Normalisht në demokracitë e partive, një pjesë e mirë e autoriteteve qeveritare dalin nga partitë politike (= funksioni i ushtrimit të pushtetit politik).
- Ata kontribuojnë në legjitimitetin e sistemit politik: në themelimin e lidhjeve mes qytetarëve, grupimeve sociale dhe sistemit politik, partitë kontribuojnë në ankorimin e rendit politik në vetëdijen e qytetarëve dhe në forcat sociale (= funksioni i legjitimimit).

Në shoqëritë moderne, procesi i ngritjes së opinionit politik është një proces polimorfik: Mediet masive, organizatat shoqërore, asociacionet, iniciativat e qytetarëve, komunitetet fetare dhe format moderne të komunikimit elektronik nëpërmjet internetit, mesazheve (sms), Facebook-it, Twitter-it dhe komuniteteve të tjera virtuale, ushtrojnë një ndikim enorm në opinionet dhe vendimet politike. Megjithatë, partitë politike janë ende agjentët parimorë për të përmbledhur opinionet e publikut dhe të i përfaqësoj në procesin e vendimmarrjes politike—dhe ato përfundimisht marrin vendimet politike nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në parlament dhe qeveri. Duke ndjekur punën e partive, perceptimi dhe vlerësimi i argumenteve të tyre gjatë debateve politike, qytetarët mund të orientojnë politikisht vetën e tyre nëpër parti. Për më tepër, me angazhimin në parti, secili qytetarë mund të ketë ndikim në procesin e vendimmarrjes politike.

Përveç kandidatëve të tyre, programi politike është "mall" i një partie, të cilin ia ofron votuesve. Programet e partisë i përmbushin në veçanti dy funksionet kryesore: në njërën anë, ato duhet të artikulojnë interesat e popullatës (partitë si "organe" të popullit) dhe në anën tjetër, ato orientojnë dhe ndikojnë opinionet e qytetarëve (partitë si "formues" të vullnetit publik; shih gjithashtu pikën 4.2.). në lidhje me programin e partisë, votuesit mund të vlerësojnë se a ka partia ndjeshmërinë e mjaftueshme për problemet shoqërore dhe nëse ato kanë mundësi që të propozojnë sugjerimet adekuate për zgjedhjen e problemeve dhe sfidave.

Partitë opozitare e kanë funksionin e kritikuesit të qeverisë, të kontrolloj atë dhe të paraqesin alternativa konstruktive. Ky funksion ka një rëndësi të madhe për një demokraci, për arsye se pa opozitë, qeveria tenton të zhvendoset në vetëkënaqësi dhe fodullizëm dhe dështon në kërkimin e alternativave. Me përmbushjen e këtyre funksioneve, partitë politike ofrojnë shërbime të rëndësishme për një shoqëri të organizuar në mënyrë demokratike. Cilësia e "ofrimit"—që është, mënyra se si ata përputhen më funksionet e tyre—kontribuon me vendosmëri në reputacionin dhe potencialin e partive politike.

1.5. Sistemet e partive politike

I gjithë grupi i partive në një vend formon sistemin e partive politike. Sistemi partiak reflekton strukturën e marrëdhënieve mes partive individuale në marrëdhëniet me njëra tjetrën.

Përbërja e një sistemi partiak rezulton kryesisht nga dy faktorë. Në njërën anë është struktura e konflikteve sociale dhe interesat. Konfliktet klasike janë për shembull ato mes kapitalit dhe punëtorit apo mes atyre partive me orientim sekular dhe fetar. Në anën tjetër partitë dhe ligjet zgjedhore gjithashtu ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm në konfigurimin e sistemeve partiake varësisht se sa liberal dhe i lirë apo kufizues ka qenë krijimi i një partie të re dhe nëse sistemi zgjedhor lehtëson përfaqësimin e një numri më të madh të artive në parlament apo jo.

Më tej, në kohën para demokratike ekzistenca e një partie ka nxitur shfaqjen e një partie tjetër. Gjatë gjithë historisë, sistemet partiake në parim janë zhvilluar përgjatë linjave sociale dhe/apo ideologjike të konflikteve.

Sistemet partiake mund të klasifikohen nga kritere të ndryshme. Më e shpeshta është numri i partive që luftojnë për pushtet që shërben si kriter për përshkrimin e sistemeve partiake. Në këtë drejtim, ne mund të dallojmë sistemin një, dy dhe shumë partiak. Në sistemin "një partiak" dominon vetëm një parti dhe ku praktikisht nuk ka konkurrencë politike mes partive. Sistemi "një partiak" është, siç u tha më herët, në kontradiktë me

veten e vet pasi që një "parti" duhet të jetë vetëm pjesë e një grupi më të madh. Sistemet një partiake për këtë arsye karakterizohen nga shtypja e konkurrencës politike dhe lirive demokratike. "Sistemi dy partiak"" nënkupton se dy parti dominojnë konkurrencën politike, derisa partitë e tjera më të vogla luajnë një rol vartës. Në "sistemet shumë partiake", më shumë se dy parti kanë efekt në garën politike. [3]

Ekzistimi i një sistemi dy-partiak ose shumë-partiak varet nga disa faktorë të ndryshëm: traditat politike, zhvillimi i institucioneve politike, socio-ekonomike, rrethanat dhe rëndësia e ndasive rajonale, si dhe kushtet etnike ose fetare. Veçoritë e ligjit zgjedhor mund të kenë një ndikim të caktuar, por jo vendimtar, në përbërjen e sistemit partiak. Sistemet e votimit me shumicë (i pari kalon) më shumë e favorizojnë evolucionin e një sistemi dypartiak (ose një sistemi të përbërë vetëm nga disa parti dominuese), ndërsa një sistem proporcional i votimit ka më shumë gjasa të favorizoj një sistem shumë partiak. Megjithatë, nuk ka asnjë lidhje të veçantë në mes të sistemeve elektorale dhe partiake.

Sistemi i qeverisë ndikon në zhvillimin e partive dhe sistemeve partiake për aq kohë sa një sistem parlamentar ofron më shumë ndikim për partitë politike sepse qeveria del direkt nga parlamenti, i cili është i dominuar nga partitë. Në një sistem presidencial, është kreu i qeverisë-presidenti- i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli dhe në këtë mënyrë legjitimiteti i tij nuk është i bazuar kryesisht në parlament. Përveç kësaj, ai kryesisht, krahas parlamentit, ushtron edhe funksionet legjislative dhe të tjera, dhe ai normalisht ka të drejtën e vetos për vendimet parlamentare apo edhe ka autoritetin për të shpërndarë parlamentin. Pra, në shikim të parë, në sistemet presidenciale partitë luajnë një rol të vogël. Nga ana tjetër, në sistemet presidenciale ndarja e pushteteve është zakonisht më e dukshme për shkak se partitë nuk janë të lidhura aq ngushtë me qeverinë. Në sistemet parlamentare, megjithatë, identiteti dhe sidomos marrëdhëniet midis qeverisë dhe partisë në pushtet ose partive janë më të mëdha. Kështu që, në një sistem presidencial, Presidenti gjithashtu ka nevojë për aprovim nga parlamenti dhe një shumicë parlamentare. Pavarësia relative nga qeveria të cilën palët e gëzojnë në një sistem presidencial është i një rëndësie të konsiderueshme. Numri i partive të përfaqësuara në parlament është i ndikuar vetëm pak nga sistemi i qeverisjes. Kjo është më tepër një çështje e ndasive shoqërore, eventualisht edhe ndasive etnike dhe të tjera në një vend, strukturës së konflikteve dhe interesave si dhe sistemit zgjedhor.

1.6. Tipologjia e partive politike

Ashtu si sistemet partiake edhe vetë partitë politike mund të dallohen në bazë të kritereve të caktuara. Tipologji të tilla ndihmojnë për të zgjidhur heterogjenitetin e fenomeneve sociale, në mënyrë që ta kuptojmë më mirë atë. Për të identifikuar partitë, ne mund të marrim në konsideratë tiparet karakteristike në mënyrë që të vihen në dukje të përbashkëtat dhe dallimet mes partive të veçanta.

Partitë mund të klasifikohen në përputhje me një numër të kritereve të ndryshme: sipas nivelit të tyre të organizimit, objektivave të tyre socio-politike, klasave shoqërore që ato duan t'i qasen dhe përfaqësojnë ose pozicionimi i tyre ndaj sistemit politik. Disa parti mund të klasifikohen edhe në bazë të emrave të tyre, të cilat shpesh shprehin objektiva të veçanta socio-politike që partitë duan të identifikohen me to. Sipas emrave të tyre, partitë

përcaktojnë se si ato duan të perceptohen dhe kjo nënkupton se si ato dëshirojnë të jenë të klasifikuara. Kjo konfirmon se klasifikimi apo ndërtimi i tipologjive nuk është një ushtrim i thjeshtë akademik, por pjesë e garës politike të partive.Tipologjitë fillimisht u shfaqën në funksion të sistemeve shumë partiake në Evropë, por gjithashtu mund të aplikohen në rajone të tjera. Disa tipologji prezantohen në vijim.

1.6.1. Dallimi i partive nga shkalla e organizimit të tyre:

Partitë e elektoratit: partitë e tilla i kushtojnë më pak rëndësi anëtarësisë së madhe, por janë veçanërisht aktive në fushën e zgjedhjeve. Lidhja e votuesve me një parti të tillë është zakonisht e dobët.

Partitë me anëtarësi: partitë e tilla kërkojnë anëtarësi më të madhe, mundësisht në të gjitha pjesët e vendit. Tradicionalisht, janë partitë popullore dhe partitë e punës ato që përpiqen të kenë një aparat të organizuar mirë të partisë me një anëtarësi të madhe ("parti masive politike"). Si minimum, kjo mundëson financimin e partisë me anë të kuotave të anëtarësimit.

1.6.2. Dallimi me anë të objektivave socio-politikë:

Sa i përket kritereve socio-politike, që janë aspiratë e partive politike, mund të bëjmë dallimin mes atyre partive që kërkojnë ndryshime sociale apo politike në kuadër të rendit ekzistues demokratik dhe partitë të cilat përpiqen për ndryshime me anë të mjeteve radikale, ekstremiste apo revolucionare. Grupi i parë përbëhet nga partitë konservative, liberale, demokratike kristiane, pjesërisht socialiste dhe gjithashtu nga partitë që e përcaktojnë veten e tyre me anë të religjionit apo besimit për sa kohë që nuk përfaqësojnë pozicione ekstremiste. Grupit të dytë kryesisht i takojnë kryesisht partitë ekstreme majtiste apo djathtiste dhe në mes te tyre janë edhe partitë komuniste, përveç tjerave.

Partitë konservative: partitë e tilla dëshirojnë ta ruajnë rendin e "miratuar" ose ta rivendosin atë; janë skeptike për ndryshime dhe risi, për shembull në lidhje me perceptimet dhe rolin e familjes, dhe modeleve alternative të jetës (p.sh. martesave të së njëjtës gjini). Ato gjithashtu nuk e duan transferimin e sovranitetit kombëtar në institucionet supra-nacionale, por e kanë parasysh që idetë, vlerat dhe parimet tradicionale nuk mund të mbahen në vazhdimësi pa reforma të moderuara.

Partitë liberale: partitë e tilla i përkrahin të drejtat e lirisë individuale dhe theksojnë karakterin demokratik të kushtetutës. Tradicionalisht, ato janë anti-klerike dhe kryesisht angazhohen për një ekonomi të tregut të lirë.

Partitë social demokratike: partitë e tilla më së shumti shfaqen në lidhje të ngushtë me lëvizjet e punëtorëve dhe konceptet e tyre politike bazohen në barazinë shoqërore të njerëzve; ato i japin të drejtë shtetit që të ketë një rol të fortë rregullues në ekonomi dhe shoqëri.

Partitë socialiste: partitë e tilla gjithashtu shfaqen në një lidhje të ngushtë me pjesë të lëvizjeve të punëtorëve, por ato përfaqësojnë një qasje më radikale për arritjen e barazisë sociale; heqja e pronësisë private për mjetet e prodhimit dhe një ekonomi e udhëhequr nga shteti janë ndër caqet kryesore të këtyre partive.

Partitë e përcaktuara nga religjioni janë forma të veçanta të partive që karakterizohen nga objektivat e tyre socio-politike. Në mbarë botën një numër i madh i partive janë të bazuara ca më shumë e ca më pak në bindje fetare. Këto janë parti kristiane apo kristian-demokratike,islamike dhe hindu që themelojnë programet e tyre në vlerat dhe standardet e religjionit apo besimit të tyre.

Kjo mund të dërgoj në dallime te konsiderueshme në programet politike dhe objektivave politike të partive të tilla, në varësi se si partitë e veçanta e konsiderojnë qëndrimin e fesë së tyre përkatëse në lidhje me të drejtat individuale te njeriut, liritë individuale ose demokracisë politike. Partitë Evropiane kristian demokratike,p.sh. angazhohen për liritë individuale, solidaritetin social dhe drejtësinë, vetë –përgjegjësinë e qytetarëve dhe një roli diskret të shtetit nën mbikëqyrjen e akterëve ekonomik dhe social.

Partitë ekstreme të krahut të djathtë: partitë e tilla predikojnë ideologji nacionaliste, që shpesh përzihen me një ideologji të paqartë etnike dhe perceptime të mundshme raciste.

Partitë komuniste: parti të tilla propagandojnë diktaturën e proletariatit dhe pretendojnë paracaktimin e historisë.

1.6.3. Dallimi sipas klasave shoqërore të cilave ato synojnë tu qasen

Partitë popullore: partitë e tilla tentojnë të marrin në konsideratë interesat dhe nevojat e sa më shumë grupeve shoqërore që është e mundur dhe në këtë mënyrë tentojnë të integrojnë sa më shumë qytetarë që munden, mundësisht me origjinë të ndryshme shoqërore brenda rangut të tyre partiak dhe dosjeve dhe të bëjnë një total të aspiratave të ndryshme politike dhe sociale në programin e tyre.

Partitë me interes të veçantë: partitë e tilla ndihen përgjegjëse për interesat e një grupi shumë te veçantë (një grupi social, religjioz apo rajonal) dhe nuk pretendojnë të jenë njëlloj të ligjshme për të gjitha pjesët e populllsisë.

1.6.4. Dallimi sipas pozicionimit të tyre drejt sistemit politik

Partitë në përputhje me sistemin: partitë e tilla pranojnë sistemin politik në të cilin ato punojnë dhe dëshirojnë që ta stabilizojnë rendin politik ose ta përmirësojnë atë gradualisht me anë të reformave.

Partitë që kundërshtojnë sistemin politik: partitë e tilla nuk i pranojnë parimet bazë të sistemit të tyre politik dhe përpiqen për ndryshim të sistemit, kryesisht me propozime të fuqishme programore.

Partitë politike shumë rrallë korrespondojnë plotësisht me ndonjërën nga këto klasifikime. Ka tranzicione të ndryshme dhe forma të përziera. Një parti me anëtarësi të madhe apo masive për shembull mund të jetë një "parti interesi" nëse përfaqëson vetëm interesat e caktuara të një grupi shoqëror apo sektori (klasës punëtore p.sh). Për më tepër kriteret tjera janë gjithashtu të mundshme: p.sh. parti qeveritare dhe opozitare, parti rajonale, parti protestuese, etj. Megjithatë klasifikimi mundëson identifikimin e atributeve tipike të një partie, që është një element i rëndësishëm në procesin e garës politike.

1.7. Partitë dhe ideologjitë

Ideologjitë dhe pikëpamjet e veçanta botërore janë të një rëndësie të veçantë për partitë politike. Ideologjitë janë vizione gjithëpërfshirëse të shoqërive dhe zhvillimeve shoqërore, që përmbajnë shpjegime, vlera dhe qëllime për zhvillimet e kaluara, të tashme dhe të ardhshme. Ideologjitë frymëzojnë dhe justifikojnë veprimet politike dhe shoqërore. Ato janë një element thelbësor për orientimet politike. Termi "ideologji" është përdorur dhe ende përdoret kryesisht nga majtistët, partitë komuniste dhe socialiste për ti karakterizuar pikëpamjet e tyre botërore dhe pozicionet politike. Megjithatë, edhe rrjedha të tjera të mendimit politik mund të emërohen si "ideologji", si p.sh liberalizmi, konservatorizmi, nacionalizmi apo fashizmi.

Nganjëherë, ka komente lidhur me "jo-ideologjizimin" e supozuar të politikës. Kjo i referohet faktit se në ditët e sotme shumë parti i theksojnë rrënjët e tyre ideologjike më pak se qasjet e tyre pragmatike në lidhje me sfidat politike dhe shoqërore. Konceptet e sipër përmendura, megjithatë e bëjnë të qartë se ideologjitë kanë ende një rëndësi të konsiderueshme për identifikimin e pikëpamjeve botërore dhe pozicioneve politike. Ne kurrë nuk e kemi arritur 'fundin e ideologjive" siç është proklamuar nga shkencëtari politik Amerikan Francis Fukuyama në fund të luftës së ftohtë. Ai supozoi se demokracia liberale do të zbatohet në fund kundër të gjitha formave të tjera të qeverisjes, dhe në këtë mënyrë të gjitha debateve ideologjike mund tu vijë fundi. [4]

Ata që janë apo që do të angazhohen politikisht duhet ti dinë fijet e ndryshme ideologjike. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për përcaktimin e pozicionit politik për dikë, por edhe për vlerësimin e pozitave tjera politike dhe eventualisht luftimit të tyre.

PASQYRA E IDEOLOGJIVE

- **Ideologjitë e përqendruara në individ**
  Liberalizmi, Neo-Liberalizmi, Konservatizmi, Demokracia Kristiane

- **Ideologjitë Egalitare**
  Socializmi, Komunizmi, Marksizmi, Leninizmi, Stalinizmi, Maoizmi, Trotskizmi, Euro-komunizmi, Neo-Marksizmi, Anarkia

- **Ideologjitë e përqendruara në kolektiv**
  Socializmi, Socializmi Demokratik, Demokracia Sociale, Komunizmi, Marksizmi, Socializmi Kombëtar

- **Ideologjitë e përqendruara në përkatësinë etnike apo kombësi**
  Nacionalizmi, Sionizmi, Rajonalizmi, Pan- Arabizmi, Pan- Sllavizmi, Fashizmi, Neo-Fashizmi, Fashizmi Klerik, Socializmi Kombëtar, Racizmi, Imperializmi, Kolonializmi, Darvinizmi Social

- **Ideologjitë e përqendruara në traditë**
  Konservatizmi, Demokracia Kristiane, Neo-Konservatizmi

- **Ideologjitë e bazuara në religjion**
  Socializmi Kristian, Demokracia Kristiane, Fashizmi Klerik, Islamizmi, Neo-Hindizmi, Sionizmi

- **Ideologjitë Totalitare**
  Socializmi Kombëtar, Komunizmi, Islamizmi, Marksizmi – Leninizmi, Stalinizmi, Maoizmi, Pol-Potizmi

- **Ideologji të tjera**
  Politikat e gjelbra, Ekologjizmi, Internacionalizmi, Kozmopolitanizmi, Pacifizmi, Republikanizmi, Humanizmi, Feminizmi

Menaxhimi modern i partive politike

2.1. Organizimi dhe anëtarësimi

Në mënyrë që të jetë e suksesshme në konkursin politik dhe të ketë një efekt mbi formimin e mendimit politik një parti ka nevojë për një organizim të përhershëm. Sa i përket ndërtimit institucional të një partie ekzistojnë modele të ndryshme themelore. Në baza individuale, që nënkupton anëtarësimin e drejtpërdrejtë të individëve, me ç'rast shumë parti janë të organizuara në një formë të decentralizuar, në bazë të asociacioneve lokale, sipas zonave të banuara apo rretheve, ose të paktën në nivel komunal. Nivelet më të larta të organizimit partiak zakonisht ndjekin strukturën e shtetit.

2. 1.1. Nivelet e organizimit të partisë

- Komitetet Bazë ose Komunale (sipas zonës së banimit ose komunës)
- Asociacionet e Qarkut apo asociacioni i një zone zgjedhore
- Asociacioni Rajonal (sipas Shtetit Federal, rajonit ose departamentit)
- Asociacioni Kombëtar

Figura 1: Niveli i organizimit të partive politike

Organet partitë	Anëtarët ose kuvendi i delegatëve (Konventa e partisë)	Bordi i drejtorëve	Gjykata partiake
Shoqatat kombëtare	Konventa e kombëtare e partisë	Bordi kombëtar	Gjykata partiake kombëtare
Shoqatat rajonale	Konventa rajonale e partisë	Bordi ekzekutiv Këshilli rajonal	Gjykata partiake rajonale
Shoqatat e rrethit / qarkut / e zonave elektorale	Kuvendi i delegatëve të rrethit	Këshilli i rrethit	Gjykata partiake e rrethit
Shoqata lokale / komisionet	Kuvendi i anëtarëve	Këshilli lokal	

Organizimi lokal i partisë është i një rëndësie të veçantë për një parti të qëndrueshme dhe aktive. Këtu, anëtarët mund të jenë aktiv politikisht në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në këtë nivel, ata kanë një kontakt më të thellë me partinë e tyre dhe politikën në përgjithësi. Organizatat lokale partiake duhet që të kryejnë takime të rregullta të anëtarësisë dhe të mbështesin, promovojnë dhe integrojnë anëtarët (e rinj). Ata duhet të ftohen në takimet e partisë, të qarkut dhe ngjarjet shoqërore, si dhe në diskutimet mbi çështjet politike lokale dhe iniciativat lokale, për shembull rindërtimin e banimeve, ndërtimin apo shtrimin e rrugëve, shkollave, zonave për biznes etj.

Organizatat lokale dhe rajonale të partisë duhet që të kenë konventën e tyre politike, nominojnë kandidatët për zgjedhje lokale dhe rajonale, koordinojnë aktivitetet e partisë në nivel lokal dhe rajonal, dhe mbajnë kontakte me organizatat jo-partiake në kontekstin lokal (të tilla si komunitetet fetare, shoqatat qytetare dhe profesionale etj). Ato duhet që gjithashtu të zhvillojnë pozicionet e tyre lokale partiake (në përputhje me programin kryesor të gjithë partisë) dhe programeve të qeverisjes lokale. Së fundi, anëtarët në nivel lokal gjithashtu kryejnë fushata për zgjedhjet lokale, rajonale ose kombëtare.

Strukturat organizative lokale të partive kontribuojnë në politikat (partiake) autentike, të cilat janë më afër qytetarëve. Pa to, anëtarët dhe simpatizuesit e një partie do të perceptojnë liderët dhe përfaqësuesit e tjerë të lartë vetëm nga një pikëpamje shumë e largët. Strukturat organizative lokale janë "baza e demokracisë partiake". Politikanët e lartë nga nivelet e larta të partisë, parlamentit, apo edhe qeverisë duhet që rregullisht të marrin pjesë në takimet e organizuara me partinë lokale.

Struktura e partisë në nivel të qarkut apo në nivel shtetëror duhet që normalisht të përputhet me strukturën e nivelit të lartë të partisë. Për më tepër, në nivel të qarkut ose atë kombëtar, zakonisht ekziston një Këshill Ekzekutiv i zgjedhur, i cili përbëhet nga kryesuesi, një apo dy zëvendës kryesues, si dhe një arkëtar (shih Figurën 2 dhe Figurën 3). Nivelet e tjera të larta të organizimit të partisë (rajonal apo kombëtar) zakonisht përbëhen nga sekretari ose sekretari i përgjithshëm, të zgjedhur nga konventa e partisë përkatëse. Ndërsa udhëheqësit e partisë, ndonjëherë si rezultat i aktiviteteve të tyre të shumta si anëtarë të parlamentit, ministra, kryeministra ose presidentë, veprojnë më shumë në rolin e një „pjese dinjitoze" të partisë, sekretari i përgjithshëm është „pjesë efikase e partisë„. Sekretari i përgjithshëm udhëheq selinë e partisë në punët ditore të partisë; është përgjegjës për komunikimet e partisë me palët e jashtme dhe të brendshme, dhe gjithashtu është përgjegjës për promovimin e diskutimeve rreth programit dhe organizimit të fushatave elektorale.

Ligjet e Partisë Demokratike kërkojnë që pozicionet e bordit në të gjitha nivelet partiake të vendosen nga zgjedhje të rregullta partiake të brendshme që mbahen në konventat apo kongreset e partisë. Kjo i referohet konventës partiake në nivel lokal, të qarkut ose shtetit si dhe në nivel kombëtar. Nëse është e mundur, në nivelin organizativ lokal, të gjithë anëtarët e partisë duhet që të marrin pjesë në zgjedhjen e drejtuesve lokal. Në nivelet e tjera të partisë, mund të ekzistojë një sistem në zgjedhjen e përfaqësuesve. Konventat e partisë janë formalisht organe të larta vendim-marrëse në çdo nivel të organizmit partiak. Anëtarët e bordit në mesin e tyre zgjedhin Bordin Ekzekutiv, Zyrën – e cila është qendër e madhe për organizime partiake, në nivel rajonal apo provincial dhe në nivel kombëtar. Në mënyrë të ngjashme, kandidatët për emërime politike dhe zyrat publike (për shembull,

kandidatët për vende parlamentare, kryetari i komunës, guvernatorët, kryeministrat e rajoneve apo shteteve federale, kryeministri/ja ose presidenti/ja e shtetit) duhet që të legjitimohen nga zgjedhjet e brendshme partiake.

Partitë duhet që të udhëhiqen në mënyrë profesionale dhe duhet që të jenë të pajisura me teknika moderne të komunikimit. Selia e partisë është në krye të organizimit të partisë. Baza për presidentin e partisë si dhe këshillin e partisë është selia e partisë. Kjo duhet që të ketë disa departamente "teknike" që përqendrohen në çështje të caktuara për të përgatitur qëndrimet e partisë mbi temat aktuale të debateve politike dhe të u sigurojë anëtarëve të partisë dhe përfaqësuesve informacione dhe argumente. Përveç kësaj, selia e partisë duhet që të kujdeset për komunikim dhe prezantim të partisë. E fundit por jo më pak e rëndësishme, selia e partisë duhet që të organizojë dhe realizojë fushatat elektorale.

Figura 2: Harta organizative e zyrës qendrore të partisë



Komunikimi dhe koordinimi i selisë së partisë me fraksionin parlamentar dhe parlamentarët është i një rëndësie të veçantë. Në perceptimin e një publiku të gjerë, ata janë përfaqësuesit më të rëndësishëm të një partie dhe kanë ndikim vendimtar në imazhin e saj publik. Në shumicën e shteteve, degët rajonale të partisë gjithashtu luajnë rol të rëndësishëm. Prandaj, komunikimi i përhershëm dhe i rrjedhshëm si dhe koordinimi me grupet rajonale, ka një rëndësi të barabartë për një parti.

Skema e Strukturës dhe Organeve të Partisë

Nuk ekziston asnjë model unik themelor për organizimin e partive politike. Në disa shtete, ka ligje që përcaktojnë kushtet themelore që partitë duhet të përmbushin. Kryesisht, këto në veçanti i referohen respektimit të procedurave demokratike brenda partisë për zgjedhjen e udhëheqësve të partisë dhe disa elementeve të përgjithshme organizative. Sa i përket përbërjes dhe kompetencave të saj, ekziston një gamë e gjerë e zgjidhjeve organizative.
Organizimi hierarkik i një partie politike shpesh korrespondon me ndarjen administrative të një vendi, d.m.th partitë kanë organizata lokale, organizata komunale ose të qarkut, organizata provinciale ose rajonale, dhe në fund një organizatë kombëtare. Parti të shumta, përveç këtyre, bëjnë edhe ndarjet funksionale të cilat janë të ngjashme me ndarjen e tre pushteteve brenda shtetit: gjykata brenda partisë për zgjidhjen e konflikteve (Gjyqësori), e cila mund të ndëshkojë dhe madje dëbojë anëtarët e partisë për veprimet që mund të dëmtojnë imazhin publik të një partie; asamblenë e përgjithshme ose konventat e partisë (Legjislatura); dhe ekzekutivin e partisë (Ekzekutivi). Për më tepër, disa parti kanë një bord të zgjeruar me përfaqësues të organizatave vartëse të partisë. Struktura e partive është paraqitur në diagramin e mësipërm. Figura 1 ilustron ndarjen komplekse gjeografike dhe funksionale të një partie politike (duke mos përfshirë asociacionet ndër-partiake dhe grupimet e veçanta të partisë). Ajo gjithashtu tregon rrugët legjitime brenda partisë që korrespondojnë me parimin e legjitimitetit demokratik të liderëve nga pozitat më të ulëta deri tek ato më të larta të hierarkisë partiake.

Përveç komitetit të përgjithshëm, shumë parti kanë komitete të tjera, komisione, komitete teknike dhe grupe punuese për detyra specifike, për shembull, për diskutimin e çështjeve programore (politikat ekonomike, politikat e brendshme, politikat e jashtme etj) si dhe për pjesëmarrjen e grupeve specifike (të rinj, gra, sindikata, politikanë lokalë, qytetarë të klasës së mesme, ndërmarrës, të moshuar etj). Këto komitete luajnë një funksion të rëndësishëm në jetën e brendshme të partive dhe imazhin e tyre të jashtëm. Në anën tjetër, ato plotësojnë dhe rregullojnë parimin rajonal të anëtarësimit dhe integrimit të anëtarëve sipas interesave të tyre të veçanta, kualifikimeve të tyre profesionale apo statusit të tyre social. Brenda partisë, këto komisione luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe formimin e mendimit politik. Nga ana tjetër, komitetet japin kontribut të rëndësishëm për të kontaktuar me grupe shoqërore të shumëllojshme, të cilave kontaktet u tregojnë se shqetësimet e tyre janë marrë parasysh dhe janë të përfaqësuara nga partitë.

Në disa shtete partitë kanë promovuar krijimin e organizatave të reja në mjedisin e tyre, të cilat kryejnë aktivitete politike edukative për anëtarët e partisë dhe qytetarët e interesuar si dhe mbështesin zhvillimin e programit dhe koncepteve të partisë përmes hulumtimit dhe konsulencës. Institucionet më të njohura të këtij lloji janë fondacionet politike në Gjermani.

2.2.Anëtarët e një partie politike

Anëtarët janë pjesa themelore e çdo partie dhe konsiderohen të jenë lidhja më e rëndësishme me shoqërinë. Partitë moderne dhe të suksesshme kërkojnë një numër të madh të anëtarëve që preferohen të jenë nga një pjesë e madhe e grupeve shoqërore. Fuqia e anëtarëve ka një efekt të drejtpërdrejtë në formimin e opinionit brenda partisë. Në ditët e sotme anëtarësimi i drejtpërdrejtë i personave është një mënyrë e përbashkët e anëtarësimit në një parti.

Megjithatë, kanë ekzistuar dhe ende ekzistojnë parti me rregullore të tjera rreth anëtarësimit. Njësitë themelore të partive komuniste, për shembull janë organizuar shpesh përmes qelizave të përbashkëta dhe sipas profesionit të anëtarëve të saj në kompani dhe autoritete. Partia Laburiste Britanike, është shembulli më i njohur i anëtarësimit pjesërisht indirekt. Deri në vitet 1990, partia kishte 350,000 anëtarë direkt dhe rreth 4 milion anëtarë "indirekt" që janë njohur si "Sindikatat e anëtarësuara të tregtisë" dhe organizata të tjera. Këta anëtarë kanë paguar një kontribut në Partinë Laburiste dhe kanë kontrolluar 50% të votave në konventat e partisë.

Anëtarët e një partie kanë ndikim më të madh politik sesa qytetarët të cilët nuk i përkasin ndonjë partie. Ata mund të marrin pjesë në formimin e opinionit brenda një partie, e cila mund të jetë ose arrijë në pushtet. Një parakusht për këtë formë të pjesëmarrjes është që partitë të ofrojnë mundësi të mjaftueshme për diskutime brenda partisë dhe formimin e mendimit.

Edhe nëse demokracia brenda partisë dhe formimi i opinionit funksionojnë në mënyrë të përkryer, jo të gjithë anëtarët e partisë do të jenë në gjendje ose të gatshëm që të marrin pjesë në mënyrë aktive në të gjitha vendimet e rëndësishme të një partie Për më tepër, në nivelin lokal, pjesëmarrja aktive dhe kontributi në punën e partisë realizohet kryesisht nga një grup i vogël i anëtarëve. Këta janë kryesisht "bartësit e pozitave" që zënë pozita politike për shkak të pushtetit të tyre që mandati u ofron.

Megjithatë, ekzistojnë mundësi të ndryshme për pjesëmarrje aktive nga anëtarët e "zakonshëm" që i tejkalojnë kufijtë përtej shpërndarjes së panove gjatë fushatave zgjedhore. Ata kanë mundësi të marrin pjesë në diskutimet e brendshme politike dhe munden që edhe vetë të organizojnë forume politike. E fundit por jo më pak e rëndësishme,

ata zgjedhin kandidatët e partisë për zgjedhje (Për fat të keq, ky nuk është rasti në të gjitha partitë, por në partitë e organizuara në mënyrë demokratike anëtarët duhet të marrin pjesë në zgjedhjen e kandidatëve!) dhe padyshim, çdo anëtar i partisë duhet të ketë shansin për të konkurruar për mandat zgjedhor.

Politikat lokale tashmë janë përmendur si fusha ku anëtarët e partisë aktivisht mund të kontribuojnë më së shpeshti dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë për organizimin e partisë. Për më tepër, politika lokale është një "mjedis mësimi" i rëndësishëm i politikës, ku anëtarët e partisë kualifikohen për pozita më të larta.

Parlamentarët dhe anëtarët e qeverisë janë zakonisht anëtarët e shquar të partisë. Ky është rasti në nivel kombëtar dhe lokal.

Këta politikan, në shumë parti, zakonisht ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë dhe në shumë raste edhe mbizotërues. Dallimet në opinionet në mes të bartësve të mandatit dhe udhëheqësve të partisë si të tilla janë mjaft të shpeshta në të gjitha nivelet e një partie. Në raste të konfliktit, delegatët dhe zyrtarët e qeverisë mund të tërhiqen përkohësisht nga udhëzimet e partisë për shkak të dispozitave kushtetuese (për shembull, "mandati i pavarur"). Në praktikën politike, megjithatë ky konflikt është zgjidhur përmes bashkimit personal të partisë dhe mandatit. Parlamentarët udhëheqës dhe përfaqësuesit e qeverisë (nëse ata janë ministra të qeverisë qendrore ose kryetarë ose drejtorë të autoriteteve lokale) janë zakonisht të pranishëm edhe në bordin ekzekutiv dhe komitetet kryesore të tjera të partisë.

2.3. Rekrutimi i anëtarëve të rinj

Partitë me një bazë të madhe të anëtarësimit kanë shanse më të larta të pjesëmarrjes me sukses në garën politike, për të fituar zgjedhjet dhe për të ushtruar ndikim në formimin e opinionit politik. Por si munden partitë të fitojnë anëtarë të rinj?

Shumë njerëz janë të interesuar në politikë, sepse e dinë që kushtet e tyre të jetesës janë të përcaktuara nga vetë partitë prandaj dëshirojnë të kontribuojnë dhe marrin pjesë në vendime në mënyrë më të drejtpërdrejtë. Shumë nga këta njerëz presin që partitë të u afrohen atyre.

Kontakti personal është mënyra më e mirë për t'iu qasur njerëzve të interesuar politikisht dhe për t'i bindur ata që t'i bashkohen një partie. Një vizitë në shtëpi e cila është përgatitur me kujdes dhe kryer me edukatë dhe maturi mund të lehtësojë vendimin e njerëzve që të bashkohen në një parti. Prandaj "promovuesi" duhet që të sjellë dhe prezantojë disa dokumente të partisë: publikime të partisë(për shembull, programin themelor dhe atë më të fundit të zgjedhjeve), një letër prezantuese nga lideri partiak, një formë të anëtarësimit dhe disa materiale reklamuese së bashku me materiale të tjera të partisë

Një tjetër formë e tërheqjes së anëtarëve është me anë **të organizimit të ngjarjeve publike, prezantimeve ose debateve publike, festimeve** në raste të veçanta, dhe aktiviteteve kulturore, ku mund të ftohen njerëzit të cilët priten të jenë më afër pozitës politike në një parti.

Diskutimet publike mbi tema të politikës lokale në përgjithësi tërheqin vëmendje të madhe dhe japin partisë mundësinë për të prezantuar qëndrimin e saj politik dhe për të fituar ndjekës dhe anëtarë rinj.

Format e integrimit të jo-anëtarëve në një parti

- Sigurimi i informacioneve të rregullta dhe të plota për jo-anëtarët e interesuar në lidhje me pozitat dhe aktivitetet e një partie (kushtet: partia duhet që të ketë informacione për personat e interesuar në aktivitetet e saj)
- Pjesëmarrja e "anëtarëve të pavarur" në grupe punuese, grupe projektuese ose komisione me të drejtë vote, të drejtën për peticion dhe të drejtën për të folur për grupet e tilla punuese në konventat e partisë
- Sondazhet e anëtarësimit mbi tema specifike dhe vendimet në drejtimin politik
- Zgjedhjet parësore për udhëheqësit e partisë dhe kandidatët; prandaj, të gjithë anëtarët duhet që të jenë pjesë e këtyre vendimeve të personelit përmes zgjedhjeve
- Kandidatura për jo-anëtarët në listat e partive, e cila duket veçanërisht e mundur në nivel lokal

Partitë politike duhet që të përmbahen nga fushatat e shtrenjta reklamuese për të tërhequr anëtarë të rinj ose të paguajnë "promovues". Përvoja tregon se lidhja në mes të kostove dhe përfitimeve ka një raport të pafavorshëm kur një parti përpiqet që të tërheq anëtarë të rinj përmes reklamave. Pagesa e reklamuesve shpesh çon në një qëndrim kur të dyja palët, anëtarët e rinj dhe reklamuesit janë më të interesuar në konsideratat financiare sesa në atraktivitetin e politikave dhe programit të një partie. Vetëm ato parti që sinqerisht përpiqen të trajtojnë problemet specifike, zhvillojnë koncepte afat-gjata, mbështeten në vlera fundamentale, u ofrojnë anëtarëve potencial perspektivë reale për pjesëmarrje dhe ofrojnë një perspektivë të qartë për të fituar pushtet politik do të jenë më tërheqëse.

Partitë duhet që t'i kushtojnë vëmendje të veçantë bazës së të dhënave të anëtarëve të saj—dhe nëse është e mundur duhet që të kenë një bazë të të dhënave për qytetarët e interesuar të cilët nuk janë anëtarë të partisë.

Menaxhimi korrekt dhe freskimi i bazës së të dhënave ka një rëndësi tejet të lartë, pasi që mund të përdoret për qëllime të ndryshme (si shpërndarja e informacioneve politike, ngritja e fondeve, dhe mbështetja gjatë fushatës elektorale). Përveç adresës postare,

numrit të telefonit, adresës elektronike, Facebook-it dhe komuniteteve të tjera, adresës së Twitter-it dhe profesionit të secilit anëtar, duhet që të përshihen informacione shtesë rreth interesave të veçanta të secilit anëtar, eksperiencës së tij apo të saj në fusha të ndryshme dhe anëtarësimi i tij apo saj në organizata ose asociacione të tjera. Kjo i mundëson partisë që në mënyrë specifike të informojë anëtarët mbi tema të veçanta dhe ti mobilizojë ata për aktivitete politike në fushat e tyre përkatëse të interesit

2.4. Edukimi dhe trajnimi i anëtarëve të partisë

Në demokracinë moderne masive, partitë politike, udhëheqësit dhe anëtarët e saj duhet që vazhdimisht të përballen me çështje dhe pyetje të reja dhe të marrin pozicione në funksionet e zhvillimeve ditore aktuale dhe ndryshimeve shoqërore. Prandaj është e domosdoshme që partitë të ndërmarrin hapa parandalues në mënyrë që të përgatitin përfaqësuesit e saj dhe anëtarët për sfida të reja si dhe marrjen e përgjegjësive brenda dhe jashtë partisë. Kjo është detyra e edukimit politik.

Edukimi politik brenda partisë është veçanërisht i suksesshëm kur drejtohet ndaj anëtarëve të rinj të partisë. Masat e trajnimit duhet që të përmbajnë tre fusha:

Çështjet e trajnimit politik

- Vlerat themelore dhe parimet e partisë
- Të kuptuarit e çështjeve politike (politikat lokale, ekonomike dhe sociale etj)
- Përgatitja për punë politike brenda partisë, dhe për marrjen e funksioneve politike në parlament (retorika politike, përgatitja e funksioneve, trajtimi i Medieve, promovimi i anëtarësisë, kryerja e fushatave zgjedhore dhe ngritja e fondeve)

Shumë parti kanë një përfaqësues për trajnime brenda partisë i cili është përgjegjës për zhvillimin e një programi koherent dhe të vazhdueshëm të masave edukative politike dhe për monitorimin e implementimit të saj.

Pjesëmarrja e liderëve të shquar partiak në këto masa edukative kontribuon në zgjerimin e interesit të anëtarëve (dhe ndoshta medias, në rastet kur aktivitete të tilla janë të hapura për publikun). Këto lloje të aktiviteteve janë impulse të rëndësishme për angazhimin në dhe për një parti. Prandaj udhëheqësit e partisë duhet që të investojnë kohë dhe përpjekje për pjesëmarrjen e tyre në masa të tilla.

Në përgjithësi, puna edukative brenda një partie mund të orientohet në skemën në vijim:

- Organizimi i një programi trajnues koherent dhe të vazhdueshëm
- Përgatitja e një ekipi të trajnimit
- Përcaktimi i objektivave të trajnimit
- Zhvillimi dhe përbërja e materialit të përshtatshëm për masa të ndryshme të trajnimit
- Përzgjedhja e pjesëmarrësve
- Planifikimi i masave, dhe themelimi i kostos dhe Organogramit
- Emërimi i ligjëruesve dhe udhëheqësve

Në shtete të ndryshme partitë kanë krijuar programe të veçanta për edukim politik.

Institucionet për Trajnim dhe Edukim Politik

Më afër Partive Politike

Në shumë shtete, partitë politike kanë krijuar institute të veçanta për edukimin politik të anëtarëve të saj që rregullisht ofrojnë aktivitete trajnuese për anëtarët e partisë (duke përfshirë kurse, seminare, punishte trajnuese

të veçanta, analiza dhe publikime).Institucione të tilla përfshijnë, për shembull, Konrad-Adenauer Stiftung në Gjermani (www.kas.de), Forum for Civic Development Fundacja Obywatelskiego Rozwoju FOR në Poloni (www.for.org.pl/pl), National Democratic Institute (NDI) dhe Republican Institute(IRI) në SHBA (www.ndi.org, www.iri.org), Fundación Rafael Preciado Hernándezas (FRPH) në Meksiko (www.fundacionpreciado.org.mx), Centro Democracia y Comunidad (CDC) në Kili (www.cdc.cl) dhe Youido Institute (YDI) në Republikën e Koresë www.ydi.or.kr

2.5. Programet e Partisë Politike

Programet e partisë përmbushin funksione të ndryshme. Programi themelor i partisë përbën identitetin e partisë dhe ofron një orientim të përgjithshëm për qytetarët dhe votuesit në parimet udhëzuese dhe idetë e një partie. Me programin e saj, partia justifikon ekzistencën e saj dhe shpjegon se si ajo dallon veten nga të tjerët. Programi i partisë ilustron ambiciet politike dhe vlerat themelore, kërkesat dhe sugjerimet e një partie.

Programi i partisë e dallon veten nga dokumentet e tjera të partisë të tilla si programi zgjedhor, i cili përmban sugjerime specifike dhe kërkesat kundrejt zgjedhjeve të caktuara dhe për këtë arsye duhet që të ri-projektohet në çdo kohë. Një program partiak ka karakter afatgjatë. Nuk i referohet çështjeve të një debati aktual politik. Kjo duhet të bëhet nga programi zgjedhor ose plani i veçantë i veprimit, të cilat janë të shkruara në një perspektivë afat-shkurtër për qëllime elektorale dhe të tjera të debateve aktuale publike.

Çdo parti politike duhet që ti kushtojë vëmendje të veçantë hartimit të programit të saj themelor. Ajo duhet të ftojë një numër të lartë të bashkëpunëtorëve në përpunimin e tij ose të paktën në miratimin e tij. Sa më shumë anëtarë që integrohen në procesin e hartimit të programit të partisë, do të jetë më mirë dhe po ashtu në këtë mënyrë do të mbrohen linjat themelore të partisë në diskutime publike.

Për të elaboruar dhe realizuar programin e vet partiak, shumë parti zgjedhin për të formuar një komision të posaçëm që vendos mbi temat që duhet të përmenden në program dhe përpunojnë një draft të parë, i cili mund të paraqitet tek partia tjetër ose komitetet e ekspertëve. Një program i avancuar i projektit mund të paraqitet për diskutim për të gjithë anëtarët e partisë. Nëse programi i ri diskutohet përfundimisht dhe miratohet nga konventa kombëtare partiake, partia do të arrijë një shkallë të lartë të ndërgjegjësimit publik.

Përveç programeve të tyre të përgjithshme, disa parti kanë gjithashtu **programe të veçanta** ose **dokumente që përcaktojnë pozitën** dhe pikëpamjet e tyre politike në lidhje me politika të veçanta, duke përfshirë, për shembull politika ekonomike, të energjisë, politika për gra, të rinj ose familje, politika rurale dhe kulturore. Një aspekt i veçantë i atraktivitetit të këtyre programeve ose dokumenteve pozicionuese është se ato mund të zhvillohen me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të atyre sektorëve që ata adresojnë. Kjo kontribuon në një marrëdhënie të fortë midis partisë dhe këtyre sektorëve.

Programi zgjedhor është hartuar me zgjedhje të veçanta dhe mund të përmbajë propozime dhe kërkesa në lidhje me aktivitetet e ardhshme që një parti mund të zhvillojë pas formimit ose bashkimit në qeveri. Programet elektorale duhet që të shkruhen para çdo zgjedhjeve. Normalisht, ato janë shkruar në kontakt të ngushtë me kandidatët kryesorë të një partie të cilët pastaj janë përgjegjës për vënien përpara të pikëpamjeve të tyre politike për publikun.

Në shumë vende, shumë parti nuk bëjnë shumë përpjekje në zhvillimin e një programi partiak dhe i kushtojnë pak vëmendje, pasi që ata identifikohen kryesisht përmes përfaqësuesve të tyre se sa programeve të tyre. Megjithatë, ato nuk duhet të nënvlerësojnë rolin e një programi gjithëpërfshirës për profilizimin dhe identifikimin e anëtarëve të saj me partinë. Programi i partisë shpalos pikëpamjet themelore të partisë para anëtarëve të partisë dhe përfaqësuesve, si dhe ndaj qytetarëve dhe votuesve dhe kjo dëshmon nëse një parti mund të përkthej shqetësimet sociale në sugjerime politike dhe programe. Prandaj secila parti duhet që ti jap rëndësi më të madhe hartimit të një program koherent. Për më tepër, diskutimi për programin e një partie duhet që të bëhet në një kornizë më të gjatë kohore, me qëllim të përditësimit të programit të partisë, duke ofruar kështu një mundësi për të udhëhequr debate programatike brenda partisë dhe me grupime të tjera shoqërore.

2.6. Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm

Komunikimi i "mirë" është i një rëndësie qendrore për çdo parti politike. Kjo përfshin komunikimin me votuesit dhe shoqërinë si një tërësi, si dhe komunikimin e brendshëm me anëtarët e saj brenda partisë. Vetëm ato parti me një sistem efikas të komunikimit të brendshëm janë të afta për komunikim efikas të jashtëm.

Komunikimi i qëllimeve politike dhe kërkimi i pëlqimit publik gjithmonë ka qenë pjesë e kërkesave kryesore për lidershipin politik në demokraci. Megjithatë, që nga fillimet e demokracisë partiake moderne, kushtet dhe manifestimi i komunikimit kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Sot, ka mjaft kërkesa të reja në lidhje me komunikimin dhe udhëheqjen publike. Kjo nuk i referohet vetëm disa aspekteve të ashtuquajtura "menaxhimi i medieve", por gjithashtu edhe aktiviteteve të ndryshme të tilla si garancia e "aftësisë së medieve" të vendimmarrësve të mëdhenj, lansimi strategjik i informacioneve në media ose përshtatja e aparatit të partisë kundrejt presionit kohor të intensifikuar në mënyrë drastike përmes komunikimit masiv të komercializuar. Ndryshimi i pritjeve të shoqërive demokratike të cilat janë të lidhura për legjitimitetin, janë po aq të rëndësishme: Legjitimiteti i pushtetit politik sot është shumë më i lidhur me aftësitë e komunikimit sesa disa dekada më parë. Retorika e lidershipit në këtë kontekst është e një rëndësie të veçantë.

2.6.1. Komunikimi me shoqërinë

Komunikimi profesional në mes të vendim-marrësve politik dhe publikut është rritur në mënyrë progresive në një faktor të pushtetit. Prandaj, pushteti politik është përcaktuar si një produkt i kapacitetit për të ndikuar në opinionin publik dhe aftësinë për të siguruar pozitën e dikujt në pushtet nëpërmes vendimeve të favorshme, të zgjuara dhe strategjike. [6]

Shtrirja dhe efektiviteti i mesazheve të transmetuara në media është rritur ndjeshëm. Politikanët orientojnë veten në klimën e mendimit politik; persona shumë të rëndësishëm politik komunikojnë drejtpërdrejtë me publikun përmes TV-së, radios, shtypit dhe komuniteteve të reja në internet si Facebook-u, Twitter-i dhe mjete të tjera pa përdorimin e aparaturës së tyre partiake. Lidhja me agjentët e marrëdhënieve me publikun (gazetarët, anketuesit, dhe konsulentët) dhe shkyçja nga organizimet partiake shpie në një vlerësim të lartë dhe ndonjëherë në mbi-vlerësim të marketingut politik në krahasim me punën e vërtet programatike të partisë.

Si rezultat, qëllimet personale afat-shkurtra strategjike shpesh dominojnë kundër qëllimeve afatgjata strategjike organizative[7]. Kjo përforcon udhëheqjen e një partie dhe të një fraksioni parlamentar. Por në të njëjtën kohë, udhëheqësit dhe anëtarët në nivel vartës të organizimit të partisë po humbin shanset për vendimmarrje dhe pjesëmarrje.

Ndryshimi i modeleve të komunikimit të elitës politike mes vete dhe me popullatën, kërkon zotësi mediatike si kërkesë themelore për komunikim politik në demokracinë mediatike. Nën këto rrethana, udhëheqja politike nënkupton "krijimin e vazhdueshëm të shumicës nga grupe të ndryshme të interesit. Në këtë rast racionaliteti i qëllimit të masave të para planifikuara aplikohet së bashku me komunikimin politik dhe racionalitetin e zbatimit.

Prandaj shpesh lidershipi politik është më shumë paraqitje pragmatike se sa menaxhim hierarkik".[8]

Lidershipi nën rrethanat e komunikimit mediatik ka " prodhuar llojin e ri të politikanit yll". Ai dallon veten nga të tjerët duke qenë 'zbavitës' dhe 'krijues', 'mendjemprehtë' dhe 'gazmor', një 'tip fituesi' dhe 'pro-TV-së', dikush 'që mund të udhëheq një emision në medie'. Në këtë rast, ka të bëjë me kërkesat për të fituar prestigj dhe pushtet nëpërmjet televizionit. Megjithatë, sa i përket kapaciteteve të menaxhimit efektive të tyre, këto karakteristika përbejnë vetëm kualifikimet periferike".[9]

Në shumicën e rasteve këto kualifikime i mundësojnë politikanit yll që të gjenerojë vëmendjen e publikut në situata të caktuara. Megjithatë, ata përfaqësojnë,vetëm një pjesë minimale të këtyre karakteristikave që janë të nevojshme për të komunikuar dhe zbatuar reformat. Ata akterë që mbështeten vetëm në këto kualifikime së shpejti do të kenë probleme në ruajtjen e besueshmërisë së tyre. Ata do të humbasin vëmendjen e publikut po aq shpejt sa e arrijnë atë. Akterë të tillë "mund ti japin shkëlqim të jashtëm ushtrimit të pushtetit, por nuk e mundësojnë apo e sigurojnë atë nga brenda. Kjo kërkon kualifikime të ndryshme."

Në fakt reformat kërkojnë që akterët politikë që janë të aftë të gjenerojnë publicitet dhe që shfrytëzojnë vëmendjen në mënyrë strategjike, por mbi të gjitha, ata kanë nevojë për realistë politik që sjellin me vete këmbëngulësi për të ndryshuar strukturat edhe gjithashtu, në qoftë se këto nuk janë të përshtatshme për të zgjidhur problemet aktuale.

Nëse partitë gjithnjë degjenerojnë në një autoritet më të thjesht ekzekutiv të akterëve kryesor dhe nëse ata ose parlamenti ose institucionet tjera legjitime janë të privuara nga pushteti ose janë zëvendësuar nga ekspertë të paguar më mirë, atëherë këto institucione vetëm kanë reduktuar kapacitetet për fillimin e ndonjë reforme. Për më tepër njerëzit humbasin besimin e tyre në këto struktura (parti, asociacione madje edhe në media). Prandaj, reformatorët politikë duhet që të gjejnë guximin për të shkaktuar procese të ndryshimeve në institucione shoqërore dhe të zbatojnë këto ndryshime edhe më tej. Një ngritje e shpejtë e këtyre organizatave mbulon domosdoshmërinë për ndryshime ndër-organizative, me ç'rast zgjidhjet pragmatike janë të nevojshme!

Institucionet shoqërore nuk mund të keqpërdoren si ofruese të imazheve për politikanë individual. Në fakt, institucionet demokratike duhet që të përdoren për të transmetuar çështjet politike. Kjo kërkon komunikim në mënyrë që njerëzit të identifikohen me të. Megjithatë, komunikimi i suksesshëm i reformave nuk zë vend vetëm në mendjen e atyre që kanë lidhje me të, por gjithashtu edhe në institucione demokratike: **Prandaj, një qeveri e suksesshme në demokraci parlamentare kërkon lidership politik të përqendruar brenda dhe jashtë partisë**. Kërkon këmbëngulje në mënyrë që vendimet të komunikohen në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe për të gjeneruar mbështetje nga institucionet e përfshira. Supozoj që votuesit janë më të mençur sesa analistët e marrëdhënieve me publikun!

Komunikimi i jashtëm mund të përfshijë çdo gjë në ofertë nga komunikimi masiv modern dhe marketingu politik. Komunikata të rregullta për shtyp dhe konferenca shtypi, dhe publikimi i buletineve dhe pozicioneve janë bazat për komunikimin e partisë. Në ditët e sotme interneti ka një rëndësi të veçantë për komunikim modern të partisë. Faqja e internetit të partisë duhet që përgjithmonë të përditësohet. Prezenca e partive politike në komunitetet moderne në internet të tilla si Facebook dhe Twitter është e domosdoshme në mënyrë që një parti të japë mesazhet e saj dhe ti paraqesë liderët e tyre për publikun e gjerë. Degët rajonale të partisë duhet që të kenë faqen e tyre të internetit për të komunikuar çështjet me rëndësi lokale dhe rajonale. Platformat vizuale si Youtube mund të përdoren për të shpërndarë mesazhet e partive dhe po ashtu të paraqesin udhëheqësit e tyre.

Përveç kësaj, organizimi i ngjarjeve masive të tilla si kongrese dhe seminare janë një mjet i rëndësishëm për thellimin e kontaktit me anëtarët dhe përfaqësuesit e organizatave shoqërore apo lokale, udhëheqësit e opinionit rajonal dhe kombëtar. Prania e liderëve partiak në emisione televizive dhe radio, si dhe në Facebook dhe Twitter, janë mjete të tjera të rëndësishme për komunikimin e partisë.

Pasi që të gjitha këto forma të komunikimit mund të jenë relevante, padyshim që një diskutim i vogël i një anëtari të "thjeshtë" të partisë me fqinjin e tij, kolegun apo shokun e tij konsiderohet të jetë një instrument shumë i rëndësishëm për kontaktin e përditshëm dhe komunikimin e partisë me shoqërinë e gjerë. Ky lloj i komunikimit të jashtëm mund të jetë efektiv vetëm aq sa komunikimi brenda partiak është efektiv.

Partitë janë hallkë lidhëse në mes të shoqërisë dhe shtetit. Në mënyrë që të zgjedhën dhe po ashtu për të formuluar kërkesat politike për të fituar shumicën në mesin e qytetarëve dhe votuesve, palët duhet që të dinë shqetësimet e shoqërisë. Prandaj kontakti i vazhdueshëm me grupe të shumta sociale dhe asociacione është i nevojshëm. Ky kontakt, i cili është rezultat i kontributit apo anëtarësisë së anëtarëve të partisë në organizata të tjera, duhet që zyrtarisht të organizohet edhe nga partia në intervale të rregullta kohore në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Duke bërë kështu, një parti dërgon një sinjal të rëndësishëm në drejtim të asociacioneve shoqërore.

Një aspekt është i qartë: të gjitha përpjekjet drejt komunikimit teknik ose individual do të jenë të padobishme në qoftë se një palë nuk është e angazhuar për veprimet politike që krijojnë besueshmëri idhe janë të orientuara për një të mirë të përbashkët. Pa koncepte afat-gjata dhe përmbajtje konkrete, të gjitha përpjekjet e komunikimit – edhe nëse ushtrohen në një mënyrë profesionale, do të perceptohen si një shfaqje bosh.

2.6.2. Komunikimi brenda partisë

Komunikimi i brendshëm i partisë është po aq i rëndësishëm sa edhe komunikimi shtesë i partisë. Komunikimi i brendshëm për një parti është i rëndësishëm jo vetëm për të informuar anëtarët e saj, por edhe për të paraqitur pozitat partiake drejt shoqërisë. Ky është një funksion shumë i rëndësishëm i anëtarëve të"thjeshtë". Prandaj, çdo lidership i partisë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të përpiqet të ndërtojë një sistem efikas të komunikimit ndaj anëtarëve të saj.

Brenda shumë partive, komunikimi i brendshëm i partisë nuk bëhet në mënyrë efikase. Ekziston një mungesë e informacionit të rregullt për anëtarët në lidhje me pyetjet aktuale politike. Por si mundet që anëtarët e partisë të përfaqësojnë ose mbrojnë qëndrimet e partisë së tyre në qoftë se ata nuk janë të informuar aq sa duhet për partinë e tyre?

Nganjëherë, ekziston një mungesë e kushteve themelore për komunikim efektiv. Ndodh shumë shpesh që asociacionet rajonale të partisë nuk posedojnë një listë aktuale të liderëve lokal të partisë dhe anëtarëve me të dhëna të plota mbi adresën dhe postën elektronike etj. Gjithashtu ata nuk kanë dijeni për interesat e veçanta të anëtarëve të tyre ose pjesëmarrjen e tyre në organizata të tjera që mund të transformojnë ata në „ambasadorë" partiak të rëndësishëm ndaj klubeve dhe shoqatave të tilla. Prandaj, krerët e partive, duhet që gjithmonë të përpiqen të përmirësojnë komunikimin brenda dhe komunikimin shtesë të partisë. Në këtë kontekst, disa aktivitete janë të një rëndësie të veçantë:

- Kuvende të rregullta të anëtarëve të partisë në nivel lokal me ofrimin e informacioneve dhe diskutimin e zhvillimeve të rëndësishme dhe vendimeve brenda partisë.
- Planifikimi dhe koordinimi i një plani vjetor për komunikim ndërmjet niveleve të ndryshme të organizatës partiake.
- Zgjedhja apo emërimi i një ekzekutivi përgjegjës për komunikim në të gjitha nivelet e organizimit të partisë dhe koordinimi efektiv në mes të ekzekutivëve përgjegjës të komunikimit. Në nivel kombëtar sekretari i përgjithshëm dhe i emëruari i veçantë për komunikim brenda partisë duhet që të jenë përgjegjës për komunikim të brendshëm efektiv. Në nivel rajonal duhet që të emërohen persona me funksione të ngjashme.
- Në të gjitha nivelet e organizimit të partisë, raporte periodike të brendshme mbi zhvillimet e brendshme dhe të jashtme duhet që të përgatiten. Raportet duhet që të dorëzohen në nivelet më të larta të partisë.
- Publikimi i raportit mbi anëtarësinë ose revistës së partisë, e cila duhet të shpërndahet në mesin e të gjithë anëtarëve të partisë.
- Mbulimi duhet që të përbëhet nga tema aktuale politike të cilat shqyrtohen nga partia, si dhe informacione të rëndësishme mbi ngjarjet brenda partisë; për më tepër, një hapësirë e caktuar duhet ti jepet anëtarëve të partisë për të kontribuar në diskutime.
- Vlerësim i vazhdueshëm i efikasitetit të komunikimit të brendshëm.

2.7. Demokracia brenda partiake

Demokracia brenda partiake është e nevojshme në mënyrë që të rritet ndikimi dhe kontributi i qytetarëve të përfshirë politikisht në parti. Një shtet demokratik nuk mund të qeveriset nga parti me struktura jodemokratike. Prandaj në shumë vende ekzistojnë udhëzuesit ligjor që obligojnë partitë që gjithashtu të respektojnë procedurat demokratike në proceset e tyre të brendshme. Megjithatë, në realitet kjo shumë shpesh shpërfillet.

Në shumë vende, kushtetuta apo ligjet, i obligojnë partitë që të formësojnë proceset e tyre të brendshme sipas procedurave demokratike. Megjithatë, pavarësisht nga të gjitha dispozitat e tilla ligjore, ndikimi i anëtarëve të "thjeshtë" të partisë është relativisht i kufizuar edhe nga qarku i anëtarëve që janë me të vërtet të fuqishëm me ç'rast ndikimi është zakonisht i vogël. Arsye për këtë është mungesa e interesimit në mes të anëtarëve që të marrin pjesë në mënyrë më aktive. Në raste të tjera, burokratizimi i aparatit partiak ka rezultuar me një distancë të caktuar – nëse jo me tjetërsim në mes të udhëheqësve të partisë dhe anëtarëve të partisë. Kjo së paku është për shkak të natyrës së veçantë të masave moderne të demokracisë që kërkojnë procese të shpejta të vendimmarrjes, e cila nga ana tjetër nuk lejon procese të gjata të votimit brenda partisë. Megjithatë, përvoja tregon se ata që investojnë kohë dhe mund në punët e partisë në fakt mund të fitojnë ndikim brenda partisë.

Ligji i Hekurt i Oligarkisë

Në një punim klasik mbi hulumtim e partisë Robert Michels e kishte demonstruar " ligjin e hekurt të oligarkisë" ("Sundimin e disave")10. Sipas hulumtimit, secila organizatë pashmangshëm e sjell në jetë një klasë sunduese të cilën nuk mund ta kontrolloj në mënyrë efikase në një afat të gjatë. Rrjedhimisht, liderët e partisë dhe strukturat e partisë gjithashtu bëhen edhe më shumë të pavarura, duke marr parasysh përparimet në teknologjinë e informimit dhe ngritjen e specializimeve të politikës. Akumulimi i përgjegjësive dhe monopolizimi i fuqisë janë simptomat e rritjes të oligarkisë, që përbën një problem për formimin e mendimit demokratik brenda partisë. Përmirësimi në procedurat demokratike dhe në shkëmbimin e pikëpamjeve mund të kontribuoj në largimin e strukturave të ngurta të partisë.

Ndikimi i komisioneve lokale të partive në formësimin e mendimit politik dhe procesin e vendimmarrjes të partisë ndërron varësisht nga natyra e problemeve aktuale. Nuk ka gjithkund ndikim në përzgjedhjen e kandidatëve për parlament. Kjo megjithatë ndryshon nga vendi në vend.

Shumë parti në gjithë botën kritikojnë mungesën e demokracisë brenda partisë, së paku për shkak të rënies së numrit të anëtarësimit. Shumë parti tani po kërkojnë të zbatojnë politika më atraktive për anëtarët aktual dhe të gjejnë stimulime për jo-anëtarët që ti bashkohen partisë së tyre.

Një mundësi është që të hapen në drejtim të jo-anëtarëve dhe tu lejojnë atyre mundësin e pjesëmarrjes në nivele të ulëta të partisë. Megjithatë, përvoja tregon se aktivitetet e jo-anëtarëve në parti janë të pakta. Gjithashtu ekziston rreziku që përfitimet individuale nga anëtarësimi në parti do të ulet nëse jo-anëtarët marrin të drejtat e njëjta, dhe marrin pjesë, për shembull, në vendimet brenda partisë mbi kandidatët. Në çfarëdo rasti, baza e partisë duhet të marr pjesë në vendimet brenda partisë. Qoftë direkt përmes vëzhgimeve të anëtarëve dhe procedurave të votimit apo në formë indirekte me delegatë, secila parti duhet të vendos në bazë të rrethanave të tyre.

Të dy mënyrat janë forma legjitime të demokracisë brenda partiake, edhe në ditët e sotme tendenca e përgjithshme është në favor të pjesëmarrjes së drejtpërdrejt të anëtarëve të partisë. Është e rëndësishme që procesi i përzgjedhjes së liderëve të partisë dhe kandidatëve për zgjedhje të respektoj kriterin demokratik. Këtu, nga parimi, duhet të zbatohet një qasje nga "poshtë-lartë"; kjo është nëse ndonjë parti apo pozitë e zgjedhur është legjitimuar nga organi përkatës zgjedhor brenda partisë. Në shumicën e rasteve kjo është asambleja e partisë, që mund të jetë në nivel lokal, rajonal, apo kombëtar.

Kjo mënyrë e emërimit i mundëson mbajtësit së një zyre që të lidhet me rivalët potencial brenda partisë dhe me ata që kanë legjitimitet nga partitë tjera.

Respektimi i demokracisë brenda partiake nën-kupton

- Promovimin e pjesëmarrjes së të gjithë anëtarëve të partisë në çështjet e brendshme të partisë.
- Mundësinë që anëtarët të shprehin brengat e tyre në kuadër të partisë.
- Mundësi për pjesëmarrje për grupe të veçanta brenda partisë (për shembull, gratë, të rinjtë, dhe njerëzit e klasës së mesme).
- Tolerancë në drejtim të mendimeve të ndryshme përderisa ata janë në kuadër të kufirit të programit bazë të partisë.
- Pajtueshmëri me rregullat dhe rregulloret për pjesëmarrje në anëtarësim dhe proceset e vendimmarrjes brenda partisë.
- Respekti i udhëheqësve të partisë ndaj anëtarëve "të zakonshëm" të partisë.

Demokracia brenda partisë gjithashtu nënkupton që grupi individual brenda-partisë duhet të jetë në gjendje të shpreh në një masë pikëpamjet dhe polemikat e tij në publik. Një parti nuk duhet të trembet nga kjo, edhe pse konfrontimet e hapura të dallimeve në mendime dhe konfliktet në disa raste besohen të jenë një shenjë e dobësisë, besueshmërisë së vogël dhe mungesë e njëzëshmërisë në brenda partisë, në mendjen e partisë dhe popullsisë votuese.

Në rastin ekstrem, është me të vërtet e mundshme që pozitat e ndryshme të jenë aq larg njëra tjetrës sa që energjitë e politikanëve shterohen me ç'rast polemikat e brendshme ndërhyjnë në vizionin e programit të partisë. Në anën tjetër dallimet e brendshme i ushqejnë diskutimet politike. Prandaj, një shenjë e fuqisë mund të jetë kur një parti pranon dallimet në mendime dhe nuk i ngulfat ato për shkak të thirrjes së famshme për unitet.

Sa i përket debateve brenda partisë dhe polemikave ato mund të jenë një demonstrim i një jete të gjallë në parti, dhe në rast të tillë gjatë fushatave zgjedhore partitë duhet të shtyjnë konfliktet brenda partiake dhe të prezantojnë veten më një profil të unifikuar. Të gjitha forcat e partisë duhet të koncentrohen në fushatën elektorale. Për konkurrentët në garat brenda partisë, kjo do të thotë lënie anash e ndjenjave personale dhe respektimi i votës për pretendentët. Megjithatë, shpesh, mund të vërehet e kundërta. Ata kandidat që kanë humbur në garat brenda partiake nganjëherë i krijojnë partitë e veta politike apo platformat zgjedhore, duke dëmtuar marrëdhëniet e tyre me partitë e tyre të vjetra pa përfituar domosdo përparësi të konsiderueshme personale.

2.8. Konfliktet brenda partiake dhe zgjidhjet e konflikteve

Brenda partive, konfliktet mund të ndodhin kohë pas kohe – për shkak të perceptimeve të ndryshme, si dhe për shkak të rivaliteteve personale për pozita dhe ndikim. Këto rivalitete janë të pashmangshme dhe legjitime, por duhet të diskutohen në mënyrë korrekte. Brenda partisë, ka gjithmonë një konkurrencë për fuqi dhe ndikim; kjo është pjesë e biznesit të përditshëm. Megjithatë, në fund, konfliktet e brendshme duhet të vendosen brenda kufijve të demokracisë dhe procedurave transparente. Është shumë e rëndësishme që të gjithë që janë të përfshirë në konflikte të tilla ti respektojnë vendimet demokratike të partisë.

Në disa vende, sidomos anëtarët e shquar të partisë, që gjithashtu mund të kenë mandate në parlament apo të zënë zyra të tjera publike kanë tendencë që të lënë partitë e tyre në rastet kur konfliktet nuk zgjidhen në favor të tyre. Kjo nuk e dëmton vetëm partinë, por gjithashtu është një shembull i sjelljeve të këqija demokratike. Në fund të fundit, demokracia nënkupton që duhet të respektohet shumica, edhe nëse pozita personale është "vetëm" mendimi i pakicës.

Organi formal për zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve ndër partiake janë takimet e partisë dhe konventat, ku dallimet në mendime mund të diskutohen dhe të vendosen në mënyrë demokratike. Instanca e fundit për të vendosur mbi mosmarrëveshjet- normalisht jo mosmarrëveshjet politike – janë gjyqet partiake të cilat në disa shtete janë të kërkuara me ligj apo nga statuset e duhura partiake. Këto gjykata partiake sigurojnë që konfliktet të mund të zgjidhen fillimisht nga brenda, dhe jo para gjykatave publike. Gjyqet partiake kryesisht kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet statusore për anëtarësimin dhe të drejtën e votimit, rishikimit të brendshëm të procedurave të votimit dhe çështjeve të tjera të brendshme apo edhe sanksioneve kundër anëtarëve sjellja e të cilëve nuk është në pajtim me linjën e partisë dhe që mund të kenë shkelur statusin apo vlerat thelbësore të partisë.

Përveç këtyre formave formale të zgjidhjeve dhe ndërmjetësimit të konflikteve, partitë shpesh zbatojnë gjithashtu forma "të buta" të ndërmjetësimit të konflikteve në mes të grupeve rivale dhe individëve. Format më të njohura janë sigurisht ofrimi i ndarjes së pushtetit duke i ftuar rivalët në zyrat e caktuara. Ilustrim i kësaj praktike është ftesa e Presidentit Barak Obama për rivalen e brendshme Hillary Clinton që të jetë sekretare e shtetit. Ai gjithashtu e ka ftuar ekspertin e njohur kundër-partiak Republikan, Robert Gates, që të bëhet sekretar i mbrojtjes. Parimi i vjetër i "përçaj dhe sundo" nuk e ka humbur rëndësinë e tij. Ai ndihmon për të mbrojtur pozitën e vet të pushtetit dhe shpesh ofron për të gjitha palët e përfshira një situatë të ashtuquajtur "fito-fito".

Konfliktet brenda partiake dhe dallimet ideologjike brenda partiake mund të zbuten nga ftesa e grupeve të brendshme rivale dhe përfaqësuesit e tyre në nivelin e menaxhimit të partive politike –ku liderët e partive janë në gjendje të vendosin një formë të arsyeshme të bashkëpunimit, që çon në përfitimin e gjithë partisë. E njëjta gjë vlen për përpjekjet që të integrohen përfaqësuesit e grupeve të ndryshme brenda partiake në këshillin partiak apo në pozitat udhëheqëse. Kjo formë e integrimit të negociuar në menaxhimin e partisë është dëshmuar të jetë më e suksesshme se marrëveshjet e kuotave, të cilat janë më të formalizuara dhe më të kontestuara. Megjithatë, marrëveshjet e kuotës mund të kontribuojnë gjithashtu në përmirësimin e përfaqësimit të grupeve të caktuara në kuadër të një partie.

2.9. Kuota për gratë dhe pakicat

Edhe pse shumica e kushtetutave në të gjithë botën përcaktojnë trajtimin e barabartë të burrave dhe të grave, gratë janë të nën-përfaqësuara në parti në mbarë botën dhe në funksionet udhëheqëse politike. Në shumë vende janë duke u bërë përpjekje që të arrihet një pjesëmarrje më e madhe e grave në politikë. Një kontribut i intensifikuar është një kërkesë themelore për këtë qëllim.

Në mënyrë që ti jepet grave një hapësirë më e madhe për kontribut politik dhe përfshirje, është krijuar një kuotë statusore për gratë në shumë vende me anë të rregulloreve të ndryshme. Zakonisht, qëllimi është që të rezervohet një numër minimal i zyrave partiake dhe pozitave për gratë gjatë zgjedhjeve. Përvoja tregon se rregulloret me kuota të tilla – ku ato funksionojnë!- mund të kontribuojnë në praktikë për një përqindje më të lartë të grave në politikë.

Sidoqoftë, përvoja gjithashtu ka treguar se rregulloret me kuota shpesh nuk vihen në praktikë, kështu që rezulton se nuk ka më shumë gra në parlament se që kishte më parë. Prandaj, duhet bërë përpjekje që të sigurohet që kuotat femërore të hyjnë në fuqi dhe që të ketë një rritje të përqindjes së grave në politik, p.sh gjithashtu në parlament. Kjo është gjithsesi një çështje e kulturës politike që kërkon kohë për tu zhvilluar. .

Disa parti aplikojnë rregulloret me kuota që tu garantojnë pakicave të caktuara bashkëpunim të përshtatshëm në kuadër të shkallës dhe dosjeve të tyre. Politikat për tu garantuar përfaqësimin e pakicave etnike bëhen në dy forma: kuotat për nominimin e kandidatit në partitë politike dhe rezervimi legjislativ. Rezervimi legjislativ përfshin rezervimin e ulëseve për grupe të caktuara dhe vetëm anëtarët e grupit mund të votojnë për përfaqësuesin e grupit.

Kjo çon në një listë të veçantë për votues për pakicat. Ky sistem nuk është shumë i favorshëm në një shoqëri shumë kulturore pasi pengon çfarëdo iniciative për përzierje politike mes komuniteteve. Pjesëmarrja e pakicave etnike apo racore në legjislatura shpesh ngrit pyetjen se në çfarë niveli janë të përfaqësuar këto grupe në parti dhe në legjislatura dhe se në çfarë mase ata mund të ndikojnë në politikë dhe vendimmarrje.

Ka pasur përpjekje të rëndësishme mes partive politike për rritjen e përkrahjes nga pakicat etnike. Ata rekrutohen përmes themelimit të njësive për ndërlidhje etnike nga partitë politike në mënyrë që të rritet profili politik në kuadër komuniteteve etnike. Kjo mund të luaj një rol të rëndësishme në zgjedhjet lokale sepse nëse pakicat etnike nuk marrin pjesën e tyre në përfaqësim, asnjë parti që synon sundimin nuk do të marr përkrahjen e tyre në kthim.

2.10. Financimi i partive

Partitë politike kanë nevojë për burime financiare në mënyrë që të vazhdojnë funksionimin e tyre efikas në frymën e përkrahjes të shoqërisë demokratike, për të marrë ekspertizën, të zhvillojnë programet e tyre dhe ti shpërndajnë ato, të mbajnë një strukturë organizative të qëndrueshme, të kultivojnë komunikimin më anëtarët dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme, të zhvillojnë fushatat zgjedhore. Në rastin ideal, ky financim duhet ti mundësoj partive që të vazhdojnë detyrat e tyre pa qenë financiarisht të varur në një grup interesi apo person.

Pasi nevoja e partive për sistem demokratik është e padiskutueshme, shumë vende demokratike kanë përkrahje financiare nga qeveria për partitë. Kjo përkrahje mund të jetë në formë të grandeve drejtpërdrejt nga thesari (zakonisht si kompensim për shpenzimet e fushatave zgjedhore) apo në formë të përkrahjes jo të drejtpërdrejt përmes zbritjes të taksave të donacioneve për partitë.

Mjetet e të hyrave

- Tarifa e anëtarësimit është burimi më pak kontrovers i të ardhurave. Tarifat janë shenjë e një marrëveshjeje në mes të anëtarëve dhe partisë së tyre . Pagesat e anëtarësimit nuk janë vetëm një burim i rëndësishëm financiar por gjithashtu një shprehje e simpatisë për një parti. Fatkeqësisht, anëtarët e varfër shpesh nuk mund të përballojnë pagesën e tarifave. Dhe nëse ka praktika të paligjshme apo keqpërdorim të fondeve të partisë, ka edhe me pak vullnet që të paguhet tarifa. Prandaj, partitë politike duhet të japin llogari për përdorimin e tarifave të anëtarësimit (si dhe të hyrave të tjera) në mënyrë transparente. Edhe në vende të varfra, partitë duhet të mundohen që të mbledhin disa tarifa të vogla nga anëtarët e tyre- por ato duhet të ofrojnë disa shërbime në kthim. Kur nuk ka mënyrë për të mbledhur tarifat në formë të parave, gjithmonë ekziston mundësia e mbledhjes së "tarifave" në formë të shërbimeve për partinë.

- Kontributet financiare të anëtarëve të parlamentit dhe taksa të ngjashme të zyrtarëve nga partitë; këta persona kontribuojnë për partinë përtej tarifave të tyre të anëtarësimit, pasi që ata i detyrohen partisë së tyre për mandatet apo pozitat e tyre në administratën publike etj.

- Të hyrat nga kapitali, ngjarjet etj; disa parti zotërojnë biznese (për shembull, shtëpi të shtypit për shpërndarjen e dokumentacionit dhe broshurave të partisë etj.) apo kryejnë aktivitetet të tjera nga të cilat gjenerojnë të ardhura. Në parim, ato duhet zyrtarisht të llogaritin të gjitha të ardhurat nga aktivitetet e tilla dhe kapitalin e tyre.

- Donacionet janë burimet më kontroverse publike i financimit të partive. Kjo është sidomos për partitë e mëdha që marrin një pjesë të rëndësishme të ardhurave të tyre përmes donacioneve. Shqetësimi është se donatorët e mëdhenj ekonomik mund të përpiqen të ushtrojnë ndikim politik përgjatë kësaj rruge. Kjo do të kundërshtonte parimet e barazisë demokratike.

- Kreditë janë një burim i rëndësishëm por problematik i financimit të partive politike. Kredit do të dërgojnë në borxhe, dhe për shumë parti borxhet paraqesin një problem serioz. Nuk është e lehtë të zvogëlohen borxhet me mjete ligjore. Nëse është e mundshme, partitë politike duhet të shmangin këtë burim të financimit. Në çdo rast, ata duhet zyrtarisht të llogarisin detyrimet e tyre ndaj institucioneve kredituese.

- Rikthimi i shpenzimeve për fushatën zgjedhore. Kjo është një praktikë e zakonshme e financimit publik të partive. Rikthimi i shpenzimeve të fushatave zgjedhore është zakonisht i lidhur me rezultatin e zgjedhjeve të një partie.

Figura 3: Burimet për financimin e partive politike



Parimet e financimit të partisë

- Partitë duhet për çdo vit edhe zyrtarisht të llogarisin financat e tyre, sidomos në rastet kur marrin fonde publike.
- Tarifat e anëtarësimit duhet të jenë një pjesë e madhe e të hyrave të partisë. Tarifat e anëtarësimit nuk kanë vetëm efekt financiar, por gjithashtu përmirësojnë identitetin dhe e obligojnë udhëheqësin e partisë që të jenë më transparent ndaj anëtarëve të tyre.
- Kontributet qeveritare për partitë duhet të respektojnë parimin e mundësive të barabarta, si dhe ndikimin e zgjedhjeve, që është shprehur nga rezultati i saj zgjedhor.
- Vëllimi total vjetor i kontributit të qeverisë duhet të rregullohet.
- Në lidhje me kontributin qeveritar për partitë, volumi i donacioneve të qeverisë duhet të merret parasysh.
- Kufiri i zbritjes së taksave për tarifat e anëtarësimit dhe donacionet duhet të caktohet sa më ulët që të jetë e mundur.
- Nga një limit i preferuar i ulët e më tej donacionet e partisë duhet të bëhen publike.

Mbledhja e fondeve për partitë

Financimi publik i partive nuk duhet të jetë burimi i vetëm e as kryesor i të ardhurave për partitë. Prandaj, partitë duhet të zhvillojnë aftësinë për të krijuar mjete të duhura të të ardhurave. Kjo është një detyrë qendrore për secilën parti dhe për këtë arsye duhet të marr parasysh kur strukturohen dhe ndahen detyrat brenda partisë.

Në mënyrë që të mblidhen fondet, është e nevojshme një strategji, dhe kjo duhet të zhvillohet nga arkëtari i partisë. Ai duhet të drejtoj dhe koordinojë të gjitha aktivitetet për të mbledhur fonde; për më shumë, ai duhet të koordinohet me arkëtarët rajonalë dhe lokal të partisë. Në të gjitha nivelet e partisë, duhet të jetë një zyrtar për financa (arkëtar) që është përgjegjës për mbledhjen e fondeve. [11]

Mbledhja e fondeve duhet të bëhet përmes një strategjie. Masat e më poshtme, mes tjerash janë dëshmuar të suksesshme:

- Lutjet personale për donacionet që janë bërë nga liderët dhe anëtarët apo nga persona të tjerë të afërt me partinë.
- Letrat personale që nxisin donacionet nga anëtarët dhe njerëz të tjerë.
- Mbledhja e komisionit për mjetet e financimit.
- Organizimi i ngjarjeve të veçanta (festave, ahengjeve verore, ngjarjeve tematike) që gjithashtu mund të përdoren për të kërkuar donacione.
- Thirrja e njerëzve për të kërkuar donacione.
- Vizitat shtëpiake të bëra anëtarëve, korporatave dhe personave nga të cilët priten donacione.

Sa i përket tërheqjes së anëtarëve të rinj, kontaktimi personal është dëshmuar të jetë metoda më e mirë për të kërkuar donacione. Megjithatë për këtë është i nevojshëm një regjistër i menaxhuar mirë i anëtarëve dhe simpatizantëve, që i lejon reklamuesit që të synojnë donatorët potencial drejtpërdrejt. Letrat jo-personale masive zakonisht prodhojnë shpenzime pa efekt. Donacionet gjithashtu mund të sigurohen në formë të punës vullnetare duke ndihmuar që të organizohen evenimente dhe ngjarje informuese, të ashtuquajturat "mbledhje votash në rrugë" gjatë fushatave zgjedhore, apo duke siguruar dhoma të takimit për partitë.

Është veçanërisht e rëndësishme që për donacionet në të holla partia ti shpjegoj donatorëve për çfarë qëllimi do të përdoren donacionet. Kjo është një çështje e transparencës dhe në përgjithësi e rrit gatishmërinë për të dhuruar. Partitë duhet që gjithashtu ti çmojnë donacionet në mënyrë të përshtatshme, për shembull, me një letër personale falënderuese, dhurata të vogla, të ashtuquajtura "dhurata rasti" të tilla si lapsat, fletoret apo çipe USB me logo të partisë, dhe informata të përgjithshme për partinë. Megjithatë, partitë duhet të jenë të kujdesshme që të mos i harxhojnë burimet duke dhënë dhurata bujare. Të gjitha masat e lidhura me mbledhjen e fondeve duhet të përputhen me rregullat ligjore dhe duhet të respektojnë parimin e transparencës.

Partitë politike dhe marrëdhëniet e tyre me shoqërinë civile dhe grupet e interesit

Nga gjeneza e tyre në shekullin XIX-të, partitë politike kanë qenë fillimisht organizata shoqërore

Në veçanti, partitë Evropiane (Perëndimore) u shfaqën si një shprehje e organizuar e konfliktit shoqëror dhe politik. Organizatat liberale, konservative, rurale dhe social demokrate u përpoqën që të riafirmojnë pozitat e tyre dhe përmes organizimit të partive. Përmes pjesëmarrjes në zgjedhje, përfaqësimit në parlament dhe pjesëmarrja në qeveritë e zgjedhura në mënyrë demokratike, ata kërkuan që të zbatojnë reformat politike dhe shoqërore. Nga origjina e tyre por edhe nga orientimi i tyre parlamentar dhe dëshira për të arritur në zyrat publike, deri më sot partitë politike janë të pozicionuara mes shoqërisë civile, parlamentit dhe qeverisë.

Në një mënyrë të caktuar, partitë politike mund të konsiderohen si organizata politike të shoqërisë civile që e përmbledhin interesin e një grupi të veçantë (apo disa grupeve), i artikulojnë dhe përfaqësojnë ata. Përmes pjesëmarrjes në zgjedhje demokratike, ata dëshirojnë që të paraqesin këto interesa tek përfaqësuesit dhe institucionet formale të politikës.

3.1.Partitë dhe shoqëritë civile

Partitë zakonisht themelohen në dy mënyra: nga elita shoqërore që mbledhin për rreth tyre një grup të përkrahësve me ndikim që të mbrojnë pozitat e tyre, apo me qytetar që kërkojnë mbështetjen e personave me mendim të njëjtë në mënyrë që të arrijnë një ndryshim politik apo shoqëror. Në rastin e parë, më shumë është një qasje nga lart-poshtë për ndërtimin e partisë, siç ka qenë rasti me partitë e para liberale të cilat ishin të bazuara në komisionet zgjedhore të formuara lirshëm që aplikonin për përfaqësim parlamentar.

Këto mënyra të krijimit të partive politike nuk janë tipike vetëm në historinë e partive të Evropës Perëndimore në fund të shekullit XIX-të. Lëvizjet reformuese në ish-vendet komuniste të Evropës Lindore, si "Karta 77" në Çekosllovaki, "Solidarnosc"; lëvizjet për sindikatën dhe reformat shoqërore në Poloni, apo lëvizja demokratike e qytetarëve në ish-Gjermanin Lindore, të tilla si "Iniciativa për paqe dhe të drejta të njeriut", "Forumi i ri" dhe "Nisma demokratike", kanë dal nga shoqëritë civile dhe më vonë janë kthyer në parti politike apo u janë bashkuar partive politike ekzistuese.

Që nga viti 1990, në kontekst të rritjes së kritikave të përgjithshme mbi partitë politike nga aktivistët socialist por gjithashtu edhe nga shkencëtarët shoqëror, me këtë rast ka filluar një debat intensiv ndërkombëtar mbi konceptin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes. Ekzistonte një perceptim i përgjithshëm për një krizë të demokracisë të fokusuar në një krizë të përfaqësimit dhe institucioneve dhe aq më pak të partive politike. Në kuadër të këtij debati, zgjerimi i pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë duket të jetë një kurë për të gjitha masat që të zëvendësoj të gjitha parimet e papërcaktuara të përfaqësimit. Organizatat e shoqërisë civile, të tilla si; iniciativat qytetare apo "lëvizjet e reja shoqërore" (lëvizjet; paqësore, e grave, mjedisore) janë bërë një sfidë për partitë duke pasur parasysh pamundësinë e tyre që të zgjidhin problemet ekzistuese dhe për shkak të demobilizimit të anëtarëve të tyre. Numri i iniciativave dhe lëvizjeve të tilla, në shumë raste, të ashtuquajtura "lëvizje për një çështje të vetme", është ngritur ndjeshëm në dy dekadat e fundit. Në disa shtete partitë e reja politike janë formuar të përqendruara vetëm në një apo disa çështje (partitë kundër imigracionit, "partitë e internetit" etj). Në shumë raste, partitë politike tradicionale i kanë integruar çështjet e reja, si mbrojtja e mjedisit, energjisë alternative, dhe zhvillimit të qëndrueshëm etj. Këto çështje në ditët e sotme janë pjesë e programeve të partive të themeluara. Në anën tjetër, disa nga lëvizjet e reja të shoqërisë kanë marr përsipër funksionet partikae, kryesisht artikulimin dhe përfaqësimin e interesave shoqërore. Megjithatë, në vitet e fundit ka pasur shenja të zhgënjimit të organizatave të shoqërisë civile në lidhje me mundësit dhe kapacitetet e tyre dhe rritjen e pëlqimit për nevojën e arritjes së një balance të arsyeshme në mes të përfaqësimit dhe pjesëmarrjes.

Është dëshmuar që demokracia masive mund të funksionoj vetëm në formë të demokracisë përfaqësuese dhe partitë në fund të fundit janë të vetmet institucione që legjitimohen me pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet e përgjithshme, duke arsyetuar përfaqësimin dhe legjitimitetin e tyre përmes pjesëmarrjes së tyre në këto zgjedhje.

Organizatat e shoqërisë civile zakonisht nuk janë në gjendje të dëshmojnë përfaqësimin e tyre të drejt (përveç nëse janë shoqata me klientelë të përcaktuar qartas). Atyre gjithashtu ju mungojnë strukturat, proceset, përvojat dhe gjithashtu personeli i nevojshëm për të ushtruar funksionet klasike të partive politike, të tilla si; legjitimimi, përzgjedhja e kandidatëve dhe më e rëndësishmja nga të gjitha qeverisje demokratike. Organizatat e shoqërisë civile nuk mund ti zëvendësojnë partitë politike.

Megjithatë, duhet të theksohet se organizatat e shoqërisë civile ofrojnë një kontribut të proceseve politike dhe stabilizim të demokracisë në secilën shoqëri. Një numër më i lartë i organizatave të shoqërisë civile dhe rritja e rëndësisë së tyre në të gjithë botën, dëshmon që praktikisht një pjesë e rëndësishme e qytetarëve dëshiron të merr pjesë në proceset politike. Mirëpo edhe në fushën e organizatave të shoqërisë civile mund të vërehen tendenca të ngjashme si ato të partive politike: janë dobësuar institucione tradicionalisht të fuqishme, siç janë; sindikatat e punës në ditët e sotme, numri i madh i organizatave nuk është medoemos dëshmi e ndikimit më të madh, por një indikator i ndarjes së tyre; shumë nga këto organizata nuk janë as transparente dhe as nuk i respektojnë rregullat demokratike në procedurat e tyre të brendshme; ato janë zakonisht të dobëta sa i përket organizimit dhe rrallëherë i përmbushin marrëdhëniet afatgjate me anëtarët e tyre; shumë shpesh identifikimi me to është jetëshkurtër. Pra, demobilizimi i partive vetëm pjesërisht kompensohet nga organizatat e shoqërisë civile.

Organizatat e shoqërisë civile mund të kryejnë funksione të caktuara që zbatohen gjithashtu edhe për partitë. Megjithatë, ato nuk mund të përmbushin funksionin më të rëndësishëm të partive; pjesëmarrjen në zgjedhjet e përgjithshme, që jo vetëm që i siguron partive pjesën e tyre të pushtetit politik por në të njëjtën kohë u siguron atyre përfaqësim.

Në të kundërtën përfaqësimi i organizatave të shoqërisë civile mbetet i paqartë edhe pse ato janë në gjendje të lëvizin turma të mëdha për raste të veçanta. Organizatat shoqërore mund të dëshmojnë mbështetjen e tyre të vërtetë brenda shoqërisë vetëm nëse transformohen në parti politike.

3.2. Partitë dhe asociacionet

Grupet e interesit janë një formë e veçantë e organizimit të shoqërisë civile. Ato organizojnë dhe i artikulojnë interesat shoqërore të secilit qytetarë, grupeve shoqërore apo të organizatave të tjera shoqërore siç janë: shoqatat e bizneseve apo sindikatat. Në kontekst të krijimit të politikave institucionale dhe strukturave vendimmarrëse ato ushtrojnë funksione të artikulimit të interesave dhe ndërmjetësimit. Ato kryejnë funksione të ngjashme si partitë politike. Megjithatë, fokusi i tyre shtrihet në një sektor të veçantë, përkundër përfaqësimit të përgjithësuar politik dhe territorial të partive.

Grupet e interesit karakterizohen nga vetitë e veçanta organizative dhe funksionale si dhe nga modele të veçanta të marrëdhënieve më akterët e tjerë në; sistemin politik, institucionet shtetërore, në media dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme me partitë politike.

Edhe nëse grupet e interesit i kryejnë disa nga funksionet e partive ato mund të dallohen nga partitë me anë të tri karakteristikave kryesore:

- Ato nuk e përfshijnë veten në gara politike për ulëse në parlament.
- Misionet, objektivat, programet, aktivitetet dhe fushat e tyre të interesit janë zakonisht të kufizuara në çështje të veçanta apo brenga të grupeve të veçanta shoqërore, përderisa partitë në përgjithësi synojnë për një qëllim më të përgjithshëm dhe funksionet e përfaqësimit dhe integrimit të grupeve të ndryshme shoqërore.
- Ato janë më të lidhura me ato grupe të cilave i `a përfaqësojnë interesat. Për shembull, organizatat afariste janë të udhëzuara nga interesat e korporatave anëtare si dhe përfaqësuesit e tyre; sindikatat përfaqësojnë interesat e punëtorëve përpara veprimeve të tyre të cilat kryesisht kanë të bëjnë me fushat negociatave për pagat dhe kushtet e punës; ndërsa organizatat e tjera fokusohen në çështjet shoqërore dhe kulturore apo në çështjet mjedisore, siç janë shoqatat për mirëqenie të cilat fokusohen në ofrimin e shërbimeve shoqërore.

Grupet e interesit në asnjë mënyrë nuk janë homogjene, dhe dallojnë jo vetëm sipas fushës së interesit por gjithashtu edhe për nga madhësia, struktura, baza e fuqisë, ndikimi i mundshëm, strategjitë e tyre etj.

Rëndësia politike e grupeve të interesit është po aq e ndryshueshme sa edhe gama e asociacioneve. Megjithatë, në kuadër të disa organizatave të caktuara përpjekja për të ndikuar debatet politike dhe vendimet është një pjesë kyçe e qëllimit të tyre. Në përgjithësi, asociacionet përpiqen të ndikojnë në disa parti të caktuara, debate politike dhe vendime në favor të tyre. Kjo mund të jetë e ligjshme në parim, por mund në veçanti të theksoj balancimin e interesit të shoqërisë si të tërë brenda interesave sektorial, sidomos në raste të tilla kur grupe të fuqishme të interesit i fusin në funksion burimet e tyre -paratë apo aftësinë për të mobilizuar masa të mëdha - për të ndikuar në vendime politike në favor të tyre.

Në të njëjtën kohë ata vetë sillen si akterë në procesin e politik-bërjes të partive të tjera. Duke ushtruar funksione të ndryshme, partitë dhe shoqatat, në një mënyrë të caktuar, i nënshtrohen kushteve të përbashkëta të veprimeve. Marrëdhëniet në mes të shoqatave dhe partive politike varen nga roli që një parti luan në sistemin politik.

Mes partive dhe grupeve të interesit ekziston një marrëdhënie e varësisë reciproke. Asociacionet kanë nevojë për qasje tek partitë në mënyrë që të kenë një lidhje të drejtpërdrejt në procesin e politik-bërjes, ndërsa partitë përkrahen nga asociacionet gjatë zgjedhjeve. Përveç kësaj, për të ndikuar tek burokracia ministrore e cila në anën tjetër varet edhe vet nga informacioni i asociacioneve. Gjithashtu, lidhur me këtë, ka mënyra reciproke të ndër-varësisë.

Mundësia për të arritur rëndësi është e përcaktuar për asociacionet jo vetëm nga kapacitetet e veta organizative por thellësisht nga kapaciteti i tyre për të përfaqësuar interesat edhe përmes konflikteve gjithashtu. Për shembull ato mund të organizojnë greva apo të ushtrojnë forma të tjera të presionit.

Efektiviteti i kërcënimeve të tilla është subjekt i konstalacioneve të caktuara në sistemin politik. Për shembull, nëse nga një ndryshim i preferencave partiake me një shumice të ngushtë në parlament mund të kërcënohet, kjo rrit ndikimin e grupeve të interesit.

Ndikimi i asociacioneve mbi procesin e vendimmarrjes duhet të monitorohet nga afër dhe është një temë e vazhdueshme e analizave të shkencave politike. Për shembull, në Gjermani, ku ekziston një numër i madh i asociacioneve, shumë nga ato kanë frikë se "fuqia e asociacioneve" është një kërcënim për sovranitetin e shtetit. Këto frika rezultojnë të jenë kryesisht të pabaza. Studimet empirike mbi krijimin e disa ligjeve erdhën në përfundim se në procesin legjislativ nuk kishte dëshmi të ndikimit të ndonjë grupi individual të interesit. Megjithatë, në Gjermani, si në shumë vende tjera, procesi legjislativ është i ndikuar drejtpërsëdrejti nga ndikimi i asociacioneve individuale në fushat e tyre përkatëse të politikës. Në shumë raste, asociacionet e mëdha të bizneseve ushtrojnë më shumë ndikim se ato të voglat.

Politikanët duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë çështje. Për shkak të marrëdhënieve të veçanta në mes të partive politike dhe asociacioneve, gjithmonë ekziston problemi që interesi sektorial mund të tejkaloj interesin shoqëror. Duke organizuar politikën dhe sistemin politik, rregullat përkatëse lidhur me veprimet e shoqatave duhet ti vështroj në mënyrë rigoroze kërkesat për transparencë[12].

Partitë politike në parlament dhe qeveri

Një parti politike i ka arritur qëllimet e saj primare kur fiton përfaqësim parlamentar, ose edhe me pjesëmarrje në qeverisje.

Pothuajse "i`a ka dalë": përfaqësuesit e saj janë ulur në parlament, ndoshta edhe ushtrojnë qeverisjen; për një afat të caktuar partia e ushtron pushtetin, gëzon privilegjet e lidhura me pushtetin dhe më në fund mund të favorizoj klientët e saj. Megjithatë, puna e "vërtetë" fillon vetëm me hyrje të suksesshme në parlament. Varësisht se sa ulëse në parlament i fiton një parti, tani ajo mund të formoj koalicione, marrëveshje për koalicione, krijoj një program të qeverisjes dhe të përballet me probleme të panumërta dhe së paku të zgjedh një pjesë të konsiderueshme të këtyre.

Zgjedhjet e vendosin se si partitë përfaqësohen në parlamentin kombëtar, në parlamentin regjional dhe respektivisht në zyrat lokale. Së paku në parim, fraksionet (grupet parlamentare) tentojnë që të e kalojnë në parlament çfarëdo që një parti pohon se përfaqëson. Suksesi i këtyre përpjekjeve është shumë i varur nga ajo se sa i madh është fraksioni i partisë që është në parlament, dhe prandaj, sa i lartë është proporcioni i mandateve të saj dhe nëse përbënë qeverinë apo opozitën.

Qeverisë i nevojitet shumica e parlamentit dhe kjo është arsyeja se pse qeveria dhe forcat e përbashkëta të partisë në koalicionin qeveritar punojnë ngushtë së bashku. Në të kundërtën partitë opozitare e kontrollojnë qeverinë, dhe prezantojnë alternativa konstruktive, për projektet e qeverisë dhe partive qeveritare.

Në modelin klasik të ndarjes së pushtetit, ka një ndarje të qartë në mes të ekzekutivit (qeverisë) dhe legjislativit (parlamentit). Megjithatë, në praktikë, ky model nuk funksionon në kushte të një ndarje rigoroze të të dy organeve, por më shumë në kuptimin e një gërshetimi apo një ndarjeje të detyrave. Kjo në veçanti vlen për sistemin e qeverisjes parlamentare, ku dega ekzekutive varet shumë në ndihmën e parlamentit. Në mes të qeverisë dhe parlamentit, që nën-kupton se shumica e përkrahësve të qeverisë në parlament, ka një ndër-varësi të ndërsjellë, e cila gjithashtu e detyron një nivel të lartë të aprovimit dhe unitetit. Pa këtë unitet, është gati se e pamundshme që të ketë një qeverisje efektive. Secila qeveri duhet të përpiqet që të arrij një shumicë të gjerë dhe të qëndrueshme në parlament, zakonisht në të dy dhomat e parlamentit, nëse është një sistem dydhomësh. Kjo gjithashtu zbatohet tek qeveritë e kuvendeve regjionale dhe lokale.

Vetëm opozita parlamentare ka interes që të zë ngushtë qeverinë. Partia qeverisëse në të kundërtën zakonisht përmbahet nga kritikat në drejtim të qeveris "të saj" apo nga shprehja e kritikave kur janë në pyetje detajet në kontekst të projekteve në pritje. Në shumicën e vendeve, ka takime të rregullta të koordinimit në mes të udhëheqësve të strategjive të partive udhëheqëse, shefit të qeverisë dhe anëtarëve të kabinetit për koordinim në mes të qeverisë dhe grupeve parlamentare si dhe për përgatitjen e procedurave të votimit në parlament. Parlamentarët e partive qeverisëse shpesh janë më mirë të informuar mbi projektet në zhvillim e sipër nga kontaktet e tyre jo formale me anëtarët e qeverisë.

4.1. Grupet parlamentare (fraksionet)

Përfaqësuesit e partive përkatëse përbëjnë fraksionet në parlament. Liderët e partive dhe fraksioneve zakonisht e krijojnë një grup të lidhur ngushtë dhe janë të bashkuar përmes bindjeve thelbësore politike. Edhe pse mund të ndodhin tensionime, fraksionet zakonisht janë këmbëngulës që të përmbahen ndaj çfarëdo mendimi të kundërt me partinë. Konfliktet e vazhdueshme në mes të një partie dhe grupit të saj ndodhin në raste të rralla. Shefat e grupeve (udhëheqësit e një grupit parlamentar apo fraksioni) zakonisht kanë një ndikim të madh në partinë e tyre. Përveç detyrave të tyre parlamentare, ata gjithashtu duhet të kontribuojnë në zbutjen e tensioneve në mes të partisë dhe fraksioneve parlamentare.

Nevojitet dhe është legjitime solidariteti dhe disiplina në kuadër të një fraksioni. Megjithatë, nuk mund të ushtrohet një detyrim i përhershëm për të gjithë parlamentarët që t`i binden udhëheqësit të partisë së tyre. Shumica e kushtetutave demokratike në botë e garantojnë "mandatin e lirë" të parlamentarëve. Gjithashtu vijat e detyruara, "urdhrat" apo "udhëzimet" nga një parti ndaj parlamentarëve të sajë janë jo kushtetuese.

Në të kaluarën dhe deri më sot, janë kryesisht partitë komuniste që kanë ushtruar masa shtrënguese ndaj anëtarëve të tyre të parlamentit. Në këto raste parlamentarët janë "ushtarët" e vërtet të partisë së tyre.

Megjithatë, kufijtë në mes të disiplinës në një fraksion dhe masave shtrënguese janë disi të paqarta edhe në partitë demokratike. Nëse një parlamentar synon që të qëndroj sërish si kandidat për parlament, ai do të përkrah kursin e fraksionit në mënyrë që të jetë në konsiderim në listën e kandidatëve dhe të përkrahet nga partia në fushatën e tij. Puna e parlamentarëve në sesionet plenar, në komisione dhe në panele të tjera të parlamentit, në shumicën e vendeve, karakterizohet në mënyrë thelbësore nga orientimi politik i një partie.

5

Lidershipi politik

Partitë Politike kanë nevojë për udhëheqës të fuqishëm politik.

Përveç përpjekjeve në lidhje me organizimin e tyre, strategjitë politike, komunikimin dhe programet, domosdo për sukses të vazhdueshëm, partitë politike duhet të kenë liderin e duhur politik, të jen tërheqës për popullin dhe votuesit. Liderët politik e udhëheqin procesin e formimit të mendimit politik dhe vendimmarrjes dhe i ofrojnë këto vendime me legjitimitet.

Që nga kohërat e lashta, mendimtarët politik janë interesuar në lidhje me kualitetet e nevojshme të një lideri të "mirë" politik. Këto ide kanë evoluar që nga "mbretërit filozof" i Platonit, deri tek pragmatizmi i Makiavelit (gjithçka që shërben për marrjen dhe mbajtjen e pushtetit është e pranueshme), deri tek teoritë moderne mbi elitën dhe konkurrencën, të zhvilluar nga e ashtuquajtura shkolla italiane e sociologëve si Vilfredo Pareto dhe Gaetano Mosca, të cilët u ngritën me ardhjen e politikës masive. Këtu, këto perceptime të ndryshme të udhëheqësve politik mund vetëm të përmenden por jo të sqarohen më gjerësisht.

Në demokraci, udhëheqësit politik fuqizohen përmes zgjedhjeve që të kryejnë procesin e opinion bërjes politike dhe vendimmarrjes. Varet nga rrethanat politike se në çfarë mase ata janë në gjendje të shfrytëzojnë këto kapacitete. Sistemi i qeverisjes ka rëndësi (nëse është sistem presidencial apo sistem parlamentar), ashtu si edhe karakteri i qeverisë, nëse është i mbështetur nga një parti apo nga një koalicion i partive, apo edhe formati i shtetit, nëse është shtet unitarian apo federal etj. Gjithashtu fuqia (apo dobësia) e grupeve të interesit si sindikatat apo asociacionet e punëtorëve dhe roli i ushtrisë janë faktor që ndikojnë në formën dhe kapacitetin e lidershipit politik. Pa marr parasysh këto rrethana, udhëheqësit politik duhet, në mënyrë ideale, të demonstrojnë disa kapacitete të caktuara. Disa nga këto janë të listuara më poshtë:

Kapacitet e udhëheqësve politike

- Parimet etike dhe morale, si dhe synimet e qarta politike që udhëheqin veprimet e tyre (dhe të cilat duhet të jenë transparente në demokraci). Ndershmëria dhe besueshmëria janë dy vetitë kryesore për lidership siç është përgjegjësia ndaj qytetarëve.
- Ekspertiza politike të jetë në gjendje të vlerësoj dhe përcaktoj çështjet e rëndësishme për procesin politik dhe pasojat e saj politike dhe shoqërore.
- Kapaciteti për menaxhim në mënyrë që drejtojnë një organizatë dhe një kuptim të qartë të rrethanave mbizotëruese në mënyrë që të jetë në gjendje të përshtatet si duhet që të përballet me sfidat e reja (edhe me mirë është aftësia për ti parashikuar ndryshimet)
- Ndjeshmëria dhe në rastin më të mirë karizma, në mënyrë që të bind dhe të mbledh përkrahje të popullatës për vendimet politike që janë në proces të zbatimit apo që tashme janë marr.
- Faktorët personal gjithashtu e luajnë një rol, siç është njohja e natyrës së njeriut, arsyetimi praktik, kontaktimi personal, aftësitë komunikuese dhe një qasje strategjike, mundësia që të merr veprime të shpejta dhe të jetë i durueshëm etj.

Këto karakteristika janë kërkesat kryesore për të udhëhequr brenda—- kjo nënkupton partinë e vetë—si dhe nga jashtë—të fitoj përkrahjen e qytetarëve dhe të votuesve dhe të ushtroj pushtet politik. Lidershipi politik përfshinë shumë më shumë se njohurinë dhe kontrollin funksional mbi procedurat legjislative; në veçanti udhëheqësit politik kanë nevojë që të ushtrojnë "ndjekjen e vazhdueshme dhe afat gjate të koncepteve politike në njërën anë dhe integrimin dhe bindjen e institucioneve dhe qytetarëve në anën tjetër."[13]

Në të njëjtën kohë, lidershipi politik kërkon përshtatje fleksibile ndaj "tregjeve të komplikuara të votimit"[14]. Margjinat strategjike për partitë janë rritur, pasi që duhet t`i qasen grupeve të ndryshme të votuesve. Si rezultat i kësaj liderëve politik u kërkohet të jenë fleksibil lidhur me përmbajtjet politike - por pa e humbur pozitat kryesore të partisë së tyre, pasi që kjo mund të frenoj votuesit tradicional.

Çështja e lidershipit politik rishfaqet përsëri e përsëri – jo më pak në kohën e globalizimit, që ka efekte të konsiderueshme në organizimin e politikave kombëtare dhe prandaj gjithashtu edhe në udhëheqësit e politikës kombëtare. Në përgjithësi mund të vërejmë që nevoja për lidership është rritur ndërkombëtarisht. Kjo është një pasojë e presioneve të ndryshme të problemeve që demokracia e përfaqësuar dhe liberale u është ekspozuar. Kjo e ka dëshmuar veten edhe një herë gjatë krizës ekonomike të vitit 2008/2009. Në situata të tilla kërkohet nga lidershipi politik që të marr vendime me përgjegjësi demokratike.

Megjithatë, nuk është vetëm rritja e presionit politik, social dhe ekonomik që ringjall thirrjen për lidership politik. Përmes efektit të saj të personalizimit, mediet masive gjithashtu kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme në vlerësimin e individëve në posedim të pozitave kryesore në parti apo qeveri, të cilët ata i portretizojnë si akterët kryesor të vendimmarrjes.

Interesimi i medieve në përfitimet personale për individët që zënë pozitat kryesore ekzekutive politike me anë të një vlerësimi. Kjo është në veçanti e lidhur me rritjen e nevojës për koordinim në mes të ekzekutivit në politiken sektoriale.

5.1. Dilema e lidershipit politik

Roli i udhëheqësve politik është diskutuar shumë herë në filozofi, shkenca politike dhe historiografi të sfondeve të ndryshme kulturore. Sociologu Maks Weber, i cili e ka studiuar këtë temë në detaje, i fokusuar në veçanti në dilemat etike në mes të "etikës të qëllimeve përfundimtare" dhe të "etikës të përgjegjësisë" që udhëheqësit politik përballen me to herë pas here. Etika e "qëllimeve përfundimtare" i referohet një sjellje politike e cila koncentrohet ekskluzivisht mbi pozitën etike dhe morale të akterëve, pa marr në konsiderim pasojat e veprimeve politike të bazuara në sjellje të tilla. Në anën e kundërt, "etika e përgjegjësisë" e konsideron një vendim politik gjithashtu me konsiderim ndaj pasojave etike dhe morale. Max Weber vjen në përfundim që udhëheqësit demokratik politik nuk duhet të udhëhiqet nga "etika e qëllimeve përfundimtare" por nga etika e përgjegjësisë. Politika e përgjegjshme kërkon një instinkt për pushtet dhe një ndjesi të përgjegjësisë dhe proporcion, por gjithashtu dedikim me plot pasion ndaj një çështje të vet-imponuar supra-personale dhe karizma të jetë në gjendje të përmbush nevojat emocionale të pasuesve.

"Politika është një shpim i fuqishëm dhe i ngadaltë i dërrasave të forta" Kërkon të dyja pasion dhe perspektivë. Sigurisht e gjithë përvoja historike e konfirmon të vërtetën – që njerëzimi nuk do të realizonte të mundshmen nëse nuk do të kërkonte të pamundurën. Por për të bërë këtë personi duhet të jetë lider, dhe jo vetëm një lider por edhe një hero gjithashtu, në një kuptim shumë të matur të fjalës. Madje edhe ata që nuk janë as liderë dhe as heronj duhet të armatosin veten e tyre me durimin e zemrës e cila mund të trimëroj edhe të gjitha shpresat e rrënuara. Kjo është e nevojshme tani apo përndryshe njerëzit nuk do të jenë të aftë që të arrijnë edhe atë që është e mundur sot. Vetëm ai që e ka thirrjen për politik dhe i cili është i sigurt se nuk do të thyhet kur nga këndi i tij i vështrimit bota është shumë e marrë apo shumë bazike për atë që ai dëshiron të ofroj. Vetëm ai që në ballë të kësaj situate mund të thotë 'pavarësisht të gjithave!' ai e ka thirrjen për politikë" (Max Weber në esenë e tij të famshme mbi "Politika si Profesion")[15]

5.2 Mësimet nga udhëheqësit politik

Nelson Mandela,
president of the Republic
of South Africa 1994-1999

Mësimet nga Nelson Mandela për lidershipin

Nelson Mandela ishte një militant i shquar kundër regjimit të aparteidit në Afrikën e Jugut dhe për këtë u deshtë të kaloj 27 vjet në burg. Pas lirimit të tij në vitin 1990 ai u zgjodh president i Republikës së Afrikës së Jugut (prej vitit 1994 deri në vitin 1999). Përvoja e tij si një udhëheqës politik ka çuar në drejtim të disa mësimeve, të cilat janë mbledhur si "8 mësimet e Mandelës mbi lidershipin"[16]

1. ***Guximi nuk është mungesa e frikës – është motivimi i të tjerëve për të lëvizur përtej saj.***
   Një lider nuk mund të shtiret se është i guximshëm, por ai nuk mund ti lejoj njerëzit të dinë frikën e tij. Ai "duhet të vendosë një front". Përmes aktit të paraqitjes si i patrembur, Mandela ka inspiruar të tjerët. Duke e ditur se ai është model për të tjerët kjo i ka dhënë forcë Mandelas që të triumfoj mbi frikën e tij.

2. ***Drejto nga fronti – por mos e lini prapa bazën tuaj***
   Një udhëheqës e merr bazën e tij përkrahëse me të dhe pasi të arrij në pozitë, i lejon njerëzit të vazhdojnë më tej.

3. ***Drejto nga prapa – dhe lejoj të tjerët të besojnë që ata janë në front***
   Triku i lidershipit është të lejosh veten që të udhëhiqesh gjithashtu. Mandela ka thënë se është mençuri që të bindësh njerëzit të bëjnë gjëra dhe ti lejosh të besojnë se ishte ideja e tyre.

4. ***Njihe armikun tënd – dhe mëso se cili është sporti i tij i preferuar***
   Një udhëheqës i kupton fuqitë dhe dobësitë e armiqve të tij, dhe i formon taktikat e tij sipas kësaj. Ai e njëson vetën me armikun e tij.

5. ***Mbaji miqtë afër – ndërsa rivalët e tu edhe me afër***
   Mandela e ka çmuar besnikërinë, por nuk ka qenë kurrë i fiksuar me të, duke thënë, "njerëzit veprojnë sipas interesave të tyre". Mandela ka besuar se përqafimi i kundërshtarëve është një mënyrë e kontrollimit të tyre; ata kanë qenë më të rrezikshëm kur janë vetëm se sa brenda rrethit të tij të ndikimit. Ai e ka pranuar që rruga për tu përballur me ata që nuk ju ka besuar ishte ti neutralizimi i tyre me anë të sharmit.

6. Paraqitja ka rëndësi –dhe mos harro të buzëqeshësh

Mandela e ka kuptuar se si paraqitja e tij mund të përparoj kauzën e tij. Avokati i tij e kujton atë si Afrikano Jugori i parë i zi që ai e kishte parë të jetë i përshtatshëm për një kostum. Megjithëse, nuk ishte një folës publik i mirë, ai gjithmonë e ka bërë vallëzimin lokal *toyi-toyi që* ishte emblemë e luftës. Buzëqeshja e tij verbuese, e bekuar dhe gjithëpërfshirëse "ishin mesazh" : për jug-afrikanët e bardhë, ndërsa mungesa e zemërimit; për votuesit e zi ai është luftëtari i lumtur dhe se ai do të triumfoj.

7. Asgjë nuk është bardh apo zi

Jeta nuk është kurrë "ose ashtu ose kështu". Vendimet janë komplekse dhe ka gjithmonë faktor konkurrues. Është tendencë e trurit njerëzor të kërkojë shpjegime të thjeshta, por kjo nuk korrespondon me realitetin. Mandela ndihet rehat me kontradiktat. Si politikan, ai ishte pragmatist që e pa botën me shumë nuanca. Llogaritja e tij ishte gjithmonë "Cili është përfundimi të cilin unë e kërkoj?" dhe "Dhe cila është rruga më praktike për të arritur aty?"

8. Edhe dorëheqja tregon lidership

Mandela e ka pranuar me përulësi se të dish se si të braktisësh një ide, detyrë apo marrëdhënie të dështuar është shpesh vendimi më i vështirë që një udhëheqës duhet të bëjë. Trashëgimia e tij më e madhe si president i Afrikës së Jugut ishte mënyra se si ai vendosi të largohet. Njeriu që i dha jetën vendit të tij refuzoi që ta mbajë atë peng. "Puna e tij ishte që të vendos kursin, jo të drejtoj anijen." Ai e dinte se udhëheqësit udhëheqin aq shumë me atë që zgjedhin të mos e bëjnë njësoj si me atë që e bëjnë.

Parimet Rudy Giulianit për lidership

Rudy Giuliani,
Kryetar i New York-ut
1994-2001.

Rudi Giuliani ka qenë një kryetar i suksesshëm i New York-ut (1994-2001) dhe është bërë i njohur ndërkombëtarisht për aftësinë e tij për të menaxhuar krizat pas sulmit terrorist të 11 shtatorit, 2011. Ai gjithashtu ka arritur përmirësimin e imazhit të qytetit, i cili ka qen i karakterizuar si i pa qeverisshëm për shkak të problemeve ekonomike dhe dhunës kriminale. Edhe pse nuk pati sukses me kandidaturën presidenciale në vitin 2008, ai ka formuluar disa parime për lidership politik që mund të merren në konsideratë nga udhëheqësit politik. Parimet e më poshtme janë marrë nga libri i Rudi Galianit "Lidershipi"

1. Dije në çka beson, për çka qëndroni, çfarë është e rëndësishme për ju dhe se cili është qëllimi juaj.

2. Për të qenë lider duhet të jesh optimist

Duhet ta njohësh problemin dhe të dish si ta kalosh me optimizëm. Duhet të jeni në gjendje të "ëndërroni" për një situatë më të mirë dhe ta bëni në atë mënyrë. Udhëhiqni njerëzit me shpresë dhe jepini atyre shpresë se ajo çka ata janë duke bërë tani mund të bëhet realitet. Të bëheni personi më i qetë në dhomë kur jeni në një situatë emergjente. Kjo ju ndihmon që të kuptoni zgjidhjen më të mirë për situatën.

3. Që të bëheni udhëheqës duhet të keni guxim të merrni rrezikun përsipër

4. Përgatitja e vazhdueshme- zvogëlon rrezikun

Gjithmonë parashikoni skenarët e mundshëm, megjithëse pa marr parasysh se si ju përgatiteni dhe e parashikoni gjithmonë do të ketë diçka që mund të ndodh për të cilën ju nuk jeni përgatitur. Menaxhimi i krizave është shumë i rëndësishëm sepse ndihmon në reduktimin e gjërave për të cilat ju nuk jeni i përgatitur.

5. Puna ekipore

Një nga gabimet e mëdha që një udhëheqës mund të bëjë është të mendoj se ai apo ajo janë të pagabueshëm. Cilat janë dobësitë e mija? Si mund të gjej njerëzit që mund të më ndihmojnë të kompensoj dobësitë e mija?

6. Për të qenë një udhëheqës i mirë duhet të komunikoni

Bëhu të dyja një mësues dhe një motivues. Nuk është e mjaftueshme të dish se çfarë të bësh duhet të jesh në gjendje ta komunikosh gjithashtu. Nëse e keni një qëllim me gamë të gjerë, duhet të keni standarde (statistika) që të dini se a keni arritur aty. Por statistikat nuk janë të mjaftueshme : duhet të dini se si të kujdeseni për njerëzit.

Sfidat për partitë politike në regjimet demokratike

6.1. Partitë politike dhe ndryshimet sociale

Demokracia ka pamje të ndryshme në çdo shtet dhe në çdo shoqëri. Forma konkrete e rendit demokratik varet nga historia, tradita, dhe kultura kombëtare si dhe nga veçoritë shoqërore, etnike dhe fetare të një shoqërie, potenciali i saj ekonomik, pesha e faktorëve rajonal, dhe më shumë. Megjithatë, ekzistojnë disa elemente bazë që duhet të jenë të pranishme në çdo sistem demokratik.

Elementet themelore të demokracisë

- organet qeverisëse duhet që të zihen nga autoritetet e zgjedhura, të cilët janë përgjegjës para zgjedhësve.
- zgjedhjet e lira dhe të ndershme duhet që të bëhen rregullisht.
- të gjithë të rriturit duhet të kenë të drejtën për të votuar dhe për tu zgjedhur për poste politike.
- liria e mendimit duhet që të mbretërojë dhe askush nuk duhet që të përndiqet për shprehjen e mendimit të lirshëm.
- qasja e lirë në burime alternative dhe pluraliste të informacionit duhet që të garantohet.
- e drejta për të formuar asociacione, grupe të interesit dhe parti politike duhet që të ekzistojë në mënyrë që të drejtat e përmendura më herët të mund të ekzekutohen.

Pavarësisht organizimit të demokracisë në vende të ndryshme, demokracia ka nevojë për institucione që sigurojnë konsolidimin e saj,stabilitetin dhe projektimin dhe të cilat mbrojnë demokracitë e "reja" nga kontestimi apo pengesat e mëdha. Shansi për stabilizim dhe konsolidim të demokracisë varet nga mënyra se si urdhrat përkatës të demokracisë janë institucionalizuar dhe se çfarë niveli i potencialit ofrohet nga institucionet demokratike për të përmbushur sfidat e ndryshimeve politike dhe sociale dhe se si ato sigurojnë legjitimitet për sistemin politik.

Pa marrë parasysh se si demokracia është organizuar në çdo rast individual dhe në çdo sistem politik, partitë politike janë institucionet kryesore të demokracisë. Pa parti nuk mund të ketë demokraci.

Funksionet themelore të partive politike tashmë janë shtjelluar. Megjithatë, partitë nuk kanë monopol në kryerjen e këtyre funksioneve dhe në ditët e sotme – më shumë se në të kaluarën, janë në konkurrencë me organizatat e tjera që gjithashtu kryejnë këto funksione të paktën në fusha të caktuara, dhe prandaj në këtë mënyrë konkurrojnë me partitë. Për këtë arsye, karakteristika thelbësore që dallon një parti është dhe mbetet pjesëmarrja e saj në zgjedhje.

Edhe pse partitë përmbushin funksionet e tyre thelbësore për sistemin politik dhe demokracinë, ato gjithashtu përballen me sfida të veçanta në demokracitë moderne. Ndryshimi social dhe efikasiteti (ose joefikasiteti) i përballjes me pasojat e ndryshimit në fushën e politikës janë arsyet kryesore në këto sfida të reja për partitë politike.

- Një dilemë klasike për partitë politike është pamundësia për të përmbushur të gjitha pritjet kundrejt tyre në të njëjtën kohë. Pasi që ata të zënë rastet për vendim-marrje politike, njerëzit presin koncepte dhe vendime për problemet dhe kërkesat e tyre. Disa grupe,megjithatë do të ndjehen të dëmtuar ose zhvillojnë kërkesa të reja, të cilat kurrë nuk janë plotësisht të kënaqshme. Dikush duhet vetëm që të mendojë për pritjen që shteti duhet të sigurojë të mirat publike dhe në të njëjtën kohë sigurinë e brendshme dhe të jashtme, një rrjet rrugor të zhvilluar mirë, shkolla publike, spitale dhe strehimore publike ose përfitime pa rritur taksat pa e rritur borxhin kombëtar. Pra partitë, kapen në marrëdhënie të vazhdueshme konfliktuoze ndërmjet pritjeve të papërmbushura dhe zgjidhjeve që perceptohen të papërshtatshme.

- Sfida të reja kanë dalë nga ndryshimi social dhe nga zhvillimi i shoqërive të fragmentuara, të cilat janë të karakterizuara nga shpërndarja e ambienteve tradicionale, erozioni i sistemeve të vlerave të qëndrueshme të mëparshme dhe zotimet në bazë të tij, një nivel më i lartë i arsimimit, pluralizmi i burimeve informative, si dhe organizimi individual i marrëdhënieve personale. "Zhvendosja e vlerave", "individualizimi", "veprimtaria e shoqërisë", dhe "fragmentimi i interesave" janë nocione për të përshkruar fenomene sociale që reflektohen në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi qëndrimin e qytetarëve kundrejt partive. Kur marrëdhëniet shoqërore humbin, angazhimi me partitë politike gjithashtu bëhet më i dobët. Partitë e ndjejnë këtë efekt jo vetëm me anë të rënies së anëtarësisë, por gjithashtu edhe me rënien e ambienteve të votuesve të qëndrueshëm dhe parashikimeve të zgjedhjeve të parakohshme dhe rezultatet e zgjedhjeve.

- Ndryshimi në media masive dhe në mënyrën e raportimit, rritja e konkurrencës për vëmendje dhe audiencë, si dhe zgjerimi i gazetarisë "hulumtuese" kanë çuar në një formë të re të raportimit për politikën, në të cilën idetë, vlerat dhe rezultatet janë më pak të rëndësishme se emocionet, morali, skandali dhe personaliteti në formën e një emisioni "informativ-argëtues". Skandalet politike dhe sjelljet personale dhe sjelljet jo të mira të politikanëve janë të njohura më shpejtë në ditët e sotme. Ky është sigurisht një përfitim në kontrollin e transparencës dhe atë demokratik por gjithashtu mund të kontribuojë në zhgënjim dhe nganjëherë edhe në degradimin e politikës dhe lojtarëve të saj. Të parët që ndjejnë pasojat negative janë partitë.

- Dilema "moderne" e partive politike buron nga globalizmi. Në nivel kombëtar, globalizmi dhe pasojat e saj kanë ulur hapësirën për manovra politike dhe kanë zhvendosur fuqinë e vendim-marrjes dhe aftësinë e menaxhimit tek lojtarët supra-nacional dhe ndërkombëtarë. Edhe pse qytetarët presin që aktorët politik kombëtar të vendosin mbi kërkesat dhe pritjet e tyre, çështje të rëndësishme nuk mund të zgjidhen nga vendim-marrësit politik kombëtar. Si pasojë, partitë politike përballen me një humbje të besimit në aftësinë e tyre për të vendosur mbi çështje të rëndësishme me interes kombëtar.

Këto zhvillime kanë pasoja serioze për partitë dhe sistemet partiake:

- në ditët e sotme sistemet partiake janë më të prira për modifikime dhe janë më të fragmentuara.

- Koha e partive të mëdha masive duhet që të ketë përfunduar. Të paktën, edhe pse disa parti mund të kenë anëtarësime të mëdha, sot është shumë e vështirë që të organizohen mitingje masive.

- Monopoli i kaluar virtual i partive si burim dhe vend për informacione politike dhe reflektim është mohuar në epokën e medieve, teknika moderne të informacionit të tilla si interneti dhe fushat alternative për pjesëmarrje politike jashtë partive.

- Partitë e kanë shumë të vështirë që të mbajnë të ashtuquajturit votues besnikë të ambienteve të caktuara në periudha afatgjata.

- Niveli i përgjithshëm i besimit të popullsisë në parti dhe në politikanë ka rënë dhe gatishmëria për t'u angazhuar politikisht ka rënë, veçanërisht në mesin e të rinjve.

- Mediet masive publikojnë raporte rreth skandaleve politike dhe mangësitë e vërteta apo të supozuara të partive dhe liderëve më të lartë për të menaxhuar dhe për të zgjidhur probleme. Në të njëjtën mënyrë siç janë rritur vështirësitë e menaxhimit politik në epokën e globalizmit financiar, politik ose ekologjik, gjithashtu janë rritur mundësitë teknike për raportim kritik. Rritja e konkurrencës në mesin e kanaleve televizive dhe medieve të shkruara ka kontribuar edhe me tendencën për të raportuar më shumë rreth gabimeve reale apo të supozuara të politikanëve.

- Rolet përkatëse të luajtura në të kaluarën nga partitë qeverisëse dhe atyre të opozitës nuk janë më aq të qarta, pasi që partitë e mëdha opozitare jo medoemos përfitojnë nga pakënaqësitë e votuesve, por në vend të kësaj ata humbasin votat për partitë e vogla apo partitë protestuese të reja.

Megjithatë, nuk janë vetëm partitë që preken nga zhvillimet e fundit të shoqërisë. Në fakt, ekziston edhe një humbje e përgjithshme e besimit në institucionet e tjera dhe organizata të mëdha shoqërore të tilla si sindikatat e punëtorëve. Megjithatë, ndryshimet janë sidomos të perceptuara nga partitë pasi që ato janë më së shumti të ekspozuara ndaj perceptimit publik. Këto zhvillime që përfshijnë dobësimin e partive të vetme nuk janë domosdoshmërish një krizë e demokracisë, por tregojnë kalimin në një formë tjetër të demokracisë, në të cilën partitë ende mund të përmbushin funksionet e lartpërmendura, por organizatat e tjera shoqërore si dhe media kanë më shumë ndikim në procesin e ndërtimit të opinionit politik se sa në periudhat e mëparshme kohore.

Përkundër kësaj humbje të ndikimit kundrejt lojtarëve të tjerë, një faktor thelbësor nuk ka ndryshuar: Partitë janë ende institucione nga të cilat konceptet dhe zgjidhjet për adresimin e problemeve të shoqërisë priten pasi që të zënë pushtetin mbi organet vendimmarrëse politike. Gjithashtu partitë janë institucionet e vetme që marrin pjesë në zgjedhje dhe se përfaqësimi i tyre matet nga rezultatet e zgjedhjeve.

Dobësimi dhe fragmentimi i sistemeve partiake në terma të përgjithshëm është problematik, sepse nuk ka asnjë alternative për shtetin partiak demokratik. Asociacionet, iniciativat e qytetarëve dhe lëvizjet sociale mund të jenë rritur në numër por ndikimi i tyre politik duhet që ende të rritet. Ky është pjesërisht një konsolidim i demokracisë.

Megjithatë, me të gjithë legjitimitetin e shqetësimeve mbi organizata të tilla, rritja e ndikimit të tyre ka gjithashtu aspekte problematike sepse ato nuk mund të mbështetin përfaqësimin e tyre dhe të adresojnë të gjitha kërkesat e publikut. Vetëm partitë mund që të legjitimojnë veten e tyre përmes zgjedhjeve demokratike.

Fuqia e medieve gjithashtu po vazhdon të rritet. Megjithatë, duke marrë parasysh konsolidimin në mes të shtypit dhe kompanive televizive si dhe dominimit të disa kompanive të TI-së ky evolucion duhet që të shoqërohet me një zgjatje të kontrollit demokratik dhe transparencës, e cila është e mundur vetëm brenda kontekstit të institucioneve të demokracisë përfaqësuese.

6.2. Kriteret për punë të qëndrueshme dhe të suksesshme të partisë

Partitë duhet që vazhdimisht të përpiqen të kryejnë funksionet e tyre nën ndryshimin e rrethanave shoqërore. Në mënyrë të pavarur nga veçantitë shoqërore rajonale dhe kombëtare ose sistemit elektoral dhe qeverisës, ekzistojnë disa kritere që çdo parti duhet ti respektoj dhe përmbushë në mënyrë që të marrin pjesë me sukses në garën politike[17].

- Një parti ka nevojë për një bazë elektorale të mjaftueshme dhe të identifikueshme. Duhet që të përpiqet që të rrënjos veten grupet zgjedhore dhe të interesit që ajo dëshiron ti përfaqësojë, natyrisht, në përputhje me vlerat themelore dhe profilin e saj programor.

- Një parti duhet që të ndërtojë një organizim të gjerë në mënyrë që të praktikojë afërsi me qytetarët dhe të mobilizojë votuesit.

- Një parti duhet të ndërtojë një organizatë të hapur për anëtarësim. Anëtarësimi është thelbësor për rekrutimin e udhëheqësve të saj të ardhshëm dhe duhet që të jetë element relevant për bazën e saj financiare. Një organizatë aktive për anëtarësim, megjithatë, kërkon demokraci brenda partisë, d.m.th anëtarët që marrin pjesë politikisht dhe janë në gjendje të përcaktojnë lidershipin e partisë dhe po ashtu caktojnë kursin e partisë.

- Një parti duhet që të komunikojë, si brenda ashtu edhe jashtë. Ka nevojë për një sistem funksional të brendshëm për të gjithë rangun e saj dhe dosjen në të gjitha nivelet dhe për anëtarët e saj. Për më tepër, një lidhje e vazhdueshme me mediet është e nevojshme. Ata janë "kujdestarë" e sistemit politik në demokracinë e zhvilluar në media, duke gjeneruar vetëdije publike.

- Një parti duhet që të zhvillojë profilin e saj programatik, duke dalluar veten nga të tjerët duke formuluar objektivat dhe mënyrat e zgjidhjes në mbajtjen e problemeve reale të kohës. Qëllimi i programit të punës është që ti mundësojë partisë të integrojë pritjet dhe kërkesat publike, si dhe të promovojë identifikimin e partisë nga qytetarët.

- Një parti duhet që të jetë në gjendje që të tregojë një shkallë të lartë të qeverisjes së brendshme të partisë. Kjo është aftësia për të gjetur një bilanc në mes të pamjes së unifikuar ndaj publikut dhe dialogut të diskutueshëm brenda partisë. Pjesë e kësaj qeverisje është përzgjedhja dhe mbështetja e gjeneratave të reja të anëtarëve të partisë dhe liderëve të partisë.

- Një parti duhet që të jetë e aftë të integrohet. Ky është çelësi i vërtetë i suksesit dhe rritjes së një partie. Këtu nënkuptohet përpjekja konstante për zgjerimin e bazës së saj elektorale, fitimin e votuesve të rinj me interesa të ndryshme dhe mënyra të ndryshme të jetesës si dhe për të themeluar një lidhje të vazhdueshme me këta votues.

- Një parti duhet që të jetë në gjendje që të kryejë fushata elektorale. Duhet që të jetë në gjendje të paraqesë tema të rëndësishme dhe profilin e vet në mënyrë efikase në publik dhe duhet që të udhëheq fushata zgjedhore të përsosura me disa tema dhe një mesazh të qartë për " komunikim të fokusuar".

- Një parti duhet që të jetë në gjendje që të formojë koalicione. Pasi që është e vështirë për një parti, veçanërisht në kontekstin e sistemit të votimit kush ka më shumë vota, për të marrë shumicën absolute në parlament, një parti duhet që të jetë në gjendje të formojë koalicione të qëndrueshme me parti të tjera që të demonstrojë qeverisshmërinë. Problemet e qeverisshmërisë reflektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë reputacionin e partive. Në formimin e koalicioneve mund të jetë i nevojshëm kalimi i përçarjeve të thella programatike/ose personale. Ky është një moment ku liderët politik mund të tregojnë aftësitë e tyre.

- Një parti duhet që të dëshmojë qeverisshmërinë e saj dhe kapacitetin për zgjidhjen e problemeve në nivel lokal. Në të gjitha shtetet, qytetarët duhet që të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me palët dhe përfaqësuesit e tyre në politikën lokale. Vetëm nëse partitë mund të dëshmojnë kompetencat dhe afërsinë e qytetarëve në këtë nivel, ato mund të presin besim në nivel kombëtar.

- Një parti duhet që të jetë e aftë për të mësuar pritjet, dhe implementimin e programeve politike që plotësojnë kërkesat brenda shoqërisë. Duke marrë parasysh rritjen e rëndësisë së organizatave shoqërore jo-qeveritare dhe asociacioneve të interesit, partitë duhet që të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të qenë në kontakt me këto organizata ndërmjetësuese, për të kuptuar pritjet e njerëzve, dhe për ti përkthyer ato në politika.

7

Konkludim:
Nuk ka demokraci Pa parti politike

Përkundër të gjitha dobësive të partive dhe përkundër të gjitha sfidave që partitë duhet të ballafaqohen, një gjë mbetet e sigurte: pa parti politike, demokracia nuk mund të funksionojë.

Në demokraci partitë janë ende hallka më e rëndësishme lidhëse në mes të shtetit dhe shoqërisë. Por me të vërtetë ata duhet që të përshtaten me ndryshimet shoqërore në mënyrë që të sigurohen që nuk do të gëlltiten nga ana e tyre.

Formimi i mendimit politik dhe konsensusit në demokraci masive është pafundësisht i mundimshëm, pjesërisht i pakënaqshëm dhe një proces vazhdimisht i rrezikuar duke përfshirë mungesën e shkëlqimit në jetën e përditshme të komiteteve, komisioneve dhe kuvendeve. Formimi i mendimit politik, ndërtimit të konsensusit dhe qeverisë në të mirë të gjithë shoqërisë nuk mund të anashkalojë ose të jetë kundër partive politike, por vetëm mundet që të përfshijë ato. Po aq sa janë të nevojshme iniciativat qytetare dhe lëvizjet sociale për risi politike, opozita dhe kritika, në fund varen shumë nga partitë të cilat kryejnë përgjegjësi afat-gjata dhe partitë janë ato që duhet të përballen me popullatën në intervale të rregullta në kontekstin e zgjedhjeve.

Partitë bartin rolin e një udhëheqësi politik duke pas parasysh që një demokraci moderne nuk mund të bëjnë pa to. Veçanërisht në kohë të ndryshimeve ky lidership politik duhet që të jetë përgjegjës dhe i dukshëm për qytetarët lidhur me interesat dhe kërkesat e qytetarëve. Ashtu siç ka theksuar Konrad Adenauer, Kancelari i parë dhe Kryeministri i Republikës Federale të Gjermanisë pas luftës së dytë botërore: “Çdo parti politike ekziston për të mirën e njerëzve dhe jo për veten. Partive politike, anëtarëve të saj dhe udhëheqësve të tyre u kërkohet më shumë së kurrë të përballen me këtë përgjegjësi.”

Partitë Politike në Kosovë

Autor: Butrint Berisha

Shkurtesat

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKShS	Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LDD	Lidhja Demokratike e Dardanisë
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LKÇK	Lëvizja Kombëtare Çlirimtare e Kosovës
LNDSH	Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare
LPK	Lëvizja Popullore e Kosovës
LPRK	Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës
LRBA	Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PKSH	Partia Komuniste e Shqipërisë
PSD	Partia Socialdemokratike e Kosovës
PSHDK	Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës
QUINT	Franca, Gjermania, Italia, Mbretëria e Bashkuar, SHBA
RAE	Rom, Ashkali, Egjiptian
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UJDI	Asociacioni për Iniciativën Demokratike Jugosllave
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VV	Lëvizja Vetëvendosje

Hyrje

Ky punim i shkurtër trajton dhe përshkruan skenën e partive politike në Kosovë, duke u fokusuar edhe në ofrimin e një përmbledhje deskriptive të partive politike në mënyrë individuale, por edhe në specifikat kryesore të ndërveprimit të tyre. Qëllimi kryesor i punimit është t'i ofrojë lexuesit të dhëna dhe analiza të proceseve ndër-partiake që kanë ndodhur në Kosovë në vitet e fundit, kësisoj duke tentuar të lehtësojë të kuptuarit e sistemit politik kosovar.

Premisa bazike e këtij punimi është se bashkëpunimi ndërpartiak në sistemet proporcionale është parakusht i qeverisjes cilësore, që i shërben përmirësimit të standardit të jetës së qytetarëve dhe krijimit të institucioneve të gatshme për të marrë vendimet e duhura. Partitë politike, si entitete demokratike, parashihet të jenë agjensët bartës të këtyre proceseve. Si një shtet i ri, pa përvojë të theksuar në institucione dhe sistemin pluralist demokratik, Kosova në vitet e fundit është përballur me kriza të shpeshta politike. Partitë politike shpesh kanë hasur në vështirësi për të gjetur formula të daljes nga krizat, çka vazhdimisht ka shkaktuar bllokada institucionale disamujore dhe polarizim politik e shoqëror. Ndër të tjera ky punim qëndron mbi këtë bazë, pra ai synon t'i kontribojë të kuptuarit e funksionimit të partive politike në Kosovë, trajektoret e formimit të tyre dhe pozicionimet ideologjike. Punimi gjithashtu synon të japë përgjigje në disa prej faktorëve ndikues që e formësojnë ndërveprimin e partive politike dhe efektet që prodhohen për sistemin politik, por edhe shoqërinë në përgjithësi.

Audienca e synuar e këtij teksti janë partitë politike, shkollarët, akademikët dhe OSHC-të, institucionet politike dhe, natyrisht, qytetarët e Kosovës. Shumica e të dhënave janë të nxjerra përmes hulumtimeve të tjera ekzistuese që kanë trajtuar partitë politike në të kaluarën. Gjithashtu, për të kuptuar më mirë funksionimin e partive politike janë dërguar pyetësor tek partitë prej të cilave përgjigje janë pranuar nga vetëm dy prej tyre (Nisma Socialdemokrate dhe Lëvizja Vetëvendosje).

Punimi vazhdon me këtë rend. Në pjesën e ardhshme ofrohet një përshkrim i aktivitetit të partive politike në Kosovë në raport me sistemet politike, domethënë një historik i shkurtër. Në pjesën e tretë ofrohen të dhënat kryesore për partitë politike parlamentare aktuale në Kosovë. Në seksionin pasues diskutohen pozicionimet ideologjike të partive politike në Kosovë dhe ndikimi i këtij pozicionimi në procesin e qeverisjes. Në pjesën e pestë ofrohet një analizë për mënyrën e bashkëveprimit të partive politike në Kosovë, rrjedhimisht funksionimin e Qeverive, me theks të veçantë në periudhën pas vitit 1999. Punimi mbyllet me seksionin e konkluzionit.

Historik i partive politike në Kosovë

Në vija të trasha partitë politike mund të definohen si organizata apo grupe individësh, të mbledhur në bazë të disa ideve të caktuara, të cilët synojnë të prodhojnë ndryshime me efekt politik në shoqëri. Partitë politike kanë një vizion të caktuar për të ndryshuar aspekte të funksionimit të shoqërisë, si rrjedhojë synojnë të përdorin institucionet, pra zyrat publike, si mjet për të kryer këto ndryshime përmes politikave. Përderisa, konkurenca e partive politike në garë të hapur, përmes sistemit pluralist dhe demokratik, tashmë është praktikë në shumicën e shteteve të botës, ka ende shtete që e diskurajojnë aktivitetin politik të organizuar nëpër parti politike.

Kosova ka qenë pjesë e një sistemi të këtillë në të shkuarën. Në përgjithësi, Kosova është një shtet që ka përjetuar transformime të dukshme në etapat e zhvillimit politik dhe shoqëror, veçmas në 30 vitet e fundit. Funksionimi i partive politike në Kosovë është i lidhur ngushtë me vendimin për të lejuar pluralizmin politik në Jugosllavi që nisi në Janar të vitit 1989.

Në periudhën 1945-1989, sistemi politik në Jugosllavi ishte njëpartiak, kësisoj përpos Partisë Komuniste të Jugosllavisë (më vonë Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë) partitë dhe formacionet politike nuk ishin të lejuara, madje gjatë gjithë kësaj periudhe veprimi i tyre ishte i dënueshëm. Ta zëmë, Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH) e themeluar në fillim të vitit 1945, ishte funksionale në Kosovë edhe pas vendosjes së komunizmit. Sidoqoftë, si pasojë e përndjekjes masive, brenda disa vitesh shumica e liderëve dhe anëtarëve të saj ishin burgosur, vrarë ose larguar jashtë, prandaj ky formacion pushoi së ekzistuari në formë aktive.[1]

Pavarësisht kësaj, formacionet politike në Jugosllavi edhe në Kosovë nuk u zhdukën tërësisht, edhe pse ishin të detyruara të mbanin një profil konfidencial dhe natyrisht një status ilegal. Në vitet dhe dekadat që pasuan në Kosovë lindën një numër grupimesh politike që afirmonin idenë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë apo shkëputjen e Kosovës nga Jugosllavia. Për shkak të kërcënimit që këto grupe ia shkaktonin legjitimitetit të shtetit Jugosllav brenda Kosovës, ku shumica e popullsisë ishin shqiptarë, zakonisht krerët e këtyre lëvizjeve ishin të përndjekur dhe burgosur. Ta zëmë, Adem Demaçi një ndër themeluesit e Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBA), i kaloi 28 vite të jetës së tij si i burgosur politik.[2]

Natyrisht, nga viti 1945 sfera publike dhe politike ishte e mbizotëruar nga Lidhja Komuniste e Jugosllavisë (LKJ), e cila kontrollonte plotësisht gjithë aparatin shtetëror.

Kur në vitin 1989 pluralizmi politik zuri të lëshojë rrënjë në vendet e ish-Jugosllavisë, edhe në Kosovë u formuan partitë politike. Por, para kësaj kishte një organizim të quajtur Asociacioni për Iniciativën Demokratike Jugosllave (UJDI), që ishte themeluar në Janar të vitit 1989 në Zagreb. Kjo iniciativë synonte konservimin e Jugosllavisë përmes reformave

politike, ekonomike dhe shoqërore. Në Kosovë, filiala e UJDI ishte nën udhëheqjen e publicistit Veton Surroi. Sidoqoftë, koha e veprimit të UJDI-t ishte shumë e shkurtër, për faktin se kjo iniciativë nuk arriti të kishte ndikim të vërejtshëm.

E para parti shqiptare në Kosovë ishte Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e themeluar me 23 Dhjetor 1989. LDK shpejt u shndërrua në një lëvizje të gjerë për artikulimin politik të kërkesës për pavarësinë e Kosovës nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës. Në muajt e ardhshëm u formuan edhe parti të tjera politike, si për shembull Partia Fshatare e Kosovës, Partia Parlamentare e Kosvoës (në fillim quhej Parlamenti Rinor), Partia Shqiptare Demokristiane, UNIKOMB-i, Partia Socialdemokrate, Partia e Aksikonit Demokratik (myslimane) për Kosovë, Partia Liberale Shqiptare, Partia Liberale e Kosovës dhe Partia Popullore Turke. Ky trend vazhdoi gjatë gjithë viteve 1990, ku u krijuan rreth 15 parti politike.[3]

Këto parti ishin pjesëmarrëse në sistemin paralel të Kosovës, që funksiononte ndaras nga institucionet e Beogradit. Krahas partive shqiptare në këtë sistem paralel merrnin pjesë edhe parti turke dhe boshnjake. Brenda sistemit paralel funksiononte Qeveria me dikastere (ani pse me kapacitete të limituara) dhe u zhvilluan zgjedhjet nacionale në vitin 1992 dhe 1998. Për shkak të një diaspore relativisht të gjerë në vendet e tjera, sidomos ato perëndimore, shumica e partive politike kishin edhe zyra të hapura jashtë Kosovës, por që funksiononin si pjesë integrale e strukturës organizative në vend.

Më tutje, grupacionet politike të ashtu-quajtura ilegale sikundër Lëvizja Kombëtare Çlirimtare e Kosovës (LKÇK), Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) dhe derivati i saj Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK) vazhdonin të ishin aktive në vitet 1990. Përpos këtyre, kishte edhe një sërë grupesh të tjera. Lëvizjet e ashtuquajtura ilegale njiheshin për një lidhje të ngushtë me Partinë Komuniste të Shqipërisë (PKSH), pra ishin të mveshura me një ideologji të fortë komuniste. Në epiqendër të programeve të tyre ishte bashkimi i Kosovës me Shqipëri.[4]

Këto lëvizje ishin zhvilluar në kohën kur asociacionet politike në Jugosllavi ishin ilegale, sidoqoftë ato nuk u bashkuan me partitë tjera kosovare në kohën kur pluralizmi u mundësua në vitin 1989. Në këtë drejtim, ato nuk ishin bërë pjesë e sistemit paralel, ani pse kishin anëtarësi dhe aktivitet të zhvilluar brenda dhe jashtë Kosovës. Abstenimi nga ky proces lidhet ngushtë me orientimin e tyre ideologjik, ngaqë aktiviteti i tyre politik ishte i atashuar me idenë e çlirimit të Kosovës vetëm përmes veprimit ushtarak. Këto lëvizje nuk besonin se formimi i institucioneve paralele kishte efekt pozitiv, domethënë mund të sillte ndonjë dobi, në çështjen e Kosovës.

Në përgjithësi, përderisa situata në terren nuk ishte e lehtë, pasi masat represive të Beogradit shkonin duke u shtuar, kishte një diversitet të formacioneve politike shqiptare. Ç'është më e rëndësishmja, disa prej këtyre diferencave janë kyçe për të kuptuar zhvillimet politike pas përfundimit të luftës, në periudhën post-1999.

Me përfundimin e luftës në Kosovë në vitin 1999 u instalua Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Përderisa, UNMIK ishte trupi më i lartë vendimmarrës në Kosovë, partitë politike lokale gjithashtu kishin rastin të bëheshin pjesë e një sistemi të ri politik, që kishte dallime të theksueshme me periudhën paraprake të sistemit

paralel. Në sistemin e ri partitë kishin dukshëm më shumë hapësirë manovrimi, ani pse prapë vijat limituese ishin të qarta meqenëse UNMIK kishte kompetencat më të larta qeverisëse. Sidoqoftë, periudha e UNMIK paraqet një epokë të re në funksionimin e partive politike në Kosovë. Gara zgjedhore do të përcaktohej në bazë të rregulloreve të reja Rregullorja 2000/16 Për Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike në Kosovë[5] (ndryshuar në 2002)[6] dhe urdhërin administrativ për zbatimin e kësaj rregulloreje.[7] Në këtë periudhë, u futën në garë edhe grupet politike që ishin pjesë e ilegales, të cilat kishin operuar inkognito me dekada, por gjithashtu edhe linden disa parti të reja. Ta zëmë, si trashëgimi e lëvizjeve ilegale dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) garës elektorale iu bashkuan Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në zgjedhjet e para të vitit 2000 dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në vitin 2001. LDK dhe shumica e partive tjera vazhduan të funksionojnë në sistemin e ri. Përpos këtyre, një e re ishte se brenda sistemit u inkuadruan edhe partitë e komuniteteve joshumicë (serb, RAE, goran, turk, boshnjak). Në përgjithësi, ishte hera e parë që në Kosovë kaq shumë subjekte politike që përfaqësonin grupe të ndryshme qytetarësh, garonin brenda sistemit të njëjtë në mënyrë të hapur.

Në Kosovë u organizuan zgjedhjet e para lokale në vitin 2000 dhe ato nacionale në vitin 2001. Siç vëren Beha, zgjedhjet nacionale në Kosovë u organizuan 16 muaj pas zbarkimit të UNMIK, pra më vonë se sa zgjedhjet lokale, diçka që mund të cilësohet si e pazakontë.[8]

Në fakt, ky ishte një ogur që shërbeu si pamje iniciale e statusit që do ta kishin partitë politike kosovare nën administratën e UNMIK-ut. Në këtë drejtim, në sytë e UNMIK-ut partitë politike dhe aktiviteti i tyre kishte për qëllim parësor ruajtjen e stabilitetit ndëretnik në Kosovë. Për këtë, UNMIK ndoqi një qasje të fokusuar të ndërveprimit me krerët e partive politike, si rrjedhojë funksionimi i brendshëm i partive politike ishte në plan të dytë.

Kjo mënyrë e funksionimit formësoi në masë të madhe funksionimin e partive politike në Kosovë, në planin afatgjatë, si parti (në masë të madhe) lideriste. Kjo qasje në njëfarë mënyre indirekt i kontriboi praktikës dhe perceptimit të partive politike si 'pronë' të paprekshme e liderëve, në të cilën ata mund të kishin pushtet thuajse të pakontestuar, ndërkaq strukturat tjera partiake më shpesh se sa rrallë ishin ndjekëse të politikës së vendimeve të marra në majen e partisë.

Në përgjithësi, përderisa periudha fillestare pas përfundimit të luftës kishte sfidat e veta, Kosova tashmë ka zhvilluar një përvojë në organizimin e zgjedhjeve. Nga viti 2008 Kosova si shtet ka marrë kompetencat për organizimin e zgjedhjeve, me ç'rast janë zhvilluar zgjedhje nacionale në 2010, 2014, 2017 dhe 2019. Sistemi shumëpartiak tashmë është plotësisht funksional, ndërkaq zgjedhjet e çertifikuara prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) janë të pakontestuara nga subjektet politike, siç ishte rasti me zgjedhjet e fundit në Tetor 2019.

Partitë politike aktuale në Kosovë

Më poshtë do të ofrohet nga një tablo me informacionet bazike për disa prej partive aktuale parlamentare në Kosovë. Në listë janë përfshirë vetëm partitë e komunitetit shumicë shqiptar, që janë të përfaqësuara në Kuvend me më shumë se 3 deputetë. Radhitja është bërë në mënyrë alfabetike.

AAK

Aleanca për Ardhmrinë e Kosovës (AAK) u themelua në vitin 2001, si derivati i dytë më i madh politik i UÇK-së. Kryetari i parë ishte (dhe vazhdon të jetë) Ramush Haradinaj. Në fillim AAK ishte themeluar si një koalicion i gjerë i pesë partive politike. Në aspektin ideologjik AAK aktualisht afirmohet si parti e qendrës së djathtë, duke avokuar për privatizim dhe liberalizim të tregut. Por, vlen të ceket se AAK në zgjedhjet e para pasluftës kishte refuzuar të rreshtohej kah një ideologji e caktuar, duke e formuar sllloganin "As majtas, as djathtas, por përpara".[9]

AAK nuk është e anëtarësuar në asnjë rrjet të organizatave politike.

LDK

Lidhja Demokratike e Kosovës u themelua në vitin 1989 si parti anti-komuniste e djathtë, që synonte liberalizimin e tregut ekonomik, si dhe liritë shoqërore dhe politike. Kryetari i parë ishte Ibrahim Rugova. LDK u formua si nevojë e kundërpeshës së politikës represive të Slobodan Millosheviçit, e cila kishte suprimuar autonominë e Kosovës, duke ia marrë kompetencat qeverisëse kësisoj duke shkelur liritë qytetare, sociale dhe politike. Në nivel kombëtar, ajo synonte pavarësimin e Kosovës, krijimin e një demokracie shumëetnike dhe anëtarësimin e Kosovës në institucionet Euro-Atlantike si BE dhe NATO. LDK e cilëson veten si parti e qendrës së djathtë[10] dhe është anëtare vëzhguese e Partive Popullore Europiane (EPP).

Nisma Socialdemokrate

Nisma Socialdemokrate u themelua në vitin 2014 nga një grup anëtarësh që u shkëputën nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Kryetari i saj nga themelimi është Fatmir Limaj. Sikur edhe vërehet nga emri, Nisma Socialdemokrate e cilëson veten si një parti të qendrës së majtë, që avokon për barazinë dhe rishpërndarjen. Nisma Socialdemokrate cilësohet si një parti e vogël, e cila graviton tek numër njëshifror i deputetëve. Numri i anëtarësisë është 10.000, ndërkaq në total ka të themeluara 31 degë dhe mbi 900 nëndegë.[11]

Nisma Socialdemokrate aktualisht nuk është e anëtarësuar në asnjë rrjet të organizatave politike.

PDK

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) u themelua në vitin 1999, si derivat i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Kryetari i parë i partisë ishte Hashim Thaçi. Përderisa PDK në statutin e saj e cilëson veten si parti e qendrës së djathtë, në fillet e saj ishte kategorizuar si parti e majtë. PDK tradicionalisht mban raporte të ngushta me Partinë Socialiste në Shqipëri. Edhe pse ishte e formuar si një subjekt me sfond të fortë nacionalist, që bazohej në luftën e viteve 1998-1999, PDK ka bërë lëvizje drejt një partie që ka përqafuar vlerat e shtetit qytetar, të drejtave të rezervuara për komunitetet dhe ekonominë e tregut të lirë. PDK ka luajtur një rol kyç gjatë procesit të privatizimit ekonomik në Kosovë. PDK është e anëtarësuar në rrjetin Konservativët dhe Reformistët Evropianë (ECR).[12]

Vetëvendosje

Vetëvendosje ishte themeluar në vitin 2005 si një lëvizje qytetare, ndërkaq iu nënshtrua procesit zgjedhor për herë të parë në vitin 2010. Lëvizja Vetëvendosje është subjekt i qendrës së majtë, pra social-demokrat, veçanërisht në politikat ekonomike, duke avokuar për zbatimin e taksës progresive, privatizim më të kujdesshëm dhe nxitje të prodhimit të brendshëm. Në përgjithësi, Vetëvendosje proklamon idetë e forcimit të shtetit, si në aspektet e skemave sociale, ashtu edhe në përmirësimin e shërbimeve të institucioneve publike, si rrugë drejt drejtësisë sociale. Përpos kësaj, identiteti i Vetëvendosje është gjithashtu i lidhur ngushtë me aspektin kombëtar, duke pasur shqiptarizmën në qendër të argumentimit politik. Vetëvendosje është anëtare observuese e Internacionales Socialiste.[13]

Aktualisht, Vetëvendosje ka një anëtarësi prej 45,296 anëtarësh ndërkaq ka 550 Pika dhe 37 Qendra në Republikën e Kosovës dhe në diasporë (si dhe 7 Qendra të reja në diasporë).[14]

Ideologjia dhe partitë politike kosovare

Një ndër aspektet kryesore të funksionimit e partive politike është pozicionimi ideologjik, që natyrisht dikton edhe veprimin e tyre politik. Në fakt, diskutimi ideologjik edhe në shtetet e tjera tashmë është bërë paksa i mjegullt. Kjo pasi vijat dhe pozicionet e qarta ideologjike, më shpesh se sa rrallë, e kanë humbur peshën e madhe që e kishin dikur. Pavarësisht kësaj, premisat ideologjike vazhdojnë të mbeten me rëndësi, për të kuptuar më mirë funksionimin dhe rreshtimin e partive politike brenda sistemit politik.

Në përgjithësi, debati ideologjik në Kosovë nuk është ende i zhvilluar sa duhet.[15] Ka disa faktorë që kanë kontribuar në këtë situatë, të lidhur kryesisht me trajektoren e zhvillimit të partive politike. Një prej tyre lidhet me vitet 1990, ku shkak të pamundësisë për të pasur qeverisje efektive sistemi paralel kishte prodhuar institucione me kapacitete të limituara. Për më shumë, kërkesa mbizotëruese e të gjithave kishte të bënte me një kërkesë të madhe si pavarësia, prandaj partitë politike kosovare në vitet 1990 nuk e kishin ideologjinë një prej anëve më të forta. Meqenëse në front të angazhimit politik të thuajse të gjitha partive brenda sistemit paralel ishte kërkesa e Kosovës për t'u shpallur shtet i pavarur, si rrjedhojë edhe orientimi ideologjik i partive në raport me politikat publike disi doli në plan të dytë.

Për më tepër, një situatë e ngjashme, ani pse jo e njëjtë, u përsërit edhe pas vitit 1999. Partitë politike edhe njëherë kishin kompetenca të ngushtuara brenda institucioneve lokale, për të formësuar dhe ekzekutuar politika publike. Në këtë kuadër, zotërimi i këtyre kompetencave nga UNMIK, bëri që kërkesa e partive për krijim të politikave në mënyrë koherente në përputhje me një ideologji të caktuar, prapë të ishte në plan të dytë. Kjo pasi kryefjala e diskutimit politik nga ana e partitve politike ishte çështja e statusit të Kosovës, e cila arrinte t'i lente në hije të gjitha aspektet tjera të politikave publike. Pra, pjesëmarrja e partive politike brenda sistemit politik nuk kishte të bënte me garë demokratike, të bazuar në garë ideologjike të ideve, aq sa në komunikim me komunitetin ndërkombëtar në lidhje me krijimin e kushteve për shpalljen e pavarësisë. Në fakt, të dy këto periudha kanë ndikuar që partitë politike në Kosovë të kenë një shtrat ideologjik jo të fortë.

Periudha e paspavërsisë solli ndryshime rrënjësore në institucionet kosovare. Ato morrën përsipër kompetencat e UNMIK. Në këtë drejtim, roli i partive politike përbrenda procesit të hartimit dhe zbatimit të politikave u zgjerua, pra ato kishin më shumë kompetenca qeverisëse. Në anën tjetër, debati ideologjik në sferën publike vazhdoi të jetë i dominuar nga temat e mëdha historike apo ato me sfond nacionalist, si një mënyrë më efektive për të mobilizuar bazat e votuesve. Në këtë kuadër, relacionet me Serbinë, themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe apo demarkacioni me Malin e Zi janë temat që kanë mbizotëruar debatin politik në Kosovë vitet e fundit. Debati publik mbi politikat sektoriale vazhdon të jetë i pamjaftueshëm.

Përpos këtyre, si tregues të shenjimit të dobët ideologjik mund të ceket lëvizja e kuadrove ndërmjet partive politike apo edhe lidhja e koalicioneve. Së pari, kapërcimet e individëve nga një parti e majtë në një parti të djathtë nuk janë të pazakonta në skenën politike. Madje në raste të caktuara ka pasur grupe të plota deputetësh që kanë lëvizur nga një parti me një pozicion të caktuar ideologjik dhe kanë formuar një subjekt në polin e kundërt, siç është rasti me Nisman Socialdemokrate, e formuar nga anëtarët e pakënaqur të PDK-së, e cila siç u cek afirmohet si parti e qendrës së djathtë.

E njëjta mund të thuhet për lidhjen e koalicioneve Qeveritare. Të qenit në anën e kundërt nuk është parë si dallim që mund të pengojë lidhjen e koalicioneve në nivel qendror apo lokal. Madje për shkak të sistemit të balotazhit, që inkurajon bashkëpunimin partiak në raundin e dytë, në nivelin lokal ka pasur ndërveprim të theksuar ndërmjet partive. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe kur në nivel qendror partitë kanë mundur të jenë në pozicione të kundërta pushtet-opozitë. Koalicioni i vetëm partiak i cili nuk është provuar deri tash as në nivel qendror as lokal është ndërmjet Vetëvendosje dhe PDK. Sidoqoftë, se sa ky mosbashkëpunim është produkt i pozicionimit ideologjik është një pikë që mund të debatohet. Kjo pasi akuzat për mënyrën e funksionimit, si psh. për korrupsion dhe keqqeverisje nga ana e Vetëvendosje kanë ndërtuar murin, ndoshta kryesor, që mëpastaj ka sjellur këtë mungesë e bashkëpunimt.

Në fakt, se komponenta ideologjike e partive politike nuk është pika e tyre më e fortë, është dëshmuar edhe në studime të mëhershme. Ta zëmë, një studim përmbledhës në vitin 2014, bazuar në qëndrimet e partive për një varg të fushave, kishte gjetur se prej katër partive të mëdha (AAK, LDK, PDK, VV) kjo e fundit ka një përputhje më të fortë të qëndrimeve mes zyrtarëve dhe anëtarëve të ideuar përreth termave të caktuar ideologjik.[16]

Në anën tjetër, tre partitë tjera cilësoheshin si parti *catch-all* me një fjalë parti pa pozicion të qartë ideologjik, duke pasur përqafim të ideve prej të gjitha anëve të kompasit ideologjik, nga strukturat partiake. Fakti se zyrtarët partiakë dhe anëtarët e shohin partinë në bazë të vlerave ideore me dallime të theksuara, flet për diskrepancën e individëve brenda partisë në raport me ideologjinë të cilën partia respektive mëton ta përfaqësojë.

Një aspekt tjetër që reflekton këtë mungesë janë politiakt e prodhuara nga partitë gjatë kohës sa janë në institucione. Këto politika shpesh janë të kundërta nga ideologjia e proklamuar. Psh. në Kosovë qeverisjet e dominuara nga partitë e qendrës së djathtë LDK, PDK dhe AAK vazhdimisht kanë rënduar bazën e skemave sociale, si rezultat Kosova aktualisht ka mbi 20 skema sociale. Në vitet e fundit, këto tre parti ishn në qendër të aprovimit të Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës Çlirimtare të Kosovës,[17] i cili e ka kosto në buxhetin e shtetit me një shifër prej rreth 100 milion. Ngjashëm me këtë, në Kosovë shteti vazhdon të mbetet punëdhënësi më i madh. Këto politika janë një rezultat i Qeverive të qendrës së djathtë, sado që në letër do të mund të pritej e kundërta. Në anën tjetër, Lëvizja Vetëvendosje, si parti social-demokrate, ka afirmuar një gjuhë të fortë patriotike, bosht i së cilës është elementi kombëtar i shqiptarizmës, që më shpesh se sa rrallë mund të ngjajë me ligjërimin e partive të djathta.

Parë në përgjithësi, profilizimi ideologjik partiak në Kosovë ka përparuar në dy dekadat e fundit. Megjithatë, ai nuk është ende në stadin e dëshirueshëm. Përderisa, tashmë

shumica e partive kanë përqafuar një pozicion të caktuar dhe në masë të madhe drejtojnë diskursin politik në përputhje me të, sistemi politik ende shquhet me çakordim ideologjik në procesin e zbatimit të politikave. Ky çakordim mund të spikatet qartazi në disa pika: kalimi i kuadrove nga njëra parti në tjetrën, sendërtimi i vazhdueshëm i koalicioneve të partive në pozicione të kundërta ose rezultatet e politikave. Thënë të gjitha këto, parë përgjithësisht, kjo situatë duket se është duke përparuar. Një gjë e tillë mund të konkludohet nëse inspektohet fushata zgjedhore në vitin 2019, ku cilësia e zgjedhjeve të politikave sektoriale ishte përgjithësisht në nivel më të lartë se në të shkuarën.

Politika ndër-partiake në Kosovë pas vitit 1999

Sikur u cek më lartë, starti i politikës ndër-partiake në Kosovë pas zgjedhjeve të para lokale dhe nacionale, në 2000, respektivisht 2001, nuk ishte i lehtë. Bashkëpunimi ndërmjet partive politike përballej me sfida serioze në dy fronte kryesore. Së pari, subjektet politike shqiptare vinin nga një dekadë me turbulenca, që kishte ngritur tensionet midis subjekteve. Sikur dihet, në atë periudhë ekzistonte një animozitet i theksuar mes LDK-së dhe partive të dala nga UÇK, pra me AAK-në, por veçmas me PDK-në. Në të njëjtën kohë, tensione ekzistonin edhe ndërmjet dy derivateve të UÇK-së, PDK-së dhe AAK-së. Duhet cekur se aq i madh ishte tensioni politik e shoqëror në periudhën e pasluftës, sa kishte edhe një sërë vrasjesh politike të figurave kyçe politike, sidomos të LDK-së, të cilat nuk janë zbardhur asnjëherë. Përpos kësaj, sfidë e dytë mbetej inkuadrimi dhe pjesëmarrja bashkëpunuese e partive të komunitetit joshumicë serb në jetën e re institucionale. Përfaqësuesit e komunitetit serb në periudhën fillestare të pas luftës, kishin refuzuar në mënyrë kategorike këto kërkesa. Ata madje kishin refuzuar të merrnin pjesë në zgjedhjet e para lokale të vitit 2000.

Komuniteti ndërkombëtar luajti një rol kyç për adresimin e këtij animoziteti, i cili cilësohej si rrezik iminent për procesin e paqe-ndërtimit në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe, UNMIK ishte i interesuar të krijojë një situatë të ndërveprimit, si dhe, bashkëpunimit ndërmjet partive politike në Kosovë. Me këtë qasje synohej të shkriheshin jo vetëm muret e krijuara nga dekada e kaluar, por edhe të ndërtonin ura bashkëpunimi dhe të krijonin mirëbesim ndërmjet subjekteve, zyrtarëve dhe votuesve të tyre për të ardhmen. Bazuar në këtë, u zgjodh zbatimi i sistemit zgjedhor proporcional, pra injorimi i sistemit mazhoritar. Një sistem mazhoritar do të mund të ndikonte në tejforcim të subjektit të parë politik, mëpastaj ulje të nevojës për bashkëpunim dhe koalicione midis subjekteve. Kësodore, përmes vendosjes së sistemit proporcional UNMIK synonte të ulte diferencat mes subjekteve politike, me një fjalë, vendosjen e një sistemi të ndërvarshmërisë, ku bashkëpunimi i partive do të bëhej jo vetëm i nevojshëm, por i pashmangshëm.

Prandaj, me fillimin e shkrirjes së këtyre animoziteteve, sidomos pas zgjedhjeve të vitit 2001, bashkëpunimi ndërmjet partive politike filloi të intensifikohej. Qeveritë me bazë të gjerë ishin një instrument i përdorur nga UNMIK dhe shtetet e QUINT për këtë qëllim. Në bazë të kësaj logjike, në periudhën 2002-2004 kishte një Qeveri të gjerë nën udhëheqjen e Bajram Rexhepit nga radhët e PDK si Kryeministër, pas disa muajsh zvarritje. Sidoqoftë, Kryeministri Rexhepi nuk ishte Kryetar i PDK-së, as një prej figurave më të fuqishme elektoralisht. Prandaj, figura e tij ishte si nën hijen e Presidentit Rugova dhe Kryetarit të PDK-së Hashim Thaçi.

Pas kësaj Qeverie me bazë të gjerë, procesi i qeverisjes në Kosovë futet në një cikël të ri nga viti 2004. Periudha 2004-2007 solli një Qeveri të formuar ndërmjet LDK-së si parti fituese dhe AAK-së, duke e lënë një PDK të tensionuar në opozitë. Edhe për shkak të shkuarjes së Kryeministrit Haradinaj në Hagë nën akuzën e Tribunalit të Hagës, por edhe për faktin

se një parti relativisht e vogël (që kishte fituar rreth 8%) mbante postin e Kryeministrit, kjo Qeveri u përball me vështirësi në reflektimin e autoritetit qeverisës. Në fakt, Qeveria ndërroi 3 Kryeministra për 3 vite, para se të shkohej në zgjedhje të parakohshme në vitin 2007.

Me fitoren e PDK-së në zgjedhjet e nëntorit 2007 dhe afrimin e fundit të negociatave të Vjenës, ishte afirmuar ideja se një koalicion i gjerë ishte i domosdoshëm për ta menaxhuar me sukses shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Për këtë qëllim, u krijua koalicioni mes PDK dhe LDK. Në të vërtetë, bashkëpunimi i këtyre partive nuk shihej si i natyrshëm nga shumica. Ky koalicion i përbërë nga dy partitë më të mëdha kishte fatin të udhëheqte Kosovën në një periudhë me perspektivë, në muajt dhe vitet e para pas shpalljes së pavarësisë. Koalicioni ishte gjithashtu stabil në aspektin e përkrahjes në Kuvend, meqë e kishte shumicën. Sidoqoftë, në vitin 2010 Gjykata Kushtetuese kishte dhënë opinion se Presidenti Sejdiu kishte shkelur Kushtetutën, duke mbajtur pozitat e Presidentit dhe Kryetarit të LDK-së. Dorëheqja e Sejdiut nga posti i Presidentit në vitin 2010, i dha fund edhe koalicionit ekzistues qeverisës. Kosova u drejtua drejt zgjedhjeve të parakohshme dhe një krize politike disamujore, me postin e Presidentit vakant.

Me fitoren e PDK-së në vitin 2010 u formua një koalicion asimetrik PDK-AKR, plus partitë e komuniteteve joshumicë. Sidoqoftë, telashet nuk mbaruan këtu, pasi procesi i votimit të Pacollit President u kontestua dhe u dërgua në Gjykatën Kushtetuese. Pas shkeljeve të identifikuara nga Gjykata Kushtetuese në procesin e votimit, Pacolli ishte larguar nga posti i Presidentit në Mars 2011. Kuvendi zgjodhi një kandidate koncensuale për Presidente, Atifete Jahjaga, me vendimin e parë për një periudhë 1 vjeçrae, që më vonë u shndërrua në një mandat 5 vjeçar. Sidoqoftë, koalicioni PDK-AKR u përball me probleme për të formuar shumicën në Kuvend në mënyrë të vazhdueshme, kësisoj duke ndërtuar një raport koncensioni të vazhdueshëm ndërmjet partnerëve të koalicionit. Për më shumë, ky koalicion përballej me një opozitë të forte, e përbërë prej LDK, AAK dhe debutuesve Vetëvendosje. Për këto arsye, në 2014 pak muaj para përfundimit të mandatit vendi u drejtua në zgjedhje të parakohshme.

Zgjedhet e Qershorit të vitit 2014 nxorrën PDK-në fituese. Sidoqoftë, disa ditë pas zgjedhjeve vendi u fut në krizën më serioze politike të pasluftës, pas nënshkrimit të një marrëveshje koalicioni ndërmjet të gjitha partive tjera shqiptare (Vetëvendosje, LDK, AAK dhe NISMA). Bazuar në votat e këtij koalicioni, me 17 Korrik 2014 ishte votuar kryetari i Kuvendit, Isa Mustafa, por ky proces ishte shpallur si i pavlevshëm nga Gjykata Kushtetuese për shkak se mbledhja, procedura, rrjedhimisht edhe vendimi nga ky takim qenë cilësuar si jokushtetuese.[18]

Për këtë, Qeveria e koalicionit VLAN nuk arriti të dilte në votim në Kuvend. Në anën tjetër, PDK, si partia fituese, nuk kishte partner të koalicionit, domethënë numrat e nevojshëm në Kuvend për ta zgjedhur kryetarin e Kuvendit, një e drejtë që i takonte si grupi më i madh Parlamentar. Ky ngërç politik ishte një test serioz për pjekurinë demokratike të institucioneve kosovare. Zgjidhja e një periudhe majft sfiduese u mundësua pasi PDK dhe LDK nënshkruan koalicion qeverisës. Kuvendi më në fund arriti të konstituohej në Nëntor 2014, plot pesë muaj pas zgjedhjeve. Në Dhjetor 2014 u zgjodh Qeveria e re, përmes koalicionit të ri të përbërë nga PDK, LDK dhe partitë e komuniteteve joshumicë, me Kryeministër Isa Mustafa.[19]

Megjithatë, as formimi i Qeverisë nuk solli stabilitetin qeverisës të kërkuar tashmë me vite. Kjo pasi me organizimin e opozitës (Vetëvendosje, AAK dhe NISMA) në një bllok opozitar, filloi kundërshtimi i vazhdueshëm i Qeverisë përmes protestave, por edhe përdorimit të mjeteve të dhunës si gazi lotsjellës në institucione, pra në Kuvend, duke pamundësuar zhvillimin e jetës legjislative dhe politike. Më shumë se një herë mbledhjet e Kuvendit u tentuan të mbaheshin në ambiente të jashtme. Kundërshtimi kishte në epiqendër pamundësimin e votimit të marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi dhe themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, që rridhte nga Marrëveshja e Brukselit në vitin 2013. Qeverisja u bë totalisht joefektive, deri kur në fillim të vitit 2017 u votua mocioni i mosbesimit dhe vendi edhe njëherë shkoi në zgjedhje të parakohshme.

Zgjedhjet e Qershorit të vitit 2017 sollën një fitore të koalicionit PAN (PDK, AAK dhe NISMA), duke pasur përballë një opozitë të fortë me Vetëvendosje dhe LDK. Për këtë arsye, Qeveria ishte tërë kohës në krizë të shumicës parlamentare, madje, duke u varur nga deputetët të opozitës për nisma ligjore të caktuara, siç është rasti me buxhetin e vitit 2018.[20]

Edhe për shkak të krizës së prodhuar nga procesi i dialogut me Serbinë dhe betejës Qeveri-Presidencë për udhëheqjen e dialogut, Qeveria përballej me vështirësi të theksuara në udhëheqje. Pas dorëheqjes së Haradinaj si pasojë e ftesës për intervistë nga Dhomat e Specializuara në Korrik, vendi u drejtua edhe njëherë drejt zgjedhjeve të parakohshme në verën e vitit 2019.

Në Tetor të vitit 2019 zgjedhjet nxorrën fituese Lëvizjen Vetëvendosje dhe në shkurt 2020, Qeveria mes Vetëvendosje dhe LDK u formua, si një Qeveri e cila mendohej të ishte stabile, veçanërisht për shkak të mjaftueshmërisë së numrave në Parlament. Sidoqoftë, pas mospajtimeve të partnerëve Vetëvendosje dhe LDK, kjo e fundit inicioi mocion të mosbesimit me ç'rast Qeveria nën udhëheqjen e Albin Kurtit u rrëzua në muajin Mars. Në Qershor 2020 Qeveria LDK, AAK, NISMA plus komunitetet joshumicë u formua, e cila prapë ka përballë një opozitë të fortë, të përbërë nga VV dhe PDK. Për këtë shkak përmbushja e mandatit të plotë shihet si diçka sfiduese.

Nga rezymeja e mësipërme, mund të vërehet se sistemi politik ndërpartiak në Kosovë ka ushqyer një praktikë të jostabilitetit politik (që shpesh është përkthyer edhe në jostabilitet shoqëror). Polarizimi partiak, ani pse është shkrirë dukshëm në vitet e fundit, ende ka potencial serioz për të krijuar kriza politike dhe bllokada institucionale në mënyrë të vazhdueshme. Kjo më së miri mund të vërehet nga fakti se asnjëra Qeveri nuk ka arritur ta përmbushë mandatin 4 vjeçar, për këtë shkak zgjedhjet e parakohshme janë shndërruar në një zakonshmëri. Realisht, zgjedhjet e parakohshme janë tipar i një sistemi politik jostabil, prandaj Kosova duhet të synojë që të mbërrijë në stadin ku rotacioni qeverisës bëhet përmes përfundimit të mandatit të rregullt.

Një tjetër aspekt spikatës, i prodhuar nga polarizimi ndër-partik, është vonesa në formimin e Qeverive. Për shembull, në vitin 2014 u deshën 6 muaj për formimin e Qeverisë së re, në vitin 2017 rreth 3 muaj, ndërsa në vitin 2019 rreth 2 muaj. Në përgjithësi, këto periudha pa qeverisje efektive, vetëm kanë dëmtuar institucionet në kryerjen e punëve të tyre. Për më shumë, bllokada të tilla institucionale shpesh kanë qenë peng i negociatave ndërmjet partive, pra kanë qenë krejtësisht të evitueshme.

Më tutje, gjatë procesit të qeverisjes, më shpesh se sa rrallë, Qeveritë janë përballur me vështirësi për të krijuar shumicën parlamentare. Me qeveri të dobëta në aspektin e numrave në Kuvend, reformat e rëndësishme afatgjatë kanë dalur gjithmonë në plan të dytë, ndërkaq ka pasur dhe mungesë bashkëpunimi pushtet-opozitë në çështje të interesit nacional. Duke i sjellë Qeveritë në pozita të palakmueshme përballë opozitave të forta, kjo pastaj ka sjellur nevojën e koncensioneve me deputetë individual, ose grupe të deputetëve, pra duke e bërë kalimin e ligjeve një sfidë persistente për ekzekutivin.

Në një vështrim të plotë, mund të thuhet se bashkëpunimi ndër-partiak është një parakusht i qeverisjes së suksesshme dhe shëndetit demokratik të sistemit politik. Nëse shihet në plan afatgjatë, atëherë vërehet se partitë politike kanë arritur të shkrijnë tensionet e dikurshme. Sidoqoftë, ndërveprimi partiak në Kosovë ende shquhet nga polarizimi, animoziteti dhe relacione të dyshimit të nxitura nga shkelja e vazhdueshme e marrëveshjeve të koalicioneve. Për më shumë, këto raporte ndër-partiake janë bartur në institucione, kësisoj duke dëmtuar cilësinë e rezultateve të tyre.

Konkluzion

Ky punim i shkurtër ka diskutuar për partitë politike në Kosovë. Ai ka ofruar një analizë përshkruese të historikut që ka formësuar partitë politike në Kosovë që nga viti 1945, mëpastaj ka përshkruar partitë aktuale parlamentare dhe tiparet e tyre kryesore. Përpos kësaj, punimi ka diskutuar për aspekte ideologjike të partive politike dhe ndikimet e tyre mbi sistemin politik, duke u fokusuar veçanërisht në bashkëpunimin partiak pas vitit 1999. Bazuar në këtë, dy pjesë vlen të ritheksohen.

Sa i përket aspekteve ideologjike, punimi ka nënvizuar se lidhja e partive politike me ideologjinë vazhdon të ngelet jo e kënaqshme. Kjo lidhje e dobët mund të vërehet tek kalimet e kuadrove nëpër parti të poleve të kundërta, lidhje të koalicioneve nga parti ideologjikisht të kundërta, ose rezultatet në politika të cilat shpesh nuk reflektojnë pozicionin e partisë. Me qëllim të hartimit të politikave koherente me rezultate efektive, por edhe pasurimit të debatit publik në Kosovë, vëmendja e shtuar për pjesën ideologjike brenda partive politike duhet të jetë prioritet për palët e përfshira, veçanërisht për strukturat dhe anëtarësitë e partive.

Një aspekt tjetër me rëndësi mbetet ndërveprimi ndërmjet partive politike, i ndërtuar në relacione korrekte dhe bashkëpunim efektiv me qëllim të prodhimit të politikave cilësore. Në fakt, nëse gjykohet në planin afatgjatë, partitë politike kosovare kanë tejkaluar polarizimin e skajshëm të fillim viteve 2000. Ndërveprimi partiak ka ndikuar në uljen e tensioneve të dikurshme dhe ka krijuar kushtet për stabilitet. Sidoqoftë, këto kushte nuk janë shfrytëzuar sa duhet nga partitë politike. Në fakt, veprimet partiake kanë sjellur kriza politike të njëpasnjëshme, që mund të vërehen me qeveri jetëshkurtëra, bllokada institucionale, mungesë bashkëpunimi pushtet-opozitë në çështje të interesit nacional dhe shkelje të marrëveshjeve të koalicionit. Në këtë drejtim, edhe pse ndërveprimi i partive politike në dy dekadat e fundit është përmirësuar, më shumë duhet bërë që ky ndërveprim të krijojë marrëdhënie të besimit të mirë ndërmjet partive. Ky besim i ndërsjellë do të ishte edhe një rrugë për gjetjen e koncensusit nacional, veçmas në momente me rëndësi për vendin.

9

Shënimet dhe referencat

Referencat

Alemann, Ulrich u.a.. *Interessenverbände*. Informationen zur Politischen Bildung (Heft 253). Bonn: Bundeszentrale für politische Bildung, 1996.

Austin and Tjernstrom (2003) Funding of Political Parties and Election Campaings. IDEA, Trydells Tryckeri AB, Sweden

Burnell at all (1998) *Funding Democratization: Perspectives on Democratization*. Manchester and New York: Manchester University Press

Dahl, Robert. *Polyarchy: Participation and Opposition*. New Haven, 1971.

Dalton, Russell J. dhe Martin P. Wattenberg. "Unthinkable Democracy: Political Change in Advanced Industrial Democracies". In *Parties without Partisans: Political Change in Advanced Industrial Democracies*, botuar nga Russell J. Dalton dhe Martin P. Wattenberg. Oxford and New York: Oxford University Press, 2000.

Downs, Anthony. *An Economic Theory of Democracy*. New York: Harper & Brothers, 1957.

Duverger dhe Maurice (1954) *Political Parties: Their Organization and Activity in the Modern State*. London and Neë York: Methuen, Wiley

Finer, Herman. *The Theory and Practice of Modern Government*. Westport: Greenwood Press, 1950/1970.

Freedom House (2012) Nations in transit [online] Gjendet: http://www.freedomhouse.org/sites/default/files/NIT2012Kosovo_final.pdf [Qasja më 15 Shkurt 2013]

Fukuyama, Francis. *The End of History and the Last Man*. New York: Harper Perennial, 1992.

Heywood, Andrew. *Politics*. Houndmills: Palgrave Macmillan, 2002.

Jäger, Wolfgang. *Fernsehen und Demokratie: Scheinplebiszitäre Tendenzen und Repräsentation in den USA, Großbritannien, Frankreich und Deutschland*. München: Beck, 1992.

Jarren, Otfried dhe Patrick Donges. *Politische Kommunikation in der Mediengesellschaft: Eine Einführung*. 2nd edition. Wiesbaden: VS-Verlag für Sozialwissenschaften, 2006.

Karl-Rudolf Korte. "Wie Parteien auf komplexe Wählermärkte reagieren". In *Blätter für deutsche und internationale Politik* 6/2000, pp. 707-716.

Kepplinger, Hans Mathias dhe Marcus Maurer. *Abschied vom rationalen Wähler: Warum Wahlen im Fernsehen entschieden werden*. Freiburg/München: Verlag Karl Alber, 2005.

Konrad-Adenauer-Stiftung, ed. *Handbuch Politische Kommunikation*. Beograd, Berlin dhe kudo tjetër, 2006 (e disponueshme në gjuhën Gjermane, Angleze, Shqipe dhe gjuhë të tjera).

Komisioni Qendor i Zgjedhjeve (2012) Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Cerfitikim. [online] Gjendet në: http://www.kqz-ks.org/SKQZ- WEB/al/rrethkqz/materiale/zrpp/Regjistri%20i%20PP%20-ve.pdf [Qasja më 14 Shkurt 2013]

Korte, Karl-Rudolf dhe Manuel Fröhlich. *Politik und Regieren in Deutschland*. Paderborn: Schöningh, 2006.

Langguth, Gerd. *Machtmenschen*. München: Deutscher Taschenbuch-Verlag, 2009.

Lijphart, Arend. *Patterns of Democracy. Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries*. New Haven dhe Londër: Yale University Press, 1999.

Lösche, Peter. *Parteiensystem der Bundesrepublik Deutschland*. Bonn: Bundeszentrale für politische Bildung, 2006.

Mack, S.C. (2010) When Political parties Dies: A Cross – National Analysis of Disaglinment and Alignment. Praeger, Oxford and California

Michels, Robert. *Zur Soziologie des Parteiwesens in der modernen Demokratie*. Stuttgart: Kröner, 1911/1989.

Müller, Wolfgang C. dhe Kaare Strøm, eds. *Policy, Office or Votes? How Political Parties in Western Europe Make Hard Decisions*. Cambridge: Cambridge University Press, 1999.

NDI (2008) Manual mbi Identitetin dhe Ideologjinë e Partive Politike. [online] Mund të gjendet në: http://ndialbania.org/files/Manual%20mbi%20Identitetin%20dhe%20Ide ologjine%20e%20Partive%20Politike.pdf [Qasja më 16 Shkurt 2013]

Nurellari, A. (2009) Nevoja e Ideoligjizimit të Partive Politike në Kosovë. [online] Gjendet në: http://pips-ks.org/img/permbajtja/pdf/Publikimi_ PIPS_2009_Final.pdf [Qasja më 2 Shkurt 2013]

Olson, Mancur. *Aufstieg und Niedergang von Nationen: Ökonomisches Wachstum, Stagflation und soziale Starrheit*. Tübingen: Mohr Siebeck, 2. Aufl, 2004.

Sartori, Giovanni. *Parties and Party Systems. A Framework for Analysis*. Cambridge: Cambridge University Press, 1976.

Stengel, Richard. "Mandela: His 8 Lessons of Leadership". In *Time Magazine*, July 9, 2008.

Strøm, Kaare. “A Behavioral Theory of Competitive Political Parties”. In *American Journal of Political Science*, Vol. 34, No. 2, 1990. pp. 565-598.

Veen, Hans-Joachim. “Die Bedeutung politischer Parteien für Demokratie und Demokratisierung”. In *Parteien und Demokratie: Beiträge der Internationalen Fachkonferenz zum KAS-Demokratiereport*, edited by Gerhard Wahlers and Karsten Grabow, 25-36. Berlin/ Sankt Augustin: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2007.

Weber, Max (1988). “Politik als Beruf”., In ders.: *Gesammelte Politische Schriften*, edited by Johannes Winckelmann), 5th edition. Tübingen: Mohr, 1988.

Referenca për kapitullin: Partitë Politike në Kosovë

1. Pirraku, Muhamet, 'Rëndësia e "Shtabit suprem të Kosovës" në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës (dhjetor 1944- tetor 1945)'. Revista "Gjurmime albanologjike" Seria e Shkencave Historike Nr. 28, 29, 1998-1999.

2. Gashi, Shkelzen. 'Adem Demaçi - Biografi e Paautorizuar.' Prishtinë: Rrokullia, 2010.

3. International Crisis Group. 'Unifying the Kosovar Factions: The Way Forward', 1999. ICG Balkan Report no 58, Brussels – Tirana, p. 3.

4. KIPRED dhe KAS. 'Integrimi i partive politike të Kosovës në organizatat ndërkombëtare të partive politike: Shpjegimi i vonesës.' Gjendet tek: https://www.kas.de/documents/252038/253252/7_dokument_dok_pdf_42088_33.pdf/7b6d7414-4d31-bdcf-3cd4-7cb0e7a3ba21?version=1.0&t=1539652209095 (qasur me 27 Qershor 2020).

5. UNMIK. *RREGULLORE NR. 2000/16 PËR REGJISTRIMIN DHE VEPRIMIN E PARTIVE POLITIKE NË KOSOVË*, Mars 2000 . Gjendet tek: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2000regs/RA2000_16.htm (qasur me 28 Qershor 2020).

6. UNMIK. *RREGULLORE NR. 2002/8 PER NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË NDRYSHUAR TË UNMIK-ut MBI REGJISTRIMIN DHE VEPRIMIN E PARTIVE POLITIKE NË KOSOVË*, Prill 2000. Gjendet tek: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2002regs/RA2002_08.pdf (qasur me 28 Qershor 2020).

7. UNMIK. *URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR.* 2000/11- *ZBATIM I RREGULLORES SË UNMIK-UT NR.* **2000/16 MBI REGJISTRIMIN DHE PUNËN E PARTIVE POLITIKE NË KOSOVË**, MAJ 2000. Gjendet tek https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2000ads/ADA2000_11.htm (qasur me 28 Qershor 2020).

8. Beha, Adem. 'Mes Stabilitetit dhe Demokratizimit: Zgjedhjet, Partitë Politike dhe Demokracia Brendapartiake në Kosovë.' Prishtinë: FES dhe CPC, 2017.

9. KIPRED dhe KAS. 'Integrimi i partive politike të Kosovës në organizatat ndërkombëtare të partive politike: Shpjegimi i vonesës.' Gjendet tek: https://www.kas.de/documents/252038/253252/7_dokument_dok_pdf_42088_33.pdf/7b6d7414-4d31-bdcf-3cd4-7cb0e7a3ba21?version=1.0&t=1539652209095 (qasur me 27 Qershor 2020).

10. LDK, 'Statuti', Maj 2016. Gjendet tek: https://www.ldk-ks.eu/statuti/ (qasur me 27 Qershor 2020).

11. Pyetjet janë dërguar në Nisma Socialdemokrate me email. Përgjigjet janë pranuar me 29 Maj 2020.

12. ECR- uebfaqja. 'About'. Gjendet tek: https://ecrparty.eu/about (qasur me 7 Korrik 2020).

13. Internacionalja Socialiste- uebfaqja. 'About us'. https:/www.socialistinternational.org/about-us/members/ (qasur me 27 Qershor 2020).

14. Pyetjet janë dërguar në Vetëvendosje me email. Përgjigjet janë pranuar me 15 Qershor 2020.

15. D4D, 'Kosovo's Political Compass: Mapping Party Ideology.' Gjendet tek: https://d4d-ks.org/en/papers/kosovos-political-compass-mapping-party-ideology/ (qasur me 28 Qershor 2020).

16. D4D, 'Kosovo's Political Compass: Mapping Party Ideology.' Gjendet tek: https://d4d-ks.org/en/papers/kosovos-political-compass-mapping-party-ideology/ (qasur me 28 Qershor 2020).

17. Kuvendi i Kosovës. *Ligji Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës Çlirimtare të Kosovës*. Gjendet tek: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9435 (qasur me 28 Qershor 2020).

18. Gjykata Kushtetuese. *Aktgjykim në rastin Nr. KO 119/14*. Gjendet tek: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ko_119_14_shq.pdf (qasur me 9 Korrik 2020).

19. DW, 'Isa Mustafa kryeministër i ri i Kosovës'. Gjendet tek: https://www.dw.com/sq/isa-mustafa-kryeminist%C3%ABr-i-ri-i-kosov%C3%ABs/a-18118488 (qasur me 9 Korrik 2020).

20. Periskopi, 'Besa Gaxherri thotë se votoi kundër buxhetit, por Kuvendi ia regjistron votën pro'. Gjendet tek: https://www.periskopi.com/besa-gaxherri-thote-se-votoi-kunder-buxhetit-por-kuvendi-ia-regjistron-voten-pro/ (qasur me 28 Qershor 2020).

Lexime të tjera (përzgjedhje)

Beyme, Klaus von. *Parteien im Wandel: Von den Volksparteien zu den professionalisierten Wählerparteien*. Wiesbaden: Westdeutscher Verlag, 2000.

Diamond, Larry J. and Richard Gunther, eds. *Political parties and democracy*. Baltimore: The Johns Hopkins University Press, 2001.

Duverger, Maurice. *Les Partis Politiques*. Paris: Armand Colin, 1951.

Grabow, Karsten and Gerhard Wahlers, eds. *Parteien und Demokratie*. Berlin: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2007.

Grabow, Karsten and Patrick Köllner, eds. *Parteien und ihre Wähler. Gesellschaftliche Konfliktlinien und Wählermobilisierung im internationalen Vergleich*. Berlin: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2008.

Katz, Richard S. and Peter Mair. "The Evolution of Party Organizations in Europe: The Three Faces of Party Organization". In *The American Review of Politics*, 14, pp. 593-617. 1993.

Katz, Richard S. und Peter Mair. "Changing Models of Party Organization and Party Democracy. The Emergence of the Cartel Party". In Party Politics, Vol. 1, No. 1, pp. 5-28. 1995.

Kirchheimer, Otto (1966). "The Transformation of the Western European Party Systems". In *Political Parties and Political Development*, edited by Joseph LaPalombara and Myron Weiner, 177-200. Princeton: Princeton University Press, 1966.

Kitschelt, Herbert. *The Logics of Party Formation. Ecological Politics in Belgium and West Germany*. Ithaca: Cornell University Press, 1989.

Kitschelt, Herbert et al.. *Latin American Party Systems*. Cambridge: Cambridge University Press, 2010.

Konrad-Adenauer-Stiftung. *Parties and Democracy. The KAS Democracy Report 2007*. Bonn: Bouvier, 2007.

Konrad-Adenauer-Stiftung. *Parteien und Parteienkooperationen der KAS in Lateinamerika*. Berlin/Sankt Augustin: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2008.

Konrad-Adenauer-Stiftung. *Parties and Democracy, Vol. II. The KAS Democracy Report 2009*. Berlin/Sankt Augustin: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2009.

Konrad-Adenauer-Stiftung. *Parteiendialoge und -kooperationen der KAS in Asien*. Berlin/ Sankt Augustin: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2010.

Liang Fook Lye and Wilhelm Hofmeister, eds. *Political Parties, Party Systems and Democratisation in East Asia*. Singapore: World Scientific Publishing, 2010.

Mainwaring, Scott and Timothy R. Scully, eds. *Building Democratic Institutions: Party Systems in Latin America*. Stanford: Stanford University Press, 1995.

Mair, Peter, ed. *The West European Party System*. Oxford: Oxford University Press, 1990.

Merkel Wolfgang und Eberhard Sandschneider, eds. *Systemwechsel 3: Parteien im Transformationsprozeß*. Opladen: Leske & Budrich, 1997.

Panebianco, Angelo. *Political Parties. Organization and Power*. Cambridge: Cambridge University Press, 1988.

Webb, Paul D., David M. Farrell and Ian Holliday, eds. *Political parties in advanced industrial democracies*. Oxford: Oxford University Press, 2002.

Weissenbach, Kristina. *Political Parties and Party Types. Conceptual Approaches to the Institutionalization of Political Parties in Transitional States: Case of the Philippines.* Manila: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2011. Available at: http://www. kas.de/philippinen/en/ publications/21710/.

Fotografitë

Faqe 12, 17,20,26
Foto nga fushata para-elektorale e LDK-së, www.ldk-ks.eu

Faqe 28
Foto nga protestat kundër shtrenjtimit të Energjisë Elektrike

Faqe 29
Petra Merkel MdB 2008
http://commons.wikimedia.org/wiki/File:Petramerkel.jpg

Faqe 35, Faqe 36
http://www.flickr.com/photos/democraciacristiana

Faqe 35
https://www.facebook.com/CDU/

Faqe 39
Foto nga Kuvendi Zgjedhor i LDK-së, www.ldk-ks.eu

Faqe 43
Foto nga forumi i Gruas i LDK-së, www.ldk-ks.eu

Faqe 44
Burns Lake Aboriginal Day
http://commons.wikimedia.org/wiki/File:Aboriginal_Day.jpg

Faqe 50
Protesta e Fermerëve mbi të Drejtat mbi Tokën në Xhakarta, Indonezi.
http://commons.wikimedia.org/wiki/File:Jakarta_farmers_protest36.jpg

Faqe 56
http://www.cdu.de/

Faqe 62
Kuvendi i Kosoves
http://www.kuvendikosoves.org/

Faqe 63
Presidenti në largim i Afrikës së Jugut Nelson Mandela përshëndet mbështetësit e tij në klinikën e re Shanty në Orlando, West Soweto 11 Qershor 1999. AFP

Faqe 65
Fotografi e Rudy Giuliani
http://commons.wikimedia.org/wiki/File:Rudy_Giuliani.jpg

Faqe 71
Foto nga festimet e pavarësisë

Faqe 76
Konrad Adenauer

Autorët

Dr. Wilhelm Hofmeister

është drejtor i projektit rajonal " Dialogu Politik me Azinë" i Konrad Adenauer Stiftung (KAS), i vendosur në Singapor. Ai ka qenë përfaqësues i KAS-it në Kili, zëvendës drejtor i departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në selinë e saj, dhe nga viti 1999 deri më 2009, ai ishte drejtor i Qendër së Hulumtimeve KAS në Rio de Zhaniero, Brazil.

Kontakt: Wilhelm.Hofmeister@kas.de

Dr. habil. Karsten Grabow

është koordinator për studime politike dhe hulumtime të partive në ekipin e politikave të brendshme në KAS në Berlin. Deri në fund të vitit 2010 ai ishte hulumtues i lartë në departamentin për Bashkëpunim Evropian dhe Ndërkombëtar (BEN) dhe përgjegjës për bashkëpunim ndërkombëtar partiak të KAS-it.

Kontakt: Karsten.Grabow@kas.de

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

329

Hofmeister, Wilhelm
Partitë politike : funksioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike / Wilhelm Hofmeister, Karsten Grabow; Global Consulting & Development Associates LLC. – Botimi 2. – Prishtinë : Konrad Adenauer Stiftung, 2020. - 103 f. : ilustr. me ngjyra ; 25cm.

1. Grabow, Karsten

ISBN 978-9951-8871-6-8

PARTITË POLITIKE janë institucione të cilat e karakterizojnë demokracinë moderne. Ato i artikulojnë dhe i bashkojnë interesat shoqërore, zhvillojnë programe dhe i lidhin shoqërinë me shtetin. Ato rekrutojnë kandidatë për zgjedhje, zgjedhin liderë politikë dhe organizojnë qeveri. Ato promovojnë pjesëmarrje politike të qytetarëve. Për më tepër, ato kontribuojnë në kontekst të legjitimitetit të sistemit politik demokratik.

Në këtë libër, partitë politike janë prezantuar si institucione qendrore të demokracisë moderne. Temat kryesore të cilat janë përfshirë janë: karakteristikat dhe funksionimi i partive, elementët kryesorë të organizimit të tyre, konteksti i tyre politik dhe social, si dhe problemet e demokracisë partiake dhe sfidat specifike me të cilat ballafaqohen ato. Libri, gjithashtu jep edhe një vështrim të shkurtër të peizazhit të partive politike në Republiken e Kosovës dhe i përshkruan ideologjitë e tyre dhe koalicionet politike.

Qëllimi i librit është të ndërmjetësojë informacione themelore për aspekte të ndryshme të partive politike. Njëkohësisht, qëllimi i tij është të zgjojë interesim për angazhimin e lexuesit në kuadër të partisë politike

KONRAD ADENAUER STIFTUNG

ISBN 978-9951-8871-6-8